

# Rrënimi i Autonomisë së Kosovës 1989 – 1991 dhe pasojat për idenë e integrimit evropian

---

Joseph MARKO



**Titulli:** Rrënimi i Autonomisë së Kosovës 1989 – 1991  
dhe pasojat për idenë e integrimit evropian

**Botuar nga:** Konrad Adenauer Foundation (KAS) in Kosovo

**Autor:** Joseph MARKO

**Koordinimi:** Daniel BRAUN dhe Granit TËRNAVA

**Lektura:** Dr. Arben Hajrullahu (shqip) dhe  
Dr. Marko Kmezić (serbisht)

**Design:** Tedel (Faton Selani)

**Shtypi:** ArtGraphics

**Shtypi:** 100 ekzemplarë

Publikimi mund të shkarkohet falas në: <http://www.kas.de/Kosovo>

Vërejtje: Qëndrimet e prezantuara në këtë libër janë pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk i paraqesin patjetër qëndrimet e Fondacionit Konrad-Adenauer. Ky botim nga Fondacioni Konrad Adenauer është vetëm për informacion. I njëjti nuk mund të përdoret për qëllime fushate gjatë një fushate zgjedhore.

# Rrënimi i Autonomisë së Kosovës 1989 – 1991 dhe pasojat për idenë e integritetit evropian

---

Joseph MARKO



## Një parathënie personale: Sërish të njëjtat gabime?

---

Ky publikim shërbeu si raport, i porositur fillimisht nga Zyra e Prokurorisë (ZP) e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) në përgatitje për aktakuzën dhe procedurat kundër Milan Milutinoviçit (Milan Milutinović), Dragoljub Ojdaniçit (Dragoljub Ojdanić) dhe Nikolla Shainoviçit (Nikola Šainović), si dhe kundër Slobodan Millosheviçit (Slobodan Milošević). Opinioni i dëshmitarit ekspert u porosit për të përgatitur një pasqyrë të kontekstit historik të zhvillimit të sistemit kushtetues të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) dhe statusit kushtetues të Kosovës brenda këtij sistemi federativ deri në shpërbërjen e tij në vitin 1991 dhe miratimin e kushtetutës së re të Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ) të vitit 1992. Prej fillimit ma bënë të qartë se praktikohen rregullat e procedurës penale anglosaksone. Pra, gjyqtarët zyrtarisht nuk lexojnë asgjë paraprakisht për kontekstin historik, domethënë faktik dhe politik, por i dëgjojnë dhe përfundimisht i vlerësojnë të gjitha ato që në gjuhë ligjore quhen „fakte të vërtetuara” në bazë të prezantimeve gojore të dëshmitarëve të sjellë si nga prokuroria ashtu edhe nga avokatët mbrojtës, si dhe nga ekzaminimi i mundshëm i kryqëzuar nga njëra apo të dyja palët në një procedurë të tillë kundërshtuese. Për më tepër, është edhe një karakteristikë e dytë e rregullave anglosaksone të procedurës penale që duhet të merret parasysh, përkatësisht mundësia e marrëveshjes për pranimin e fajësisë në mënyrë që prokuroria dhe mbrojtja të mund të dakordohen t’i lënë mënjanë provat faktike të cilat nuk do të paraqiten më pas në seancat gjyqësore.

Këto vëzhgime duhet ta bëjnë të qartë se produkti përfundimtar, aktgjykimi, qoftë për shpallje të fajësisë apo të pafajësisë, dhe në veçanti arsyetimi i tij ligjor që e shpjegon dhe arsyeton këtë vendim, mund të mos ofrojë një pamje të plotë të ngjarjeve në shqyrtim dhe për këtë arsye nuk e përfaqëson domosdoshmërisht atë që quhet „e vërteta materiale” në rregullat e procedurës penale në Evropën kontinentale. Andaj, nuk është çudi që personat e shpallur fajtorë dhe të dënuar me burg, familjet

dhe komunitetet e tyre etnike, për të mos folur për „kombe” të tëra të cilëve ata deklarojnë se u „përkasin” ose të cilët ata konsiderohet si i „përfaqësojnë”, nuk do ta besojnë „të vërtetën” dhe rrjedhimisht drejtësinë e vendimit. Ose siç u shpreh një nga të paditurit para TPNJ-së: „Ju keni faktet tuaja. Ne kemi faktet tona. Ju keni të drejtën e plotë të zgjidhni ndërmjet dy versioneve ...”, duke shprehur kështu në mënyrë të përsosur hendekun mes njohurive dhe pranimit<sup>1</sup> të mundësive empirike dhe normative, të cilat duhet të përputhen për të krijuar legjitimitetin e cilësdo gjykate penale, qoftë lokale apo ndërkombëtare.

Por TPNJ-ja është kritikuar pak a shumë shumë edhe në literaturën akademike për shkak të mungesës së këtij legjitimiteti „sociologjik”.<sup>2</sup> Dënimet për fajësi si dhe për lirim u panë si tepër „të individualizuara dhe të dekontekstualizuara”<sup>3</sup> nga procedurat penale dhe, në fund të fundit, të shqiptuara pa programet e nevojshme informuese për t’ua shpjeguar shoqërive të ndryshme të shteteve pasardhëse të RSFJ-së. Kështu, siç argumentuan kritikët, gjykimet e tribunalit nuk u pranuan kurrë politikisht në shoqëritë përkatëse, siç tregojnë disa anketa të opinionit<sup>4</sup> dhe për këtë arsye nuk mund të kontribuojë në drejtësinë tranzicionale në aspektin e pajtimit pas konfliktit të dhunshëm ndëretnik.

*Pra, pse duhet të publikohet ky raport i dëshmitarit ekspert pothuajse 20 vjet më vonë?* Më shumë se tri dekada pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe të gjitha përpjekjeve ndërkombëtare për t’i parandaluar dhe ndaluar luftërat

- 
- 1 Në këtë mënyrë unë ndjek pikëpamjet teorike dhe empirike të Edith Marko-Stöckl, „E vërteta ime, e vërteta jote – të vërtetat tona? Roli i mësimdhënies së historisë dhe komisioneve për të vërtetën për pajtim në ish-Jugosllavi”, në: *Libri vjetor evropian i çështjeve të pakicave*, vëll. 7, 2007/8, Leiden-Boston 2010, 328 – 352, në veçanti në fq. 348-9.
  - 2 Harry Hobbs, „Tribunalet hibride dhe përbërja e gjykatave: Në kërkim të legjitimitetit sociologjik”, *Chicago Journal of International Law*, 16: 2 (2016), 482 – 522, në 494.
  - 3 Karen Engle, „Një gjenealogji e kthesës kriminale në të drejtat e njeriut”, në: Karen Engle et.al. (red.), *Agjenda kundër pandëshkueshmërisë dhe për të drejtat e njeriut*, Cambridge: Cambridge University Press 2016, 15 – 67, në 57.
  - 4 Milan Milanović (Milan Milanović), „Dështimi gjyqësor. Kur ka gjasa që publiku lokal t’u besojë Gjykatave Penale Ndërkombëtare?”, në: Kevin J. Heller et.al. (red.), *Doracaku i Oxford Handbook për Ligjin Penal Ndërkombëtar*, Oxford: Oxford University Press, 2020, 261-290. Shih gjithashtu, për shembull, Milica Kostić (Milica Kostić), „Anketa e Opinioneve Publike në Serbi hedh dritë mbi trashëgiminë e TPNJ-së”, 22 janar 2018, në [www.ejiltalk.org/public-opinion-survey-in-serbia-sheds-light-on-icty-legacy/](http://www.ejiltalk.org/public-opinion-survey-in-serbia-sheds-light-on-icty-legacy/), (qasur më 15 korrik 2023), ose Aidan Hehir, „Mësime të nxjerra? Mungesa e legjitimitetit lokal të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe implikimet e shkaktuara”, *Human Rights Review* (2019) 20: 267 – 287.

e ndryshme në territoret e shteteve pasardhëse të saj, si dhe për të mbështetur përmes „evropianizimit“ transformimin e tyre në shtete me sundim të ligjit, demokraci dhe ekonomi të tregut,<sup>5</sup> ngjarjet e fundit politike që kërcënojnë me dhunë masive në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë, por edhe ngjarjet në mbarë Evropën, na tregojnë se jemi duke dëshmuar të ashtuquajturin „regres demokratik“. Në vend të „stabilizimit të demokracisë“ siç ishte parashikuar nga „teoritë e transformimit“ në vitet 1990,<sup>6</sup> sërish po shohim populistë nacionalistë në pushtet, të cilët kanë vendosur regjimet e tyre autoritare nën etiketën eufemiste „demokracia joliberalë“ dhe duke e mbytur lirinë e informimit përmes shtypit dhe mediave të pavarura politikisht, duke manipuluar zgjedhjet e përgjithshme, si dhe duke i kapur burimet ekonomike të vendit përkatës. Në këtë mënyrë ata mund ta (keq) përdorin pushtetin pothuajse monopolist që e kanë fituar rishtazi në ekonomi dhe politikë, për formimin e një „lidshipi“ të fortë ekzekutiv dhe „reformën“ e gjyqësorit me qëllim stabilizimin e pushtetit politik të partisë së tyre politike apo të koalicionit qeverisës kundër ndryshimit të qeverisë dhe opozitës në zgjedhjet e ardhshme, çka është karakteristika bazë e pluralizmit politik si „esencë“ e demokracisë. Andaj, ia vlen të citojmë një raport të Institutit për Studime Evropiane në Beograd nga raporti i mëposhtëm i dëshmitarit ekspert në lidhje me kushtetutën serbe të vitit 1990:

„Kushtetuta e Serbisë e miratuar në vitin 1990, e cila ishte rezultat normativ i nacionalizmit autoritar dhe populist, është shembull paradigmatic i abuzimit të ligjit për të siguruar vazhdimësinë e një regjimi politik. ... forma e saj demokratike ... pritej të siguronte strukturën autoritare të qeverisjes bazuar në udhëheqjen e një njeriu. ... Parlamenti është kryesisht një simulim i demokracisë. Vendimet kryesore politike merren nga një person i vetëm, Presidenti i Republikës, ndërsa roli i Parlamentit është që këtyre vendimeve t'u japë një imazh të kushtetutshmërisë ... Regjimi ka nevojë për Kushtetutën, parlamentin dhe qeverinë në radhë të parë për të legalizuar dhe institucionalizuar pushtetin e vet.“<sup>7</sup>

---

5 Frank Schimmelfennig dhe Ulrich Sedelmeier, „Evropianizimi i Evropës Lindore: Shqyrtimi i Modelit të Stimujve të Jashtëm“, 22/23 qershor 2017, në [www.eui.eu/Documents/RSCAS/JMF-25-Presentation/Schimmelfennig-Sedelmeier-External-Incentives-Revisited-JMF.pdf](http://www.eui.eu/Documents/RSCAS/JMF-25-Presentation/Schimmelfennig-Sedelmeier-External-Incentives-Revisited-JMF.pdf) (qasur më 15 korrik 20213).

6 Wolfgang Merkel, *Transformimi i Sistemit*, Wiesbaden: VS Verlag für Sozialwissenschaften, 2nd ed., 2010.

7 Instituti për Studime Evropiane, *Konflikti Ndëretnik dhe Lufta në ish-Jugosllavi*, Beograd 1992, fq.23-4.

Si përfundim, a po bëjmë sërish të njëjtat gabime? Duke mos kuptuar se që nga fillimi pas rënies së regjimeve komuniste në Evropën Qendrore Lindore dhe Juglindore komunizmi nuk u zëvendësua domosdoshmërisht nga liberalizmi, demokracia dhe sistemet e tregut siç kishin parashikuar, ose për ta thënë më mirë, siç shpresonin teoritë e transformimit, por nga mobilizimi pak a shumë politik i elektoratit në baza të ndjenjave (etno-)kombëtare të cilat jo vetëm çuan në „divorc” paqësor të Çekosllovakisë, por edhe në konflikte dhe luftëra etnike në territoret e ish-RSFJ-së. Pas 30 vitesh punë si studiues dhe praktikues në fushën e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, me fokus të veçantë në Evropën Juglindore, kam bindjen e sigurtë se krijimi i kushtetutave për mekanizma të ndarjes së pushtetit, siç u bë në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë, është një përpjekje e nevojshme pas konfliktit të dhunshëm etnik. Por ndarja e pushtetit nuk është e mjaftueshme për të „ruajtur” paqe negative, për shembull, me forca paqeruajtëse të OKB-së të dislokuara në „zona tampon” dhe komunitete „etnike” të ndara territorialisht, institucionalisht dhe në arsim, siç ndodh edhe në Qipro edhe sot, pavarësisht se është një vend anëtar i BE-së prej gati njëzet vjetësh. Paqja pozitive në aspektin e bashkëjetesës dhe bashkëpunimit ndërtnik nuk mund të arrihet vetëm me masa ndëshkuese në drejtim të drejtësisë ndëshkuese, por ka nevojë për drejtësi restauruese përmes masave të pajtimit për të parandaluar „hakmarrjen ndër gjenerata”. Ose, siç u shpreh kjo nga Presidenti i parë i TPNJ-së, Antonio Cassese, „ ... ndjenjat e urrejtjes dhe pakënaqësisë që digjen në sipërfaqe, herët a vonë, do të shpërthejnë dhe do të çojnë në dhunë të përtërirë”.<sup>8</sup> Gjithashtu, Bashkimi Evropian e ka postulat se drejtësia tranzicionale do të jetë „pjesë integrale e ndërtimit të shtetit dhe paqes [që] duhet gjithashtu të ngulitet në reagimin më të gjerë ndaj krizave, parandalimin e konflikteve, sigurinë dhe përpjekjet zhvillimore të BE-së”.<sup>9</sup>

Andaj, publikimi i raportit të dëshmitarit ekspert i shërben një qëllimi të dyfishtë:

---

8 Cituar nga Anne Leebaw, „Qëllimet e Papajtuësme të Drejtësisë Tranzicionale”, *Human Rights Quarterly*, 30:1 (2008), 95 – 118, në 113.

9 BE, Korniza e Politikave të BE-së për Mbështetjen e Drejtësisë Tranzicionale, 16 nëntor 2015, në <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-13576-2015-INIT/en/pdf>. (qasur më 24 shtator 2023).



Së pari, kur gjyqtarët e vetëm ose panelet e gjyqtarëve „përcaktojnë faktet“, raporti do të tregojë se vendimi për atë që është e vërtetë apo jo nuk është i lehtë. Kështu, gjatë leximit të aktgjykimeve kundër Milan Milutinoviçit<sup>10</sup> dhe Slobodan Milloshoviçit<sup>11</sup> dhe arsyesimit ligjor të bazuar në dëshmitë dhe ekzaminimin e kryqëzuar të dëshmitarëve okularë, ky raport do të ndihmojë për t'i „kuptuar“ jo vetëm ndërlikimet e sistemit anglosakson të procedurës penale, por aq më tepër detajet faktike të përmendura nga këta dëshmitarë me më shumë apo më pak saktësi dhe, çka është më e rëndësishmja, provat faktike të *munguara* dhe të nevojshme për të siguruar një pasqyrë të plotë të ngjarjeve *përtej akteve të vetme dhe të fragmentuara* të vlerësuara nga gjyqtarët nëse kanë qenë vepra penale individuale apo jo. Leximi vetëm i këtyre aktgjykimeve pa një „përgjithësim narrativ“ të bazuar në një analizë „gjithëpërfshirëse“ — që rrjedh nga metodat shkencore që ofron ky raport — në të vërtetë do të krijojë një përshtypje të mirë pse „individualizimi“ i nevojshëm normativ dhe „dekontekstualizimi“ i pretenduar nga procedurat e TPNJ-së, nuk u „pranuan“ si përpjekje „për gjetjen e të vërtetës“ nga elitat politike dhe shoqëria në përgjithësi.

Një shembull që trajton temën e raportit të dëshmitarit ekspert, përkatësisht shfuqizimin e autonomisë territoriale të Kosovës të garantuar sipas kushtetutës federative jugosllave të vitit 1974, duhet të mjaftojë për qëllim të ilustrimit.

Më 3 maj 2002, ish-presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova, u thirr për të dëshmuar dhe për të raportuar për ngjarjet në lidhje me debatin parlamentar në Kuvendin e Kosovës për „pezullimin e statusit federativ të Kosovës, përkatësisht statusit autonom të Kosovës“ më 28 mars 1989.<sup>12</sup> Ai tregoi për presionin për faktin se në ndërtesën e Kuvendit kishte polici dhe deputetët duhej të votonin nën presion. Gjithashtu se kishte „demonstrata në këtë kohë, në 1989“ ku „disa u plagosën dhe rreth 20 u vranë“. Për më tepër, ai raportoi se u morën „masa të posaçme apo masa të jashtëzakonshme“ me „suspendimin e disa institucioneve“ dhe „vënien e kontrollit policor në Kosovë“. Për më tepër, „Policët shqiptarë të

---

10 TPNJ, Prokurori kundër Milutinoviçit e të tjerë, Lënda Nr. IT-05-87-T, 2009.

11 TPNJ, Prokurori kundër Milloshoviçit, Lënda Nr. IT-02-54-T, 2006.

12 Prokurori kundër Milloshoviçit, Lënda Nr. IT-02-54-T, Transkripti fq. 4191 – 4194.

Kosovës u pushuan nga puna, në vitin 1991 u pushuan të gjithë”. Në vijim ai raportoi për „Deklaratën Kushtetuese, apo Deklaratën për Pavarësi, e cila kërkon që Kosova të bëhet republikë e pavarur e barabartë me ish-republikat e tjera të ish-Federatës”.

Megjithatë, gjyqtari Robinson nuk u mjaftua me këtë përgjigje dhe i kërkoi „Dr. Rugovës” të sqarojë përgjigjen e tij lidhur me statusin kushtetues të Kosovës: „Në vitin 1990, Kosova e shpalli veten entitet të pavarur brenda Jugosllavisë, e barabartë me republikat e tjera. Ky është një status që duhet dalluar nga pavarësia.” Në përgjigjen e tij, „dëshmitari” përsëriti: „Ne e shpallëm Kosovën — në atë kohë ekzistonte ende ish-Jugosllavia, Federata, dhe kështu, edhe Kosova duke qenë republikë ose shtet i pavarur, do të kishte marrëdhënie me republikat e tjera”.<sup>13</sup> Nuk është befasi që Slobodan Millosheviqi në ekzaminimin e tij të kryqëzuar iu kthye pyetjes nëse Ibrahim Rugova po i referohej Kosovës që bëhej një republikë e barabartë brenda kornizës së RSFJ-së apo shtet i pavarur përmes shkëputjes nga „Serbia”.<sup>14</sup>

Pra, a është e mundur që në bazë të kësaj dëshmie të dëshmitarit dhe ekzaminimit të kryqëzuar të „përcaktohen faktet” pa shpjeguar doktrinat e të drejtës ndërkombëtare publike dhe të drejtës kushtetuese të RSFJ-së në lidhje me çështjen nëse parimet e sovranitetit të shteteve dhe të vetë-vendosjes së popujve e përfshijnë ndarjen, siç bën raporti im si dëshmitar ekspert? Dhe cili mund të ketë qenë dallimi mes „masave të posaçme dhe masave të jashtëzakonshme” që sqarohet edhe nga raporti? Sa i përket hamendësimit të shifrave të policëve dhe punonjësve të tjerë të pushuar nga puna, raporti im përpiket t’u përgjigjet të gjitha këtyre pyetjeve ligjore dhe empirike në bazë të hulumtimit të kujdesshëm të burimeve të marra nga vetë Gazetat Zyrtare të Serbisë dhe Kosovës. Meqë ra fjala, kjo vërteton deklaratën e Institutit për Studime Evropiane në Beograd të cituar më sipër për përpjekjet e regjimit për t’i „legalizuar” masat e veta antikushtetuese.

---

13 Prokurori kundër Millosheviq, Lënda Nr. IT-02-54-T, Transkript fq. 4205.

14 Prokurori kundër Millosheviq, Lënda Nr. IT-02-54-T, Transkripti fq. 4298 – 4309.

Kështu, nuk është befasi që anketat e opinionit në Serbi dhe Kosovë të cituara më lart e konfirmojnë refuzimin e gjetjeve të TPNJ-së dhe tribunaleve të tjera penale për shkak të *anshmërisë etnike* të formave të dëshiruara të drejtësisë që janë thelbësisht të papajtueshme kur, për shembull, serbët në Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe në Kosovë, me të drejtë pretendojnë se konflikti nuk ishte i njëanshëm dhe se krimet janë kryer nga „të dyja palët”. Megjithatë, ajo që i kthen këto pretendime në një *barazim të pajustificueshëm të krimeve*, duke *mjegulluar kështu vijat ndarëse mes agresorit dhe viktimeve* apo edhe duke çuar në përmbysjen e kësaj marrëdhënieje, janë pretendimet për *reciprocitetin* matematikor etnik të personave nën aktakuzë dhe vendimeve të fajësisë dhe lirimit përmes gjykatave që çojnë në pohimin se anëtarët e vetë grupit do të ishin viktimat „e vërteta” nëse nuk do të bëhej kështu. Andaj, në fund, kriminelët e luftës të shpallur fajtorë për gjenocid mbeten „heronj” të popullit të tyre, siç e dëshmojnë festimet për Ratko Mlladiqin (Ratko Mladić) në Republikën Srpska dhe Beograd në vitet e fundit.

Milan Milanoviq (Milan Milanović) përpiqet të shpjegojë pse TPNJ-ja ishte e destinuar të dështonte që në fillim, pasi që faktorët e etnifikimit dhe polarizimit të shoqërisë nuk është se u zhdukën me përfundimin e luftërave. Ai i përmbledh gjetjet e tij me faktorët parashikues të mëposhtëm: *Kohezioni i grupeve etnike* dhe *polarizimi* mbetën të pandryshuar. Dhe, për mendimin tim, edhe për shkak të aranzhimeve të rrepta institucionale për ndarjen e pushtetit si në Bosnjë dhe Hercegovinë<sup>15</sup> ashtu edhe në Kosovë<sup>16</sup>, të cilat i „çimentojnë” ndarjet etnike të shoqërisë. Për më tepër, në konfliktet e nxitura nga etno-nacionalizmi, *vazhdimësia e elitës* kërkon ruajtjen e narrativave të ngulitura nacionaliste. Kryeministri dhe më pas presidenti i Republikës së Serbisë nga viti 2014 e tutje, Aleksandër Vuçiq (Aleksandar Vučić), ishte ish-ministër i Informacionit në regjimin e Millosheviqit; po ashtu Bakir Izetbegoviç (Bakir Izetbegović), djali i presidentit boshnjak të kohës së luftës, Alija Izetbegoviç (Alija Izetbegović), si dhe kryeministri dhe

---

15 Shih Joseph Marko, „Demokrati me defekte në një shtet të dështuar? Krijimi i urave mes dizajnit kushtetues, politikës dhe ndarjeve etnike në Bosnjë dhe Hercegovinë”, në: Yash Ghai dhe Sophia Woodman (red.), *Praktikimi i Vetëqeverisjes*, Cambridge: Cambridge University Press 2013, fq. 281 – 314.

16 Shih Joseph Marko, „Kushtetuta e re e Kosovës në një këndvështrim krahasues rajonal”, *Review of Central and East European Law*, 33 (2008), fq. 437 – 450.

presidenti Hashim Thaçi, një nga ish-udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), mund të shërbejnë si shembuj të mirë për këtë vazhdimësi të elitave. Për fund, ka një trend drejt *autoritarizmit*, duke përfshirë *kërcënimet* kundër pikëpamjeve alternative të shprehura në media dhe edukim publik dhe shtypjen e tyre,<sup>17</sup> e që në rastin më të mirë kjo çon në marginalizimin e një „opozite parlamentare“ të dobët dhe të fragmentuar, por në rastin më të keq në zhdukjen e plotë të pluralizmit politik. Milanović vjen kështu në përfundimin paraprak: „Ekziston, me fjalë të tjera, gjithmonë një lloj narrative grupore tek e cila kapen anshmëritë kognitive – çfarë ndryshon është ajo se që bëjnë personat në pushtet me këto anshmëri. Në rastin më të keq, siç ndodhi në ish-Jugosllavi, ata do të lehtësojnë krijimin e realiteteve specifike të grupeve, në të cilat puna e gjykatës apo tribunalit penal ndërkombëtar të diskredituar nga elita do të jetë e paaftë për të depërtuar.”<sup>18</sup>

Për më tepër, siç analizohet më hollësisht në literaturën akademike, ky ishte dhe është problem jo vetëm i procedurave të gjykatave dhe programeve të informimit, por edhe i donatorëve ndërkombëtarë si SHBA dhe BE, si dhe pasqyrojnë ideologjitë e reja nacionaliste të elitat politike të shteteve pasardhëse dhe regresin e tyre demokratik si pasojë e populizmit nationalist-autoritar dhe për rrjedhojë mungesën e mbështetjes së tribunaleve ndërkombëtare nga qeveritë, si në Serbi ashtu edhe në Kosovë.<sup>19</sup> Problematike është edhe mungesa e mbështetjes efektive e shoqërisë civile nga qeveritë apo donatorët ndërkombëtarë për ta kapërcyer të menduarit binar etno-nationalist dhe fashist në terma të „ne kundër armiqve“ (C. Schmitt).

Së fundi, synimi i dytë i kësaj parathënie është të trajtohen sfidat mbi mënyrat se si duhet të ofrohet mësimdhënia e historisë së luftërave të viteve 1990-a, çfarë përbën problem për mbështetjen e drejtësisë tranzicionale përmes pajtimit. Siç ka raportuar Edith Marko-Stöckl në vitin 2010, qasja e parë e përdorur nga OSBE-ja në Bosnjë dhe

---

17 Shih, për shembull, raportin e fundit të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, *Serbia: Shoqëri e kapur*, Beograd 2023.

18 Milanović, *Dështimi gjyqësor*, 267.

19 Shih, në veçanti, analizën dhe konkluzionet e Gëzim Visokës, „Vlerësimi i ndikimit të mundshëm të Gjykatës Speciale të Kosovës“, shtator 2017, në veçanti fq. 27 – 30, në [www.paxforpeace.nl](http://www.paxforpeace.nl). (qasur më 15 korrik 2023).

Hercegovinë ishte t'i nxinte fjalët, fjalitë ose paragrafët e inkriminuar në tekstet shkollore për nxënësit e shkollave filllore dhe të mesme. Ashtu siç mund të imagjinohej, kjo madje rriti kureshtjen e nxënësve për t'i zbuluar „vetë” ato „fakte” që nuk kishin leje t'i lexonin. Kështu, nën drejtimin e OSBE-së, në vitin 2004 u krijua një komision lokal për zhvillimin e udhëzimeve për shkrimin e teksteve shkollore për lëndën e historisë dhe gjeografisë, i cili përfundimisht botoi „Udhëzuesin për shkrimin dhe vlerësimin e teksteve të historisë për shkollat filllore dhe të mesme në Bosnjë dhe Hercegovinë” që kërkonte zbatimin e parimit të këndvështrimeve të shumëfishta për t'u mundësuar nxënësve të mësojnë tolerancën.<sup>20</sup>

Sidoqoftë, një studim i kohëve të fundit mbi materialet për mësimdhënie të historisë për raportin e OSBE-së „për mësimnxënien dhe mësimdhënien në lidhje me periudhën 1992 – 1995 në shkollat filllore në mbarë Bosnjë dhe Hercegovinë”<sup>21</sup>, paraqet rezultate demoralizuese. Autorja thekson gjetjet e saj kyçe të konstatuara më shumë se njëzet e pesë vjet pas përfundimit të luftës:

„ ... • Tekstet dhe materialet e mësimdhënies të analizuarra janë etnocentrike dhe zhvillojnë tre narrativa që përjashtojnë njëra-tjetrën.

• ... [Ato] kontribuojnë në politizimin dhe instrumentalizimin e së shkuarës në vend të mirëkuptimit të ndërsjellë dhe pajtimit.

• Të gjitha i rrëfejnë vitet 1990 të mbushura me konflikte pothuajse ekskluzivisht si vite të viktimizimit 'të tyre', promovojnë dhimbshurinë vetëm ndaj popullit 'të tyre', si dhe e portretizojnë palën 'tjetër' pothuajse ekskluzivisht si kryes të dhunës.

• Zbatimi i këndvështrimeve të shumëfishta dhe rezultateve përkatëse të të nxënësve nuk është qasje mbizotëruese në asnjë nga tekstet shkollore dhe materialet e mësimdhënies të analizuarra.

---

20 Marko-Stöckl, *E vërteta ime, e vërteta jote – të vërtetat tona?*, në 339.

21 Heike Karge, *Materialet për mësimdhënie të historisë në lidhje me vitet 1992 – 1995 në Bosnjë dhe Hercegovinë: ndërtimi i besimit ose thellimi i ndasive*, Sarajevë 2022.

- Aty ku janë të pranishme, këndvështrimet e shumëfishta dhe të menduarit kritik nuk janë të dizajnuara për të sfiduar veprimet e anëtarëve të popullit ‘të cilit i përkasin’ nxënësit.”

Fatkeqësisht, raportet për mësimdhënien e historisë në Kosovë dalin me të njëjtat rezultate me konstatimin se arsimit kosovar i historisë ka nevojë për ndryshim.<sup>22</sup> Këto raporte duhen parë si paralajmërim! Përfundimi i vetëm, të cilin të gjithë akterët ndërkombëtarë, jo vetëm OSBE-ja, por edhe organet e ndryshme të BE-së, e kanë të vështirë ta shmangin është se: Në kundërshtim me të gjitha rekomandimet dhe udhëzimet ndërkombëtare për qasjen me këndvështrime të shumëfishta dhe të menduarit kritik, hakmarrja gjeneracionale është e ngulitur te nxënësit edhe sot e kësaj dite, duke krijuar terrenin për spirale të ripërtëritura të konflikteve të dhunshme.

Si analizë finale, bashkëpunimi me nacionalistët autoritarë nuk është garanci për stabilitet politik, por pikërisht e kundërta! Tanimë nuk na duhet një dizajn institucional edhe më i rafinuar për ndarje të pushtetit me kuota etnike, por riedukim në të gjitha nivelet për të shpjeguar avantazhet e sundimit të ligjit bazuar në të drejtat e njeriut dhe të pakicave nga një sistem gjyqësor që është efektiv, i pavarur dhe i paanshëm politikisht dhe etnikisht, si parakusht për shoqëri multietnike, siç proklamohet për Kosovën në nenin 3 të Kushtetutës së saj. Andaj, jam optimist se raporti im si dëshmitar ekspert, përmes analizës së tij gjithëpërfshirëse dhe me shumë faktorë, mund të kontribuojë në qasjen e kërkuar të këndvështrimeve të shumëfishta për të menduarit kritik edhe në përpjekjet e ardhshme në edukim.

---

22 Shih Abit Hoxha dhe Anna di Lellio, „A je partizan apo çetnik. Mësimdhënia e historisë në shkollat serbe në Kosovë”, 13 shkurt 2017, në <https://sbunker.net/op-ed/88663/are-you-a-partisan-or-a-chetnik-teaching-history-in-kosovo-serbian-schools/> (qasur më 15 korrik 2023); Joanna Hanson, „Edukimi për historinë kosovare ka nevojë për ndryshim”, 9. 4. 2019, në <https://kosovotwopointzero.com/en/kosovar-history-education-needs-a-change/> (qasur më 15 korrik 2023); Rodoljub Jovanović (Rodoljub Jovanović), „Të arrijmë paqen përmes mësimdhënies për luftën: Si e japin luftën e Kosovës mësimdhënësit e historisë në Kosovë?”, në: Ioannis Armakolas et al. (red.), *Përballja me kriza të shumëfishta: Këndvështrimet lokale dhe ndërkombëtare për politikëbërjen në Kosovë*, Prishtinë: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur 2022, fq. 111 – 144.

Në fund të kësaj parathënie, dëshiroj të falënderoj ish studentin tim në Universitetin e Grazit dhe tani profesorin e Shkencës Politike në Universitetin e Prishtinës, Dr. Arben Hajrullahu, jo vetëm që mori iniciativën për publikimin e kësaj ekspertize dhe mbikëqyri përkthimin në gjuhën shqipe, por edhe për shumë diskutime të frytshme gjatë dekadave të fundit dhe miqësinë e tij të kahershme. Një falënderim i madh shkon edhe për Menaxherin e Programeve të zyrës në Kosovë të Fondacionit-Konrad-Adenauer, Granit Tërnavë, për gatishmërinë e tij për mbështetjen e këtij projekti dhe për përkthyesit në gjuhën shqipe dhe serbe. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, falënderimet e mia shkojnë edhe për tjetërin ish studentin dhe mikun tim të vjetër, Dr. Marko Kmezić, tani Hulumtues i Lartë në Qendrën për Studime të Evropës Juglindore në Universitetin e Gracit, i cili mbikëqyri përkthimin në gjuhën serbe.





# Raporti i dëshmitarit ekspert për çështje kushtetuese dhe juridike në lëndën MOS

---

Nga Joseph Marko/Graz-Bolzano

## Përmbledhje ekzekutive

---

### 1. Rrënimi i Autonomisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

---

#### 1.1. Zhvillimet Kushtetuese

- 1.1.1. Statusi i republikave dhe krahinave autonome të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë sipas sistemit kushtetues të vitit 1974
- 1.1.2. E drejta për vetëvendosje duke përfshirë shkëputjen sipas Kushtetutës së RSFJ-së
- 1.1.3. Amendamentet e Kushtetutës Federative dhe të Republikës në 1988 dhe 1989
- 1.1.4. Kushtetuta e re serbe e vitit 1990
- 1.1.5. Kushtetuta e re e Republikës Federative të Jugosllavisë e vitit 1992

#### 1.2 Programet, Ligjet dhe Vendimet e Republikës së Serbisë për heqjen e Autonomisë së Kosovës

- 1.2.1. „Ligji për Punë të Brendshme”
- 1.2.2. „Programi për realizimin e paqes, lirisë, barazisë, demokracisë dhe prosperitetit të KSA të Kosovës”
- 1.2.3. „Ligji për veprimet e agjencive të republikës në rrethana të posaçme”
- 1.2.4. „Ligji për ndërprerjen e punës së Kuvendit dhe Këshillit Ekzekutiv të KSA të Kosovës”

1.2.5. „Ligji për pezullimin e kryesisë së KSA të Kosovës”, shkarkimin e anëtarit nga Kosova në Kryesinë e RSFJ-së dhe shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

1.2.6. „Ligji për marrëdhëniet e punës në rrethana të posaçme”

1.2.7. Heqja e Autonomisë së Kosovës

### 1.3. Konkluzione

## 2. Pozita dhe kompetencat e organeve të ndryshme shtetërore sipas Kushtetutës së Serbisë të vitit 1990 dhe Kushtetutës së RFJ-së të vitit 1992 dhe legjislacionit përkatës

---

2.1. Presidenti i Republikës Federative të Jugosllavisë

2.2. Presidenti i Republikës së Serbisë

2.3. Zëvendëskryeministri i RFJ-së

2.4. Ministri i Brendshëm i Serbisë

2.5. Komanda Supreme dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Jugosllavisë

2.6. Këshilli Suprem i Mbrojtjes

2.7. Departamenti Shtetëror i Sigurisë, Departamenti i Sigurisë Publike dhe Stafi i MUP-it në Kosovë dhe Metohi

2.8. Konkluzione

## 3. Detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare në lidhje me konfliktin e Kosovës

---

3.1. Traktatet ndërkombëtare detyruese për RFJ-në dhe zbatimi i tyre në të drejtën e brendshme

3.2. Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Sigurimit

3.3. Konkluzione

# Përmbledhje ekzekutive

## Rrënimi i Autonomisë së KSA të Kosovës

1. Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974 solli barazimin e plotë të institucioneve të Republikave dhe Krahinave Socialiste Autonome (KSA) dhe i dha secilës të njëjtin status konstitutiv në nivel të Federatës në proceset vendimmarrëse në institucionet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. I vetmi dallim i rëndësishëm mes Republikave dhe KSA-ve mbeti karakterizimi i republikave si shtete ndërsa KSA-të quheshin komunitete socio-politike. Në lidhje me dallimin ndërmjet kombeve dhe kombësive, në doktrinën kushtetuese jugosllave u nxorr përfundimi se të drejtën e vetëvendosjes duke përfshirë shkëputjen e kishin vetëm kombet dhe për rrjedhojë Republikat, por jo kombësitë dhe Krahinat Autonome.

2. Sistemi kushtetues i vitit 1974 u kritikua nga juristët kushtetues serbë si federativizëm asimetrik që diskriminonte Republikën Socialiste të Serbisë (RSS). Këto kritika dhe pretendime të serbëve të Kosovës u përvetësuan nga Lidhja e Komunistëve të Serbisë pasi që Slobodan Millosheviqi u bë kryetar i partisë dhe i largoi kundërshtarët e tij. Përpjekjet e para për ta kapërcyer asimetrinë e pretenduar të Kushtetutës së RSFJ-së ishin propozimet për ndryshimin e Kushtetutës së RSFJ-së në vitin 1987. Megjithatë, u shtynë reformat më të mëdha të marrëdhënieve federative dhe marrëdhënieve mes RSS-së dhe KSA-ve. Ndryshimet e miratuara në vitin 1988 sollën vetëm rregullime të vogla, por i lanë të paprekura institucionet dhe kompetencat e KSA-ve.

3. Në procesin paralel të ndryshimit të Kushtetutës së RSS-së në 1988 dhe 1989, shumë kompetenca dhe institucione të KSA-ve do të kalonin në varësi të institucioneve të republikës. Kjo hasi në rezistencë të ashpër politike në radhët e partive komuniste në Vojvodinë dhe në Kosovë. Rezistenca u mposht nga demonstratat masive që çuan në dorëheqjen e drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe partiake jo vetëm në Vojvodinë dhe Kosovë, por edhe në Mal të Zi. Më në fund, ndryshimet u miratuan nga Kuvendi i Kosovës në mars të vitit 1989 pasi ishte shpallur „gjendja e jashtëzakonshme”. Këto ngjarje ngrenë dyshime serioze për

legjitimitetin e këtyre ndryshimeve kushtetuese. Nga këndvështrimi i së drejtës kushtetuese jugosllave, ndryshimet vërtet i kaluan institucionet e KSA-ve në varësi të institucioneve të republikës dhe në këtë mënyrë dobësuan kompetencat e KSA-ve, por ato nuk ishin në kundërshtim me Kushtetutën e RSFJ-së.

4. Kushtetuta e re e Republikës së Serbisë e miratuar në shtator të vitit 1990 e uli autonomitë territoriale të Vojvodinës dhe Kosovës nën nivelin e vetëqeverisjes lokale. Kuvendet e tyre e humbën fuqinë kushtetuese dhe legjislative. Presidentat, Gjykatat Supreme dhe Kushtetuese u shfuqizuan. Kjo ishte shkelje e Kushtetutës ende të vlefshme të RSFJ-së e cila i garantonte këto institucione. Për më tepër, kushtetuta nuk kishte lidhje institucionale me nivelin federativ dhe nga Slobodan Millosheviqi mendonte të siguronte kornizën ligjore për një shtet serb të pavarur. U ngritën kritika politike dhe shkencore kundër kompetencave unike të Presidentit të Republikës gjatë „gjendjes së jashtëzakonshme”.

5. Kushtetuta e re e Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ) e miratuar në vitin 1992 nuk i përmend më KA-të. Për dallim nga Kushtetuta e RSFJ-së, ato nuk kanë më garanci kushtetuese me Kushtetutën Federative. Miratimi i kësaj kushtetute të re, për çka nuk u ndoq procedurën e paraparë në Kushtetutën e RSFJ-së, ngre dyshime serioze për legjitimitetin e kësaj kushtetute.

6. Pas amendamenteve të kushtetutës së RSS-së në vitin 1989, kuvendi serb filloi të ri-centralizojë policinë me legjislacion të zakonshëm. Në mars të vitit 1990 Kuvendi miratoi „Programin për realizimin e paqes, lirisë, barazisë, demokracisë dhe prosperitetit të KSA të Kosovës” dhe „Planin Operativ”. Siç shihet nga masat e propozuara, ata donin të merrnin kontrollin e plotë të pothuajse çdo aspekti të jetës në KA të Kosovës dhe të ndryshonin ekuilibrin etnik duke ofruar një program kthimi për serbët dhe malazetë që kishin emigruar. Për shkak të rezistencës së përfaqësuesve shqiptarë të Kuvendit të Kosovës dhe popullatës vendase shqiptare, ky plan u zbatua në vitet 1990 dhe 1991 duke i shfuqizuar me disa ligje institucionet e garantuara me kushtetutë të krahinës. Pozitat udhëheqëse në institucionet administrative, gjyqësore dhe komunale, si dhe pozitat e tjera në ekonomi, shërbim shëndetësor, arsim, televizion dhe radio, u spastruan nga shqiptarët e Kosovës. Këto ligje dhe vendime

të Kuvendit të Serbisë de jure e hoqën autonominë e Kosovës, por jo edhe të Vojvodinës. Kjo ishte në kundërshtim me Kushtetutën e RSFJ-së edhe para miratimit të Kushtetutës së re të Republikës së Serbisë. Mirëpo, siç tregojnë qartë „Programi” dhe „Plani Operativ” dhe 250 vendimet e zbatuara në vitin 1990, këto masa nuk mund të kenë qenë një reagim spontan i Kuvendit të Serbisë. Ato duhet të jenë planifikuar sistematikisht kohë më parë.

### **Kompetencat e organeve të ndryshme shtetërore**

7. Presidenti i RFJ-së ka pozicion të fortë ligjor duke i bashkuar dispozitat e kushtetutës serbe të vitit 1990, kushtetutës së RFJ-së të vitit 1992 dhe legjislacionit përkatës. Në fakt, kështu ai mund të dominonte gjithë procesin e vendimmarrjes nga përcaktimi i gjendjes së luftës deri te komanda operative e Ushtrisë Jugosllave.

8. Dispozitat e paqarta kushtetuese në lidhje me autoritetin komandues të Presidentit të RFJ-së dhe Presidentit të Republikës së Serbisë mbi „forcat e armatosura” mund të harmonizohen me interpretim. Kështu që Presidenti i RFJ-së komandon Ushtrinë Jugosllave, ndërsa Presidenti i Republikës së Serbisë komandon mbrojtjen territoriale të Serbisë.

9. Dispozitat e kushtetutës së RFJ-së dhe kushtetutës serbe në lidhje me shpalljen e gjendjes së luftës nuk janë të harmonizuara.

10. Në lidhje me vartësinë e MUP-it dhe forcave policore, dispozitat përkatëse të Ligjit Jugosllav për Mbrojtjen dhe Ligjit Serb për Mbrojtjen dhe Ligjit për Punët e Brendshme, nuk janë të harmonizuara.

### **Detyrimet ndërkombëtare të RFJ-së**

11. RSFJ-ja ishte e detyruar t’i përmbahej të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe ligjeve ndërkombëtare të luftës si nënshkruese e shumë konventave ndërkombëtare si Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollat e tyre Shtesë të vitit 1977, Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, Konventa Ndërkombëtare për të

Drejtat Civile dhe Politike e vitit 1966 ose Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese. Këto konventa ishin gjithashtu të detyrueshme për RFJ-në si nga këndvështrimi i së drejtës kushtetuese ashtu edhe nga e drejta ndërkombëtare publike dhe u inkorporuan në rendin juridik të brendshëm.

12. Në lidhje me dispozitat përkatëse, Presidenti i RFJ-së ishte i detyruar të urdhërojë hetim të plotë dhe të iniciojë procedurë para gjykatës ushtarake. Meqenëse Presidenti i RFJ-së ishte përgjegjës „për të mbikëqyrur zbatimin e sistemit komandues” (neni 4 i Ligjit për Ushtrinë Jugosllave), ai kishte një detyrë pozitive ligjore për të mbikëqyrur veprimet e Ushtrisë dhe nuk mund të priste vetëm raportet.

13. Ndërmjet dhjetorit 1992 dhe dhjetorit 1998, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një numër të rezolutave ku shprehu shqetësime të mëdha për situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Në ato rezoluta, Asambleja e Përgjithshme u kërkoi autoriteteve në Republikën Federative të Jugosllavisë që të marrin të gjitha masat e nevojshme për t’i dhënë fund menjëherë këto shkelje të të drejtave të njeriut, për të revokuar të gjithë legjislacionin diskriminues dhe për të rivendosur institucionet demokratike të Kosovës, duke përfshirë Kuvendin dhe gjyqësorin.

14. Megjithatë, përkundër faktit se asnjë nga rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme nuk pati ndonjë efekt pozitiv, Këshilli i Sigurimit i OKB-së filloi të miratonte rezoluta vetëm në mars të vitit 1998. Në një seri të rezolutave pas kësaj rezolute të parë, KS kërkoi që RFJ të ndalojë të gjitha veprimet e forcave të sigurisë kundër popullatës civile dhe të sjellë para drejtësisë ata anëtarë të forcave të sigurisë përgjegjës për keqtrajtimin e civilëve dhe shkatërrimin e pronës, si dhe të ndërmarrë menjëherë të gjitha hapat për arritjen e një zgjidhje politike dhe për të bashkëpunuar me TPNJ-në. Sidoqoftë, RFJ nuk e respektoi asnjë nga kërkesat e KS-së. Më në fund, REZ 1244 KS e 10 qershorit 1999 krijoi bazën për themelimin e UNMIK-ut, i cili mori përsipër të gjithë pushtetin legjislativ, administrativ dhe gjyqësor në Kosovë.

# 1 Rrënimi i Autonomisë së KSA të Kosovës

## 1.1. Zhvillimet Kushtetuese

### 1.1.1. Statusi i republikave dhe krahinave autonome të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë sipas sistemit kushtetues të vitit 1974

15. Duke u kthyer prapa në historinë e zhvillimit kushtetues të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) pas vitit 1945, duhet të merret parasysh se sistemi i autonomisë territoriale si mjet akomodimi ndëretnik ishte marrë nga modeli sovjetik me një hierarki e njërive territoriale.<sup>23</sup> Kështu, me kushtetutën e parë federative jugosllave të vitit 1946<sup>24</sup> u krijuan gjashtë Republika Socialiste dhe dy njësi territoriale autonome në kuadër të Republikës Socialiste të Serbisë (RSS), përkatësisht Vojvodina dhe Kosova<sup>25</sup>. Teksa Vojvodinës iu dha statusi i krahinës autonome që në fillim, Kosovës së pari iu dha statusi i rajonit autonom.

23 Për zhvillimin e formave të autonomisë territoriale në Bashkimin Sovjetik shih Wolfram Gärtner, *Die Erscheinungsformen der Sowjetautonomie (Format e Autonomisë Sovjetike)*, *Recht in Ost und West* 1990, fq. 228 – 238. Ratko Marković (Ratko Marković), *Krahinat Autonome në Sistemin Kushtetues Bashkëkohor të RSFJ-së*, *Yugoslav Law* 1985, fq. 125 deklaroi se modeli sovjetik kishte qenë një model për kushtetutën jugosllave të vitit 1946.

24 Teksti i Kushtetutës Federative Jugosllave të vitit 1946 dhe 1963 mund të gjendet në përkthim në anglisht në Jan F. Triska (red.), *Kushtetutat e Shteteve Komuniste*, Stanford 1968, fq. 453 – 541.

25 Në vijim do të përdoren tri emra për të njëjtin territor: Në anglisht dhe sipas sistemit kushtetues të vitit 1974 në gjuhën serbo-kroate emri është Kosovë. Në shqip dhe për rrjedhojë sipas burimeve shqiptare emri i krahinës është Kosova. Vetëm me kushtetutën serbe të vitit 1990, krahinës iu dha (përsëri) emri Kosova dhe Metohija në serbisht.

16. Megjithatë, në aspektin e pushteteve dhe institucioneve pozita kushtetuese e Kosovës – në rrjedhën e viteve 1960 – gradualisht „u ngrit” në krahinë.<sup>26</sup> Me miratimin e kushtetutës së re të RSFJ-së dhe kushtetutave të Republikave dhe Krahinave Socialiste Autonome (KSA) në vitin 1974<sup>27</sup>, ky proces i ngritjes mori fund me barazimin institucional të republikave dhe KSA-ve.

17. Për sa u përket institucioneve të KSA-ve, ato kishin këto institucione: Ato kishin parlamente, të quajtura kuvende (neni 300 i Kushtetutës të KSA të Kosovës), me kompetenca kushtetuese dhe legjislativë. Ato kishin kryesi (neni 309) të përbërë nga një kryetar dhe tetë anëtarë. Kryetari i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës është ex officio anëtar i Kryesisë (neni 343, paragrafi 4). Ato kishin qeveri, të ashtuquajturat këshilla ekzekutive (neni 349) dhe organe administrative (neni 362). Dhe më në fund, ato kishin një sistem gjyqësor të plotë me gjykata të zakonshme (neni 237) duke përfshirë gjykatat supreme (neni 390) dhe, përveç kësaj, gjykatat kushtetuese (neni 372).

18. Në nivel federativ, Republikat dhe KSA-të ishin — si entitete të veçanta — të përfaqësuara drejtpërdrejt<sup>28</sup> në institucionet federative përmes delegacioneve ose në bazë të parimit të barazisë (Presidenca, neni 321 Kushtetuta e RSFJ-së) ose parimit të proporcionalitetit (të dy dhomat e Parlamentit, nenet 291 dhe 292, Këshilli Ekzekutiv, neni 348, Gjykata Supreme, neni 370 dhe Gjykata Kushtetuese, neni 375 pika 6).

19. Për sa i përket ndikimit të tyre në procesin e vendimmarrjes, çdo amendament i Kushtetutës Federative ishte i mundur vetëm me

---

26 Për zhvillimin e krahinave autonome në sistemin kushtetues para vitit 1974, shih Jovan Gjorgjeviq (Jovan Đorđević), *Ustavno Pravo (E Drejta Kushtetuese)*, Beograd 1984, fq. 663 – 684.

27 Tekstet e këtyre kushtetutave gjenden në *Ustavi i ustavnih zakona. Prvi dio. Tekstovi ustava i ustavnih zakona* (Kushtetutat dhe ligjet kushtetuese. Pjesa 1. Tekstet e kushtetutave dhe ligjeve kushtetuese), Informator, Zagreb 1974. Një përkthim në anglisht i kushtetutës së RSFJ-së është botuar në Albert P. Blaustein/Gisbert H. Flanz (red.), *Kushtetutat e vendeve të botës*. Jugosllavi, mars 1986 (Oceana Publications).

28 Kjo do të thotë jo përmes delegimit nëpër organe të Republikës. Sipas teorisë së sistemit sovjetik të delegimit nga sovjetet në nivelin më të ulët territorial në Sovjetin Suprem, përfaqësuesit zgjidhen në mënyrë indirekte, pra të deleguar, nga një nivel në tjetrin. Kjo do të thotë se parlamentet e KSA-ve duhej të zgjidhnin përfaqësuesit e tyre në Parlamentin e Republikës, i cili nga ana e tij zgjedh përfaqësuesit e tij në Parlamentin Federativ. Megjithatë, në sistemin jugosllav, parlamentet e KSA-ve i zgjidhnin përfaqësuesit e tyre drejtpërdrejt në Parlamentin Federativ. E njëjta gjë vlen edhe për Këshillin Ekzekutiv Federativ dhe Presidencën Federative.



pëlqimin e Kuvendeve të KSA-ve (nenet 398 dhe 402 të Kushtetutës së RSFJ-së) dhe ato kishin të njëjtën të drejtë të vetos absolute në lidhje me amendamentet e Kushtetutës së Serbisë (neni 427 i kushtetutës serbe). Për më tepër, ata kishin të drejtën e vetos kundër lidhjes së traktateve ndërkombëtare, nëse kompetencat e tyre prekeshin nga kushtet e traktateve (neni 271 i Kushtetutës së RSFJ-së).

20. Për më tepër, statusi i të dy KSA-ve ishte i garantuar nga Kushtetuta Federative.

Kjo mund të shihet nga dispozita e nenit 5 të Kushtetutës së RSFJ-së e cila kërkon pëlqimin e KSA-ve për çdo ndryshim të territoreve dhe kufijve të tyre si dhe kufijve të vetë RSFJ-së.

21. Gjithashtu, institucionet e mëposhtme të KSA-ve janë të garantuara me kushtetutën e RSFJ-së: Kuvendet (nenet 132, 300), Kryesitë (neni 147), Këshillat Ekzekutivë (nenet 148, 276), Organet Administrative (neni 149) dhe Gjykatat (Nenet 222, 371 Gjykatat Supreme të KSA-ve), Prokuroritë (neni 235) dhe Bankat Kombëtare (neni 260). Për zbatimin e ligjit federativ në territorin e KSA-ve, vetëm organet administrative të KSA-ve janë kompetente pa ndërhyrje nga organet administrative të Republikës (nenet 273, 274).

22. Megjithëse formalisht ekzistonte një hierarki juridike midis Federatës dhe Republikave, d.m.th. kushtetutat dhe ligjet e republikave duhej të ishin në përputhje me kushtetutën federative, Gjykata Kushtetuese e Federatës nuk ishte e autorizuar të shpallte si të pavlefshme dispozitat e një kushtetute të një republike ose KSA të cilat i konsideronte jokushtetuese. Për këtë çështje Gjykata mund t'i jepte vetëm një opinion këshillues Parlamentit Federativ (neni 378 i Kushtetutës së RSFJ-së).<sup>29</sup> Vetëm në rast mospërputhjeje të ligjeve të republikave dhe të KSA-ve me kushtetutën federative ose me ligjet federative, parlamenti përkatës kishte fillimisht detyrimin që dispozitën antikushtetuese ose të paligjshme ta sillte në përputhje me dispozitën federative. Nëse nuk do ta bënte këtë brenda afatit kohor prej gjashtë muajsh, Gjykata Kushtetuese Federative vetëm atëherë mund ta shpallte të

---

29 Më pas, në praktikë, duhej të fillonte negociatat me Parlamentin e Republikës për ta sjellë dispozitën antikushtetuese në përputhje me kushtetutën federative. Por nuk kishte asnjë mekanizëm për zbatim të ligjit.

pavlefshme dispozitën përkatëse me një vendim të ri (neni 384 i Kushtetutës së RSFJ-së).

23. I njëjti sistem u zbatua në Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë në lidhje me kushtetutat dhe ligjet e KSA-ve. Neni 402 thjesht thotë: „Gjykata Kushtetuese e Serbisë i jep opinionin e saj Kuvendit të RSS-së lidhur me çështjen nëse një kushtetutë krahinore nuk është në përputhje me Kushtetutën e RSS-së”. Sipas nenit 410, në rast të konfliktit ndërmjet ligjeve të republikës ose KSA-të me kushtetutën e RSS-së ose të ligjeve krahinore me ligje të republikës, Gjykata Kushtetuese e Serbisë duhej t’i jepte një opinion kuvendit përkatës, i cila kishte detyrimin ta rregullonte dispozitën përkatëse brenda gjashtë muajve. Nëse nuk e bënte këtë, Gjykata Kushtetuese duhej të merrte sërish një vendim për shpalljen e dispozitës përkatëse të pavlefshme. Pra, në fakt, as Kuvendi dhe as Gjykata Kushtetuese e Serbisë nuk mund ta detyronin Kuvendin e KSA të pranonte opinionin e tyre për në rast të konfliktit ndërmjet kushtetutave.

24. Pra, KSA-të ishin — për sa i përket dizajnit institucional dhe vendimmarrjes në nivel federativ — të barabarta me Republikën e Serbisë përmes Kushtetutës Federative të vitit 1974: ato mund të merrnin pjesë në procesin e vendimmarrjes në nivel federativ pa i marrë udhëzimet nga përfaqësuesit e Serbisë. Së dyti, institucionet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të KSA-ve nuk ishin në varësi të institucioneve përkatëse të Republikës së Serbisë. Megjithatë, mbeti një dallim i rëndësishëm midis Republikave dhe KSA-ve, që u bë gur themeli për përcaktimin e bartësve të së drejtës për vetëvendosje, duke përfshirë shkëputjen.

### **1.1.2. E drejta për vetëvendosje duke përfshirë shkëputjen sipas Kushtetutës së RSFJ-së**

25. Kështu, sipas nenit 3 të kushtetutës së RSFJ-së vetëm Republikat kishin statusin e „shtetit” bazuar në „sovrانيتin popullor dhe pushtetin dhe vetëadministrimin e klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punëtorë”. Në të kundërt, KSA-të janë, sipas nenit 4, „komunitete socio-politike autonome, socialiste, vetëqeverisëse, demokratike të bazuara në pushtetin dhe vetëadministrimin e klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punëtorë” në të cilat njerëzit dhe qytetarët punëtorë, kombet dhe kombësitë ushtrojnë „të drejtat e tyre sovranë”. Për më tepër, kapitulli I i pjesës hyrëse të Kushtetutës

së RSFJ-së flet për themelimin e RSFJ-së nga „kombet” jugosllave, bazuar në të drejtën e secilit popull për vetëvendosje, duke përfshirë edhe shkëputjen, ...” dhe shumë dispozita të Kushtetutës bëjnë dallimin midis kombeve (narodi) dhe kombësive (narodnosti), një terminologji e përdorur për rrjedhojë në të gjithë tekstin e Kushtetutës. Sipas doktrinës kushtetuese jugosllave të gjithë ata popuj që formuan shtetin e tyre në territorin e RSFJ-së quheshin kombe, ndërsa ata popuj që formuan shtetin e tyre jashtë Jugosllavisë quheshin kombësi. Kështu, hungarezët në Vojvodinë kanë formuar një kombësi në të njëjtën mënyrë si shqiptarët në Kosovë.

26. Sipas këtij dallimi të doktrinës kushtetuese jugosllave dhe tekstit të pjesës hyrëse të kushtetutës së RSFJ-së, vetëm kombet kishin të drejtë për vetëvendosje duke përfshirë shkëputjen, ndërsa kombësitë<sup>30</sup>, respektivisht pakicat kombëtare, jo, edhe nëse do të përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë së një KSA-je.

27. Kjo doktrinë u afirmua nga Gjykata Kushtetuese Federative në vitin 1991 kur vendosi për Deklaratën Kushtetuese të Kosovës si Njësi e Pavarur dhe e Barabartë në Kornizën e Federatës (Konfederatës) të Jugosllavisë si entitet i barabartë me njësitë e tjera në Federatë (Konfederatë).<sup>31</sup> Në arsyetimin e saj për antikushtetutshmërinë e kësaj deklaratë, Gjykata Kushtetuese deklaroi se „shpallja e kombësisë shqiptare në Kosovë popull i Jugosllavisë nuk është në përputhje me Kushtetutën e RSFJ-së sepse sipas Kushtetutës së RSFJ-së shqiptarët në Kosovë janë kombësi dhe nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën e vetëvendosjes dhe në këtë mënyrë nuk mund ta shpallin KSA-në e Kosovës njësi federative si republikat. Pra, sipas Kushtetutës së RSFJ-së, të drejtën e vetëvendosjes e kanë vetëm popujt e Jugosllavisë dhe jo kombësitë”.

28. Megjithatë, askund në Kushtetutën e përmendur nuk janë renditur popujt në dallim nga kombësitë. Kjo është edhe arsyeja pse Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë nuk ka mundur të citojë një dispozitë si dëshmi për këtë argument.

---

30 Shih Marković, *Krahinat Autonome*, fq. 122, dhe Tibor Varady, Të drejtat kolektive të pakicave dhe problemet në mbrojtjen e tyre ligjore: Shembulli i Jugosllavisë, *East European Politics and Societies* (1992), fq. 265.

31 Botuar në Gazetën Zyrtare të KSA të Kosovës, Nr. 21/90.

29. Për t'i dhënë peshë historike kësaj doktrine kushtetuese, Prof. Ratko Marković, në një artikull studimor<sup>32</sup>, i referohet një vendimi të sesionit të dytë të AVNOJ-it<sup>33</sup> në vitin 1943 ku parashikohet se Jugosllavia „ndërtohet dhe do të ndërtohet mbi parimin federativ, i cili do të sigurojë barazi të plotë të statusit ndërmjet serbëve, kroatëve, sllovenëve, maqedonasve dhe malazezëve, përkatësisht popujve të Serbisë, Kroacisë, Sllovenisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinës”. Megjithatë, vetë Ratković i referohet faktit se „krahinat autonome jugosllave” nuk ishin krijuar me Republikën e Serbisë kur ndiqet rendi i ngjarjeve në krijimin e atyre krahinave: „Në fillim organet e tyre më të larta vendosën t'i bashkohen Serbisë si njësi federative në kuadër të Jugosllavisë federative; ky vendim u konfirmua më pas nga organet më të larta të pushtetit federativ (përkatësisht Kryesia e AVNOJ-it në sesionin e tretë), dhe në fund organi më i lartë i autoritetit të Serbisë i miratoi ligjet për autonomitë. Kjo më pas u mor përsipër nga Kushtetuta e Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë në vitin 1946 dhe Kushtetuta e Republikës Popullore të Serbisë.”<sup>34</sup>

### 1.1.3. Amendamentet e Kushtetutës Federative dhe të Republikës në 1988 dhe 1989

30. Që në vitin 1985, artikulli i prof. Ratko Markovićit shprehte kritika kundër asimetrisë dhe pabarazisë institucionale në mbarë sistemin kushtetues të vitit 1974. Më vonë kjo kritikë – e cila politikisht ishte në përputhje me „Memorandumin” famëkeq të Akademisë së Shkencave Serbe<sup>35</sup> – u shpreh edhe nga juristë të tjerë kushtetues serbë të botuar në revista juridike.<sup>36</sup> Këto kritika mund të përmbliidhen si më poshtë:

---

32 Marković, *Krahinat Autonome*, fq. 122, fusnota 18.

33 Ky ishte Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Jugosllavisë, i krijuar dhe i dominuar nga Lëvizja e Rezistencës Partizane Komuniste.

34 Marković, *Krahinat Autonome*, fq. 120.

35 Sipas Tim Judah, *Serbët. Historia, Miti dhe Shkatërrimi i Jugosllavisë*, botimi i dytë, Yale 2000, fq. 158 fragmente të Memorandumit të papërfunduar u botuan më 25 dhe 26 shtator 1986 nga gazeta e Beogradit Večernje Novosti. Teksti i plotë është botuar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Kosta Mihajloviq (Kosta Mihajlović)/Vasilje Krestiq (Vasilje Krestić), *Memorandum i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Serbe. Përgjigje për kritikët*. Botuar mbi Vendimin e Kryesisë së Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve. Redaktor Akademik Miroslav Pantiq (Miroslav Pantić). Versioni anglisht, Beograd 1995.

36 Marković, *Krahinat autonome*, fq. 105 – 128; Jovan Gjorgjeviq, Status autonomije (pokrajine) i položaj

31. Së pari, juristët kushtetues pohojnë se Serbia u nda në tri pjesë me institucionalizimin ligjor të autonomisë territoriale për Vojvodinën dhe Kosovën në mënyrë që Serbia të mos gëzojë shtetësinë dhe sovranitetin e plotë si republikë. Prandaj, kjo do të përbënte një diskriminim ndaj Serbisë në krahasim me republikat e tjera të federatës ku nuk ishin krijuar autonomi të tilla territoriale. Së dyti, Krahinat Autonome do të kishin të njëjtat kompetenca dhe institucione si republikat në mënyrë që ato të gëzonin shtetësinë e plotë pa u quajtur shtete. Në fakt, krahinat autonome jo vetëm që do të formonin një shtet brenda shtetit, por do të privilegjoreshin edhe në sistemin e vendimmarrjes në nivel federativ kundrejt Republikës së Serbisë. Kështu, Federata Jugosllave do të formonte një federatë asimetrike që do të diskriminonte ekskluzivisht kundër Serbisë.

32. Në nivel republike, argumenti i ndarjes së Serbisë në tri pjesë çoi në përfundimin se marrëdhëniet ndërmjet Republikës dhe KSA-ve do të diskriminonin vetë Serbinë, d.m.th. territorin pa KSA-të, pasi që KSA-të kishin të drejtën e vetos në të gjitha ligjet bashkëpunuese të republikës dhe përfaqësuesit e zgjedhur në territorin e KSA-ve mund të merrnin pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështjet që kanë të bëjnë me vetë Serbinë.<sup>37</sup> Për më tepër, dispozitat kushtetuese të KSA-ve që ishin në kundërshtim me kushtetutën e Republikës nuk mund të shpalleshin të pavlefshme nga Gjykata Kushtetuese e Serbisë (neni 402) dhe, së fundi, KSA-të kishin të drejtën absolute të vetos për amendamentet e kushtetutës së Republikës (neni 427).

33. Përpjekja e parë për ta shfuqizuar këtë gjoja asimetri dhe pabarazi institucionale në sistemin federativ sipas ligjvënësve kushtetues serb,

---

SR Srbije (Statusi i autonomisë (të krahinës) dhe situata e RS të Serbisë), *Opština* br. 9 –10/1988, fq. 15 – 27; Miodrag Jovičić (Miodrag Jovičić), Neravnopravnost SR Srbije sa ostalim Republikama u Federaciji (Pabarazia e RS të Serbisë me Republikat e tjera në Federatë), *Pravni život* 1988, fq. 934 – 938; Radomir Lukić (Radomir Lukić), Ostvarivanje Funkcije SR Srbije kao države (Funkcionimi i RS të Serbisë si shtet), *Pravni život* 1988, fq. 927 – 933; Ratko Marković, Zašto Kosova ne može postati republika (Pse Kosova nuk mund të bëhet Republikë), *Pravni život* 1989, fq. 1017 – 1024.

37 Megjithatë, ajo që nuk përmendet në këtë kritikë është fakti se nuk mund të ndodhte humbja me votim apo krijimi i shumicave pasi që neni 343 i Kushtetutës së Republikës parashikonte domosdoshmërinë e shumicës së përfaqësuesve nga „territori jashtë territorit të krahinave“ që është shprehja kushtetuese për vetë Serbinë.

ishite procedura për ndryshimin e Kushtetutës Federative të vitit 1974.<sup>38</sup> Në debatin publik<sup>39</sup> në vitet 1987 – 1988 u mbajtën dy qëndrime të kundërta: nga njëra anë, në përputhje me idenë e ri-centralizmit të Federatës u bë propozimi për të hequr autonomitë territoriale dhe për të futur në vend të saj formën e autonomisë kulturore për të gjitha pakicat, d.m.th. për serbët që jetojnë në republikat e tjera.<sup>40</sup> Propozimi i kundërt ishte rritja e KSA-ve në republika. Ky propozim u pa si një vepër penale sipas Kodit Penal që cenon „vëllazërinë dhe unitetin”.<sup>41</sup> Shtypi sloven dhe kroat e akuzoi palën serbe si nacionaliste dhe madje fashiste.<sup>42</sup> Si përfundim, asnjë nga këto qëndrime të kundërta nuk u miratua dhe kështu u shty reforma e madhe e marrëdhënieve federative ndërmjet republikave nga njëra anë dhe Republikës Socialiste të Serbisë dhe KSA-ve nga ana tjetër. Pa marrë parasysh shumë ndryshime në lidhje me sistemin ekonomik, vetëm Amendamentet XXVII para 3, XXIX, XXXI, XXXIV, XXXVI, XXXVII dhe XLIII janë me interes në këtë kontekst.<sup>43</sup> Megjithatë, këto ndryshime të miratuara në 1988<sup>44</sup> sollën vetëm më shumë saktësi për sa i përket gjuhës së tekstit ose reforma të detajuara për specifikimin e hierarkisë ligjore dhe akomodime shumë të moderuara për hierarkinë e organizimit administrativ. Në fakt, statusi i KSA-ve, d.m.th. i institucioneve të tyre të garantuara me kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974, nuk u ndryshua në asnjë mënyrë.

34. Procesi paralel i ndryshimit të kushtetutës së RSS<sup>45</sup> hasi rezistencë masive politike në KSA, të cilat do të analizohen më poshtë në përfundime.

35. Problemi (politik) se nuk kishte një mekanizëm ligjor, por vetëm politik për të sjellë kushtetutat e KSA-ve në përputhje me kushtetutën e

---

38 Shih Propozimin e RSFJ-së për të vazhduar me ndryshimin e Kushtetutës së RSFJ-së, botuar në anglisht në anketën Jugosllave Nr. 1, 1987, f. 3 – 20. Në veçanti në kapitullin III „Marrëdhëniet brenda Federatës dhe të Drejtat dhe Detyrat e Federatës” propozohet ndryshimi i dispozitave përkatëse të kushtetutës së RSFJ-së të cilat „nuk shprehin qëndrimet e Republikës Socialiste të Serbisë dhe të krahinave autonome socialiste ...”

39 Shih artikullin studimor nga Herwig Roggemann, Zur Verfassungsdiskussion in der SFR Jugoslawien (Mbi debatin mbi reformën kushtetuese në RSFJ), *Recht in Ost und West*, Heft 5, 15. shtator 1989, fq. 273 – 284.

40 Shih Roggemann, *Verfassungsdiskussion*, fq. 280.

41 Shih Roggemann, *Verfassungsdiskussion*, fq. 280.

42 Shih për shembull, *Vjesnik*, 17 shkurt 1988.

43 Ndryshimet e dispozitave kushtetuese në lidhje me tekstin e vitit 1974 janë përmbledhur në anglisht në anketën Jugosllave, vëll. XXX, Nr. 1 1989, fq. 3 – 38.

44 Službeni List (Gazeta Zyrtare) RSFJ, Nr. 70/1988.

45 Službeni glasnik (Gazeta Zyrtare) RSS, Nr. 11/1989.

RSS-së, u ndryshua me Amendamentin XXIX, pika 1. Sipas kësaj dispozite – në analogji me atë që kishte parashikuar tashmë kushtetuta e vitit 1974 në rastin e mospërputhjes së ligjeve të republikës dhe krahinave – Gjykata Kushtetuese e Serbisë mund të deklaronte se një dispozitë antikushtetuese nuk është më valide nëse Kuvendi i krahinës nuk e sjell dispozitën në përputhje brenda një viti. Ky amendament, pra, devijon nga i gjithë sistemi kushtetues i vitit 1974, por nuk bie ndesh me Kushtetutën Federative, pasi nuk ka një parashikim të shprehur për rastin e konfliktit midis kushtetutave të një Republike dhe një KSA.

36. Amendamenti XXXI pezulloi nenin 296 të Kushtetutës së Serbisë dhe u jep institucioneve të Republikës, kundrejt atyre të KSA-ve, të drejtën për të udhëzuar se si të zbatojnë ligjet e Republikës dhe mjetet për të siguruar zbatimin.

37. Amendamenti XXXIII ndërhyr në kompetencat e KSA-ve duke u dhënë organeve të Republikës të drejtën të rregullojnë shumë çështje në mënyrë uniforme për të gjithë territorin e Republikës si: përdorimi zyrtar i gjuhës serbo-kroate dhe alfabetëve të saj – cirilik dhe latin (paragrafi 1); kufizimi dhe shuarja e të drejtave pronësore (paragrafi 2, pika 4); mbrojtja kombëtare, mbrojtja territoriale dhe mbrojtja civile (paragrafi 3); mbrojtja e rendit kushtetues (sigurimi shtetëror – paragrafi 4, pika 1) dhe siguria publike (paragrafi 4, pika 3); themelimi i gjykatave të rregullta (paragrafi 8); koordinimi i bashkëpunimit ndërkombëtar nga krahinat autonome me organet e RSS (paragrafi 9); mbledhja, regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave statistikore (paragrafi 10); bazat e sistemeve arsimore fillore dhe të mesme, mbrojtja dhe përdorimi i aseteve kulturore (paragrafi 11); plani social dhe plani urban (paragrafi 12); ngritja e organizatave të punës (paragrafi 13, pika 1); sistemi i taksave dhe kontributeve (paragrafi 13, pika 2); mbrojtja e mjedisit (paragrafi 13, pika 7); zgjidhja e konfliktit ndërmjet ligjit të republikës dhe atij krahinor (paragrafi 14).

38. Amendamenti XLIV parashikoi mundësinë që Gjykata Kushtetuese e Serbisë të mund të merrte përsipër një çështje nëse Gjykata Kushtetuese e një KSA nuk merr vendim për atë lëndë brenda gjashtë muajve. Megjithatë, kjo ishte e mundur vetëm nëse pretendohet se një ligj ose një rregullore tjetër binte njëkohësisht në kundërshtim me kushtetutën e RSS dhe kushtetutën e krahinës.

39. Me Amendamentin XLVII u hoq e drejta e vetos absolute e KSA-ve për amendamentet e kushtetutës së Republikës. Kuvendet e KSA-ve morën vetëm një veto pezulluese për gjashtë muaj. Nëse brenda këtij afati nuk mund të arrihet një konsensus politik ndërmjet kuvendeve përkatëse, kuvendet e KSA-ve mund të kërkojnë një referendum në mbarë territorin e Republikës. Sërish kjo nuk është në kundërshtim me Kushtetutën Federative, por devijon nga sistemi i saj i parashikuar për ndryshimin e Kushtetutës Federative ku kuvendet e KSA-ve kanë të drejtën e vetos absolute.

40. Të gjitha ndryshimet në kushtetutat e republikave u shqyrtuan nga Gjykata Kushtetuese Federative. Këto vendime janë botuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së Nr. 10/1999. Megjithatë, në vendimin e saj për amendamentet e Kushtetutës së RSS, Gjykata Kushtetuese Federative deklaroi jokushtetues vetëm Amendamentin XX, pika 3 (transaksionet e pasurive të paluajtshme mund të ndalohen me ligj), dispozitat e Amendamentit XXVII, paragrafi 3 (mundësia për të përjashtuar me ligj përdorimin zyrtar të alfabetit latin në favor të shkrimit cirilik) dhe Amendamentin XXXIX, paragrafi 2, pika 4 (dispozitat për bazën zgjedhore për zgjedhjet në këshillat e komunave).

#### **1.1.4. Kushtetuta e re serbe e vitit 1990**

41. Sa i përket sferës kushtetuese, në shtator të vitit 1990 u miratua kushtetuta e re serbe.<sup>46</sup> Kjo kushtetutë nuk e shfuqizoi formën e autonomisë territoriale si të tillë, por hoqi disa institucione dhe kompetenca të Krahinave Autonome (KA) të garantuara me Kushtetutën Federative ende të vlefshme të vitit 1974.

42. Sipas nenit 110 të kësaj kushtetute, KA-të – pasi ishte shfuqizuar edhe karakterizimi i tyre si „socialiste” – nuk kishin më kushtetutë, por „statut” që duhej të miratohej paraprakisht nga Kuvendi Kombëtar i Republikës. Institucionet e KA-ve janë Kuvendi, Këshilli Ekzekutiv dhe organet administrative sipas nenit 111. Me fjalë të tjera, KA-të nuk kanë më kompetenca gjyqësore me sistemin e tyre të gjykatave, duke përfshirë

---

46 Sl. gl. RS, Nr. 1/1990.



një gjykatë kushtetuese. Për më tepër, siç shihet nga neni 109, Kuvendi nuk ka më pushtet legjislativ. Askund nuk e përmend kjo kushtetutë përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e KA-ve në proceset vendimmarrëse në nivel republike apo federativ. Më në fund, territori i KA-ve mund të përcaktohet me ligj të republikës sipas nenit 108 paragrafi 3 dhe, sipas nenit 133, KA-të nuk mund të marrin pjesë më në procesin e ndryshimit të kushtetutës serbe.

43. Për më tepër, kushtetuta e re nuk u miratua sipas rregullave për amendamentet kushtetuese të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së vitit 1974, as në versionin e ndryshuar të vitit 1989. Prandaj, në aspektin e teorisë kushtetuese, kushtetuta e re serbe mund të quhet kushtetutë „revolucionare“.

44. Cila ishte arsyeja për këtë thyerje revolucionare të vazhdimësisë kushtetuese? Siç shihet nga kritikantët në gazeta dhe nga akademikë kritikë,<sup>47</sup> qëllimi i miratimit të kësaj kushtetute të re nga sistemi njëpartiak komunist ende në pushtet ishte sigurimi i pushtetit të partisë komuniste në zgjedhjet e ardhshme shumëpartiake dhe, në veçanti, posti dhe kompetencat e forta të Presidentit të Republikës për Sllobodan Millosheviqin. Nga këndvështrimi i së drejtës kushtetuese krahasuese, në veçanti kompetencat emergjente të Presidentit janë

---

47 Shih, në veçanti, kritikën e Prof. Dr. Pavle Nikoliq (Pavle Nikolić), Sekretar i Shoqatës Ndërkombëtare të së Drejtës Kushtetuese, në artikullin e tij studimor „Ustav Republike Srbije i 1990 god. i problemi demokratizacije (Kushtetuta e Republikës së Serbisë 1990 dhe problemet e demokratizimit)“, *Pravni život*, Beograd, Nr. 1-2/1991, fq. 92 – 96: „Dizavantazhi i kushtetutës së re të Serbisë (1990) qëndron në faktin se ajo u miratua nga një parlament njëpartiak i cili ishte i përbërë në bazë të sistemit njëpartiak. ... Kushtetuta e re është, pa dyshim, një shprehje e përpjekjes për të adoptuar forma të demokracisë moderne pa humbur pushtetin. ... Kushtetuta e Republikës së Serbisë i rikthehet idesë së ndarjes së pushteteve, por nuk prezanton një sistem që do të çonte në një ekuilibër real ndërmjet pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv. Kushtetuta e Serbisë vendos një sistem të pazakontë të ndarjes së pushteteve, i cili haptazi siguron prerogativën e ekzekutivit në duart e Presidentit. ... Kushtetuta e Republikës së Serbisë nuk është dhe nuk mund të jetë bazë për demokratizimin e Serbisë dhe as nuk i hap rrugën një procesi të vërtetë demokratizimi ... Kjo tregon domosdoshmërinë e një reforme rrënjësore, ose më saktë, derogimin dhe miratimin e një kushtetute të re nga një Kuvend që do të ketë legjitimitet“.

Shih gjithashtu artikujt kritikë të Sllobodan Iniq (Slobodan Inić), Predsjednička svemoć (Pushtetshmëria Presidenciale), *Borba*, 23 gusht 1990, duke theksuar kompetencat emergjente presidenciale në fjalinë se „ky President ... mund të udhëheqë një luftë të brendshme në kohë paqeje dhe kjo në mënyrë kushtetuese!“. Shih gjithashtu artikullin e të njëjtit autor „Loša balkanska kopija (Një kopje e keqe ballkanike)“, *Borba*, 24 gusht 1990, me nëntitull: Nëse serbët e miratojnë këtë kushtetutë, duhet ta dinë se nuk do të ketë më politikë. Do të jetë vetëm një person politik – Presidenti i Republikës.

të jashtëzakonshme: sipas nenit 83, pikat 6 deri në 8 të kushtetutës së re, ai mund të shpallë gjendjen e luftës dhe mund të miratojë më pas rregullore me të cilat mund të ndryshojë kompetencat e qeverisë, ministrive, gjykatave dhe prokurorëve. Gjithashtu, ai mund të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në një pjesë të territorit të Republikës, nëse rrezikohet siguria e Republikës, të drejtat dhe liritë e qytetarëve ose funksionimi i institucioneve shtetërore. Kjo saktësohet më tej në „Ligji për masat në rast të gjendjes së jashtëzakonshme”.<sup>48</sup>

45. Për më tepër, përkundër faktit se neni 135 i Kushtetutës deklaroi se „Republika e Serbisë është në kuadër të RSFJ-së”, nuk ka më dispozita që tregojnë ndonjë lidhje institucionale me Federatën.<sup>49</sup> Kjo do të thotë se kjo kushtetutë ishte hapi i parë në përgatitjen e ngjarjes së shpërbërjes së Jugosllavisë komuniste dhe për të pasur bazën kushtetuese për një shtet të pavarur kombëtar.<sup>50</sup>

---

48 Sl. gl. RS 19/1991. Neni 2 „përcakton” kushtet për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në pjesë të territorit të Republikës së Serbisë, përkatësisht „kur ndërmerren aktivitete të cilat rrezikojnë: rendin kushtetues, sigurinë e Republikës – sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin e territorit të saj, ushtrimin e veprimtarive ekonomike dhe shoqërore, ushtrimin dhe mbrojtjen e lirisë, të drejtave dhe detyrimeve të njeriut dhe qytetarëve dhe punën e organeve shtetërore.” Neni 6 paragrafi 1 numëron masat që mund të marrë Presidenti: „Të urdhërojë detyrimin për të punuar, të kufizojë lirinë e lëvizjes dhe të qëndrimit, të kufizojë të drejtën për grevë, të kufizojë lirinë e tubimit, të kufizojë lirinë e veprimtarive politike, sindikaliste dhe të tjera.” Paragrafi 2 i jep më pas mundësinë „të urdhërojë edhe të tjera masat në përputhje me ligjin.” Së fundi, neni 11 legjitimon masat „e urdhëruara me dispozita të veçanta në ato pjesë të territorit të Republikës së Serbisë para hyrjes në fuqi të këtij ligji” – kjo frazë abstrakte nënkupton Kosovën.

49 Kjo u shpreh edhe në artikuj studimorë. Shih Miodrag Jovičić (Miodrag Jovičić), Ustav koga se Srbija neće stideti (Një kushtetutë nga e cila Serbia nuk do të turpërohet), *Pravni život*, Beograd, Nr. 7-8/1990, fq. 1050-51: „Një zinxhir i madh historik lidh vitin 1903 me vitin 1990. Në fillim ishte kushtetuta e fundit e Serbisë së pavarur, të cilën e miratoi në mënyrë të pavarur. Në fund është kushtetuta të cilën Serbia do ta miratojë deri në fund të vitit 1990 si ligjin e saj bazë, pasi që në mars të vitit 1989 kishte fituar fuqinë e saj kushtetuese. ... Serbia prezanton kushtetutën e saj të re pa lidhje me dispozitat e kushtetutës federative ... Serbia, për herë të parë pas vitit 1903, është e lirë të konceptojë kushtetutën e saj sipas vullnetit të saj. ...” Dhe Vladan Kutlečić (Vladan Kutlečić), anëtar i komisionit kushtetues dhe sekretar i Presidencës së Republikës së Serbisë, deklaroi sinqerisht se Serbia duhet „të miratojë një kushtetutë të plotë dhe të re për të rregulluar të gjitha problemet, .... në sferën e sistemit politik dhe organizimit të pushtetit në Republikë, pa marrë parasysh – si njësitë e tjera federative – kushtetutën e vlefshme jugosllave, e cila nuk vlen më.” Në Aktualna ustavno-pravna situacija zemlje i Predlog Predsedništva SFRJ za donošenje Ustava SFRJ (Situata aktuale kushtetuese e vendit dhe propozimi i Kryesisë së RSFJ-së për miratimin e një kushtetute të RSFJ-së), *Pravni život*, Beograd Nr. 3-4/1990, fq. 510.

50 Shih edhe Zdravko Huber, Ustav ranog postkomunizma (Kushtetuta e një post-komunizmi të hershëm), në: *Borba*, 28 shtator 1990, fq. 2: „Hartuesit e kushtetutës së kësaj Republike donin të arrinin një korrigjim specifik të shtetësisë serbe në lidhje me ekzistimin e autonomive territoriale. Në

46. Kjo u deklarua hapur nga Slobodan Millosheviqi kur u miratua drafti i Kushtetutës së re serbe në fund të qershorit 1990: „Ne e miratojmë këtë kushtetutë në një kohë kur Jugosllavia ka filluar të konfederativizohet në mënyrë kushtetuese në kuadër të kufijve ekzistues ndërmjet republikave. ... Në lidhje me këto tendenca të forta konfederative të shpërbërjes, do të ishte e papërgjegjshme ndaj Serbisë dhe qytetarëve të saj, nëse do të kishim vetëm një koncept për zgjidhjen e krizës jugosllave: Jugosllavinë federative. Kjo është arsyeja pse ky draft lejon gjithashtu një opsion tjetër të mundshëm: Serbinë si shtet i pavarur”.<sup>51</sup>

### 1.1.5. Kushtetuta e re e Republikës Federative të Jugosllavisë e vitit 1992

47. Pas Opinionit Nr. 1 të Komisionit të Arbitrazhit për ish-Jugosllavinë, i ashtuquajturi Komisioni Badinter që kishte deklaruar më 11 janar 1992 se RSFJ ishte „në proces të shpërbërjes”,<sup>52</sup> më 27 prill 1992 u miratua kushtetuta për Republikën e re Federative të Jugosllavisë nga përfaqësuesit e mbetur nga Serbia dhe Mali i Zi të Dhomës Federative të Kuvendit të RSFJ-së. Në një deklaratë për shpalljen e Kushtetutës së RFJ-së të së njëjtës ditë, të miratuar „në seancën e përbashkët ceremoniale të Republikës Federative të Jugosllavisë, Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë dhe Kuvendit të Republikës së Malit të Zi”, „përfaqësuesit e popullit të Republikës së Serbisë dhe Republikës së Malit të Zi”<sup>53</sup> deklarojnë arsyen për këtë kushtetutë të re: Sipas pikës 1, RFJ shihet si „vazhdim i personalitetit shtetëror, juridik dhe politik ndërkombëtar të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë...” Prandaj, RSFJ, sipas opinionit të tyre, nuk u shpërbë dhe RFJ vazhdoi personalitetin juridik ndërkombëtar të RSFJ-së, pasi që shtetet e reja të pavarura të Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnjë dhe Hercegovinës ishin shkëputur nga RSFJ dhe për këtë arsye nuk mund të shiheshin si shtete pasardhëse.

---

fund ata shfuqizuan të gjitha elementet e shtetësisë krahinore dhe vendosën sovranitetin e shtetit të Republikës. Serbia, pra, ka sot bazën kushtetuese për të ekzistuar si një shtet i pavarur, sovran, i bazuar në një demokraci parlamentare-presidenciale dhe ekonomi të përzier. Nëse dëshiron të transferojë pjesë të shtetësisë së saj në ndonjë institucion federativ – kjo është një çështje e marrëveshjes me shtetet e tjera, anëtarë të mundshëm të një federate jugosllave.”

51 Shih *Politika*, 26 qershor 1990.

52 Shih tekstin i cili është ribotuar në Marc Weller (red.), *Kriza në Kosovë 1989 – 1999, Dokumentet dhe Analiza Ndërkombëtare*, Vëllimi 1, Cambridge 1999, fq. 80.

53 Kjo deklaratë është botuar në anglisht në *Review of International Affairs*, Beograd, vëll. XLIII, Nr. 1004, 1. V. 1992.

48. Vetëkuptohet se nuk u respektuan dispozitat e Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974 për ndryshimin e saj. Prandaj, edhe kjo kushtetutë është një akt revolucionar.

49. Për më tepër, kur deklarata flet për „përfaqësuesit e popullit të Republikës së Serbisë”, duhet të merret parasysh se shqiptarët e Kosovës nuk morën pjesë pasi të gjitha institucionet e tyre ishin shfuqizuar me masa legislative në vitin 1990 dhe 1991, të cilat do të përshkruhen në detaje më poshtë.

50. Në lidhje me pyetjen se cilat njësi e formojnë Federatën, neni 2 thjesht i referohet Republikës së Serbisë dhe Republikës së Malit të Zi si „republika anëtare”. Kushtetuta Federative nuk përmend më se Republika e Serbisë përmban autonomi territoriale, kështu që ato – në kontrast të fortë me Kushtetutën Federative të RSFJ-së – nuk janë më të garantuara me kushtetutën e RFJ-së. Megjithatë, ajo përmban disa dispozita për mbrojtjen e „pakicave kombëtare” (nenet 11 dhe 45 deri në 50). Vetëm neni 15 i cili parasheh serbishten dhe cirilikën si gjuhë dhe shkrime zyrtare përmban një referencë të dobët për aq sa u lejon „rajoneve të Republikës Federative të Jugosllavisë të cilat janë të banuara nga pakicat kombëtare” përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj.

## 1.2 Programet, Ligjet dhe Vendimet e Republikës së Serbisë për heqjen e Autonomisë së Kosovës

### 1.2.1. „Ligji për Punë të Brendshme”

51. Pas ndryshimeve të kushtetutës së RSS në 1989, „Ligji për Punët e Brendshme”, i cili u miratua në korrik 1989<sup>54</sup> shfuqizoi decentralizimin e institucionit të policisë në tërë Serbinë, i cili ishte zhvilluar në „Ligjin për Punët e Brendshme” të vitit 1985.<sup>55</sup> Ky ligj kishte krijuar një strukturë rajonale me komunat e lidhura në asociacionet rajonale ndërkomunale për të krijuar një sekretariat të përbashkët për punët e brendshme.

---

54 Sl. gl. RS Nr. 30/1989.

55 Sl. gl. SRS Nr. 22/1985

Sekretarin e sekretariatit të përbashkët e emëron dhe e shkarkon kuvendi i asociacionit rajonal ndërkomunal. Komunitetet që krijuan një sekretariat të përbashkët siguruan fondet për funksionimin e tij. Tani me ligjin e vitit 1989 sekretarët rajonalë ishin në varësi të sekretarit të republikës. Sekretari i republikës emëronte dhe shkarkonte drejtuesit e sekretariateve me miratimin paraprak të qeverisë dhe opinionin e kuvendeve përkatëse komunale. Sekretariati i Republikës u detyrua të merrte në varësi punonjësit e organeve të punëve të brendshme deri në fund të vitit 1989, si dhe lokalet, pajisjet dhe fondet e tyre për qëllime të veçanta. Për më tepër, në bazë të nenit 12, Presidencës së RSS-së iu besua kontrolli mbi Shërbimin e Sigurimit Shtetëror si dhe koordinimi i punës së tij që përfshinte „dhënien e drejtimeve politike dhe të sigurisë, urdhërimin e masave dhe përcaktimin e detyrave të tjera”. Slobodan Millosheviq ishte kryetar i Lidhjes së Komunistëve të Serbisë dhe, për rrjedhojë, anëtar i më me ndikim në Presidencën e Republikës. Në nëntor 1989 ai u bë President i Republikës. Kështu, ai ruajti funksionet e kontrollit dhe madje komandimit të vendosura me ligj mbi forcat e sigurimit të shtetit.<sup>56</sup>

### **1.2.2. „Programi për realizimin e paqes, lirisë, barazisë, demokracisë dhe prosperitetit të KSA të Kosovës”**

52. Megjithatë, në varësi të organeve të Republikës duhet të jetë jo vetëm organizimi i punëve të brendshme të KA-ve. Me „Programin për realizimin e paqes, lirisë, barazisë, demokracisë dhe prosperitetit të KSA të Kosovës”<sup>57</sup> dhe një „Plani Operativ”, të cilat parlamenti serb e miratoi në mars të vitit 1990, u zhvillua një qasje sistematike për t’i kaluar në varësi të institucioneve përkatëse të Republikës të gjitha sferat e shtetit, ekonomisë dhe arsimit të Kosovës, por jo edhe të Vojvodinës.

53. Para së gjithash, programi i referohet shifrave të popullsisë për përfundimin se pas Luftës së Dytë Botërore 400.000 serbë dhe malazezë kishin emigruar nga Kosova, vetëm 135.000 midis viteve 1961 dhe 1989, kështu që përqindja e serbëve dhe malazezëve në popullsinë e Kosovës

---

56 Shih Budimir Babović (Budimir Babović), *Analiza e rregulloreve në lidhje me përgjegjësinë për kontrollin e Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë*, Beograd 2003, fq. 11.

57 Sl. gl. SRS Nr. 15/1990. Fragmentet janë botuar në përkthim në anglisht në Weller (red.), *Crisis*, fq. 60.

ra nga 43% para Luftës së Dytë Botërore në 15% në 1981 dhe nën 10% në 1990. Arsyeja për këtë tani shihet ekskluzivisht të jetë gjendja e keqe e serbëve dhe malazezëve që rezulton nga mungesa e lirisë dhe pasiguria që kërcënojnë lirinë dhe pronën e serbëve dhe malazezëve të shkaktuar nga presioni i nacionalistëve shqiptarë në Kosovë. Qëllimi i „nacionalistëve dhe separatistëve shqiptarë” shihet si një Kosovë „etnikisht e pastër” e mundësuar nga dëbimi i të gjithë serbëve dhe malazezëve nga ai territor për të arritur „qëllimin e tyre themelor – shkëputjen e Kosovës nga Serbia dhe më vonë nga Jugosllavia, dhe krijimin e Shqipërisë së Madhe”.

54. Për të rikthyer „sundimin e ligjit” dhe për t’i dhënë fund „padrejtësisë” ndaj emigrantëve serbë dhe malazezë, parlamenti serb atëherë në këtë program — në një përzierje të kërcënimeve ndaj institucioneve të Kosovës nga njëra anë dhe duke elaboruar masat ekonomike, të synuara vetëm për serbët dhe malazezët nga ana tjetër — propozon:

„Sundimi i ligjit do të sigurohet për të gjithë serbët dhe malazezët dhe kombet dhe kombësitë e tjera që janë të kërcënuara; ... të gjitha të drejtat liberale dhe politike u garantohen të gjithë qytetarëve; ... Serbia do të ndërmarrë të gjitha masat për zhvillim më të shpejtë ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës; ... kompanitë serbe do të investojnë kapital në Kosovë; ... 1% e të hyrave personale duhet të paguhet në Serbi si taksë e veçantë për mbështetjen e zhvillimit në Kosovë me qëllim të ndalimit të emigrimit dhe inkurajimit të kthimit të serbëve dhe malazezëve”.

55. Në të njëjtën kohë, programi i parlamentit serb paralajmëron:

„Autonomia e Kosovës nuk duhet të përdoret si justifikim për mosfunksionimin e sundimit të ligjit... dhe nuk duhet të keqpërdoret për qëllimin e mëposhtëm: të parandalojë kthimin e serbëve dhe malazezëve ... dhe shkëputjen e një pjese të territorit të Republikës. .... Funkzionimi joadekuat i organeve ekzekutive, prokurorive dhe sistemit gjyqësor nuk duhet të vërë në dyshim realizimin e kushtetutës, paqen, lirinë, barazinë dhe demokracinë, apo funksionimin efikas të sundimit të ligjit. Nëse ndodh kjo, institucionet përgjegjëse të Serbisë do të marrin kompetencat përkatëse administrative, prokuroriale dhe gjyqësore”.

56. Më pas ky program ndiqet nga i ashtuquajtimi „Plani Operativ”<sup>58</sup> i ndarë në 3 kapituj me 94 pika në të cilat propozohen masa të hollësishme legislative dhe administrative në të gjitha fushat e jetës publike dhe „private”<sup>59</sup> duke përfshirë: legjislativin, ekzekutivin, gjyqësorin, krijimin e komunave të reja me shumicë serbe (pika 15), ekonominë, arsimin, shkencën dhe kulturën, kujdesin shëndetësor dhe çështjet sociale. Për secilën masë, plani operativ përcakton institucionin përgjegjës të republikës dhe krahinor dhe cakton një afat kohor, në shumicën e rasteve deri në mesin e vitit 1990.

57. Një vështrim i përgjithshëm i të gjitha këtyre masave jep përshtypjen se të gjitha institucionet krahinore politike, ekonomike, sociale dhe arsimore duhet t’u nënshtrohen institucioneve përkatëse të republikës, megjithëse kjo shpesh shprehet në mënyrë eufemiste në termat e „bashkëpunimit dhe ofrimit të ndihmës”.

### **1.2.3 „Ligji për veprimet e agjencive të republikës në rrethana të posaçme”**

58. Meqenëse kjo „ndihmë” dhe „bashkëpunim” padyshim që nuk funksionoi, më 26 qershor 1990 parlamenti serb miratoi „Ligjin për veprimet e agjencive të republikës në rrethana të posaçme”.<sup>60</sup> Neni 2 përcakton se „rrethanat e posaçme” do të konsiderohen se kanë lindur në një pjesë të territorit të RS të Serbisë kur të organizohen:

1. veprimtaritë që synojnë përmbysjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial;
2. mosrespektimi i ligjeve dhe akteve nënligjore;
3. veprime të cilat mund të jenë të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njeriut;

---

58 Sl. gl. SRS 15/1990, pos 266.

59 Pika 91 parasheh nevojën për marrjen e masave për „uljen e shkallës së lindshmërisë në Kosovë”.

60 Sl.gl. RSS 33/90, fragmente nga teksti në përkthim në anglisht mund të gjenden në Weller (red.), *Crisis*, fq. 60-1.

4. ushtrimi i të drejtave dhe detyrave të përcaktuara me Kushtetutë dhe me statut në mënyrë që dëmtojnë rëndë interesat publike dhe përdorimin e tyre në ndjekje të objektivave antikushtetuese.

Në nenin 3 renditen më pas masat që duhet të marrin agjencitë e republikës nga pavlefshmëria e akteve të institucioneve krahinore, zbatimi i vendimeve të agjencive të republikës e deri te marrja e kompetencave nga institucionet e krahinës.

59. Në të njëjtën ditë — dhe të botuar në Gazetën Zyrtare të njëjtën ditë — parlamenti serb miratoi „Vendimin për ekzistimin e rrethanave të posaçme në territorin e KSA të Kosovës” pa ndonjë arsytim se cilat ngjarje çuan në përfundimin se ekzistojnë rrethana në Kosovë në kuptim të nenit 2 të ligjit të cituar më lart.

60. Një ankesë kundër këtij ligji në Gjykatën Kushtetuese të Jugosllavisë e parashtruar nga disa institucione të Kosovës nuk ishte zgjidhur para shpërbërjes së RSFJ-së.<sup>61</sup>

#### **1.2.4. „Ligji për ndërprerjen e punës së Kuvendit dhe Këshillit Ekzekutiv të KSA të Kosovës”**

61. Më 5 korrik, parlamenti serb miratoi „Ligjin për ndërprerjen e punës së Kuvendit dhe Këshillit Ekzekutiv të KSA të Kosovës”.<sup>62</sup> Termi ndërprerje është në fakt një eufemizëm për shfuqizimin e këtyre institucioneve. Neni 3 rregullon që „të drejtat dhe detyrat” e autoriteteve krahinore të merren nga Kuvendi dhe Këshilli Ekzekutiv i Serbisë. Neni 5 shkarkon nëpunësit civilë të institucioneve të prekura si dhe zyrtarët që drejtojnë organet e administratës krahinore. Rregullorja për zbatimin e këtij ligji, e miratuar më 13 korrik, rregullon detajet për organizimin dhe veprimtarinë e re të organeve administrative të krahinës, të marra nga funksionarët e republikës. Përsëri, një ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Jugosllavisë nuk u zgjidh para shpërbërjes së RSFJ-së.<sup>63</sup>

---

61 Shih Violeta Demaj, *Kosovë/a – Recht auf Unabhängigkeit?* (Kosovo/a – E drejta për Pavarësi?), Wien 2003, f. 80.

62 Sl. gl. SRS 33/90. Teksti në përkthim në anglisht mund të gjenden në Weller (red.), *Crisis*, fq. 61-2.

63 Shih Demaj, *Kosovo/a*, fq. 83.



### **1.2.5. „Ligji për pezullimin e kryesisë së KSA të Kosovës”, shkarkimin e anëtarit nga Kosova në Kryesinë e RSFJ-së dhe shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.**

62. Në vijim u shfuqizuan edhe institucionet e tjera të Kosovës në nivel krahinor dhe u shkarkua përfaqësuesi i saj në nivel federativ. Më 18 mars 1991, parlamenti serb e shkarkoi Riza Sapunxhiun si anëtar të Kryesisë së RSFJ-së i zgjedhur nga Kosova pasi Presidenti i Republikës Sllobodan Millosheviq kishte kërkuar shprehimisht shkarkimin në një deklaratë kritike ndaj Kryesisë së RSFJ-së.<sup>64</sup> Në të njëjtën ditë, parlamenti serb miratoi edhe „Ligjin për Pezullimin e Kryesisë së KSA të Kosovës”.<sup>65</sup>

63. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese veç ishin shkarkuar me një vendim të botuar në Sl. gl. RS Nr. 22/90. Pa asnjë dispozitë për rrimërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, gjykata u shfuqizua efektivisht. E njëjta gjë vlen edhe për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme botuar në Sl. gl. RSS 53/90.

### **1.2.6. „Ligji për marrëdhëniet e punës në rrethana të posaçme”**

64. „Ligji për marrëdhëniet e punës në rrethana të posaçme”<sup>66</sup>, në veçanti neni 8, ofronte arsyet për shkarkimin e nëpunësve civilë në administratën krahinore dhe punëtorëve në kompanitë vetëadministruese.

### **1.2.7. Heqja e Autonomisë së Kosovës**

65. Këto ligje u pasuan me gati 500 vendime të kuvendit serb, të cilat prekën të gjitha sferat e shtetit dhe shoqërisë në Kosovë: institucionet autonome të pushtetit administrativ dhe gjyqësor në nivel krahinor, rajonal dhe lokal, tërë ekonominë vetëadministruese, shërbimin shëndetësor, sistemin e sigurimeve shoqërore dhe të gjithë sistemin arsimor nga institucionet parashkollore dhe shkollat fillore deri te universiteti. Këto ligje dhe rregullore administrative dhe vendime rezultuan në heqjen totale të autonomisë së Kosovës.

---

64 Shih *Borba*, 17 mars 1991.

65 Të dy aktet janë botuar në Sl. gl. RS 15/91.

66 Sl. gl. RSS 40/90.

66. Shih për shembull vendime të shumta për shkarkimin dhe riemërimin e gjyqtarëve të gjykatave në nivel rajoni dhe komunal (Sl. gl. RSS Nr. 53/90, Sl. gl. RS Nr. 6 dhe 16/90 dhe 43, 48, 79/91).

Prokurorët në nivel rajoni dhe komunal janë shkarkuar nga detyra me vendim të botuar në Sl. gl. RSS Nr. 53/1990.

Nga detyra u hoqën edhe funksionarët publikë të agjencive administrative krahinore, si çështjet e të drejtave pronësore, çështjet gjeodezike, financat, urbanizmi dhe strehimi, bujqësia, arsimi dhe informacioni (Sl. gl. RSS Nr. 39, 44, 53/90 dhe Sl. gl. RS Nr. 6/90).

U hoqën dhe u riemëruan edhe funksionarët publikë të komunave (Sl. gl. RSS Nr. 43, 44, 53/90; Sl. gl. RS Nr. 6, 13, 16/90 dhe Nr. 16, 30, 41, 44, 46, 62, 79/91).

Me shumë rëndësi ishte edhe nënshtrimi i televizionit dhe medias së shkruar. Shih vendimet për largimin e drejtorëve dhe gazetarëve në TV Prishtinë (Sl. gl. RSS Nr. 34, 36, 43/90), radiostacionet rajonale (Sl. gl. RS Nr. 6, 13, 20/90 dhe Nr. 27, 41/91), gazetatat Rilindja (Sl. gl. RSS Nr. 34, 37, 44/90 dhe Nr. 16, 46/91), Tan (Sl. gl. RSS Nr. 37/90) dhe Jedinstvo (Sl. gl. RSS Nr. 37/90)

Për më tepër, u kap i gjithë sistemi i kompanive vetëadministruese në fushat e mëposhtme: industrinë minerare dhe kimike, tregti, tekstile, bujqësi, transport, hotele, fabrika të birrës (Sl. gl. RSS Nr. 31, 34, 36, 39, 43, 46, 53/90, Sl. gl. RS Nr. 6, 13, 20/90 dhe Nr. 9, 17, 27, 31, 38, 41, 46, 47, 48, 63, 64, 72, 75 dhe 79/91).

Kundër Universitetit të Prishtinës (Sl. gl. RS Nr. 13/90 dhe Nr. 38 und 63/91) dhe në veçanti të gjitha instituteve të fakultetit të mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (Sl. gl. RSS Nr. 43, 53, Sl. gl. RS Nr. 6 dhe 20 dhe Nr. 9, 17, 27, 37, 41, 47, 64, 72 dhe 75/91) u morë masa të përkohshme. Gjithashtu në qendrat e shërbimit shëndetësor në mbarë Kosovën (Sl. gl. RSS Nr. 39 dhe 43/90, Sl. gl. RS Nr. 6 dhe 20/90 dhe Nr. 31 dhe 41/91).

Masa të përkohshme u morën edhe ndaj qendrave kulturore (Sl. gl. RS Nr. 6 dhe 13 si dhe Nr. 41 dhe 46/91), kundër Institutit të Historisë së Kosovës (Sl. gl. RS Nr. 13/90), Arkivit të Kosovës (Sl. gl. RS Nr. 13/90 dhe 17/91) dhe Teatrit Kombëtar (Sl. gl. RS Nr. 20/90).

Sa i përket sistemit arsimor, me „Ligjin serb për shkollat” (Sl. gl. RSS Nr. 45/90) u shfuqizuan të gjitha ligjet e miratuara nga kuvendi i Kosovës dhe arsimi sipas ligjit dhe u vendosën planprograme të njëtrajtshme serbe.

Më në fund, me „Ligji për kushtet dhe procedurat për shpërndarjen e tokës bujqësore qytetarëve që dëshirojnë të jetojnë dhe punojnë në territorin e KA të Kosovës dhe Metohi” (Sl. gl. RS Nr. 43/91) prona shoqërore u nda për përdorim privat vetëm për serbët dhe malazezët. Me ligjin e vitit 1987 transaksionet e pronave të paluajtshme ishin të ndaluara, por kjo u shpall jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë (U 12/1-88, U 101/1-89 dhe U 102/2-89, 27 qershor 1990). Megjithatë, i njëjti ligj u miratua përsëri nga parlamenti serb më 18 prill 1991 (Sl. gl. RS 22/91).

67. Në fakt, sipas shifrave të dhëna nga Violeta Demaj,<sup>67</sup> u shkarkuan më shumë se 220 gjyqtarë dhe prokurorë shqiptarë dhe 115.000 personel administrativ, duke përfshirë 4000 policë. Rreth 90% e fuqisë punëtore shqiptare mbetën të papunë.

68. Arsyesimi i këtyre masave kundër institucioneve të Kosovës jepet në dy dokumente: raporti i Republikës Federative të Jugosllavisë për Komisionin për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD/C/248) dhe deklaratat e përfaqësuesit të RFJ-së në përfundim të vëzhgimeve si dhe në Raportin Plotësues të RFJ-së, 29 gusht 1994 në lidhje me Kosovën.<sup>68</sup>

Në këto raporte janë përdorur argumentet e mëposhtme për të shpjeguar masat ndaj institucioneve të Kosovës:

„Pakicës kombëtare shqiptare iu dha autonomi e plotë territoriale dhe kulturore, por në vend të kësaj ata donin shkëputjen; ... Me pezullimin e Kuvendit të Kosovës dhe Këshillit Ekzekutiv, Republika duhej të mbronte integritetin e saj territorial dhe strukturën kushtetuese; ... Një pjesë e madhe e shqiptarëve nuk i shfrytëzojnë të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Serbisë dhe RFJ-së ose i bojkotojnë ato, të udhëhequr

---

67 Demaj, *Kosovo/a*, fq. 83 dhe 89.

68 Këto dokumente mund të gjenden në fragmente në Weller (red.), *Crisis*, fq. 141 – 148.

nga liderët separatistë; ... Rënia e shqiptarëve në drejtësi, polici dhe institucione shëndetësore ishte jo për shkak të diskriminimit apo përjashtimit nga puna, por për shkak të refuzimit të tyre për të njohur autoritetet legjitime të shtetit; për shembull, 31 gjyqtarë dhe prokurorë shqiptarë të emëruar kishin refuzuar të bënin betimin për besnikëri përpara Kuvendit Kombëtar dhe në këtë mënyrë u diskualifikuan nga detyra; kërkesa e vetme është që shqiptarët të respektojnë realitetin se Kosova dhe Metohia janë pjesë përbërëse e Serbisë; ... Tendencat jashtëzakonisht negative ekonomike i detyruan autoritetet serbe të marrin masat e duhura ndaluese me qëllim të parandalimit të shkëputjes dhe vendosjes së sundimit të ligjit; për shkak të emërimit ekskluzivisht të shqiptarëve në bordet drejtuese dhe postet drejtuese, cilësia e mirë u sakrifikua për hir të kuotave kombëtare; për ta sanuar këtë situatë, u vendosën masa emergjente në 330 ndërmarrje dhe në shërbimet sociale në periudhën korrik-nëntor 1990; Organet e përkohshme në ndërmarrje u përballën me rezistencë dhe bojkotimin e vendimeve të tyre nga drejtues dhe punëtorë me kombësi shqiptare që merreshin me veprimtari sabotuese, vjedhje, shkatërrim të të dhënave financiare dhe mungesa të organizuara; ... Marrëdhëniet ndërmjet punëtorëve të kombësisë shqiptare dhe të tjerëve në shërbimet shëndetësore u prishën në mënyrë dramatike sepse ata me votë i mundnin jo shqiptarët. Mjekë të shumtë shqiptarë, pjesëmarrës në lëvizjen secesioniste, u jepnin trajtime të ndryshme pacientëve në varësi të përkatësisë së tyre kombëtare. Prandaj, Kuvendi i Serbisë miratoi masa ndaluese në 13 institucione shëndetësore në krahinë duke përfshirë edhe fakultetin e mjekësisë. Në gjysmën e dytë të vitit 1990 rreth 1200 punëtorë që i përkisnin pakicës kombëtare shqiptare braktisën me dashje postet e tyre të punës në institucionet shëndetësore”.

### 1.3. Konkluzione

69. Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974 solli barazimin e plotë të institucioneve të republikave dhe KSA-ve dhe statusin e njëjtë konstitutiv në nivel të Federatës në proceset vendimmarrëse në pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. I vetmi dallim i rëndësishëm mes Republikave dhe KSA-ve mbeti karakterizimi i republikave si shtete ndërsa KSA-të quheshin

komunitete socio-politike. Në lidhje me dallimin ndërmjet kombeve dhe kombësive, në doktrinën kushtetuese jugosllave u nxorr përfundimi se të drejtën e vetëvendosjes duke përfshirë shkëputjen e kishin vetëm kombet dhe për rrjedhojë Republikat, por jo kombësitë dhe KSA.

70. Kjo doktrinë mund të kritikohet. Siç del nga shkrimi i prof. Ratko Markoviçit i cituar më lart, statusi autonom i Kosovës dhe pozita e shqiptarëve si pakicë kombëtare nuk janë krijuar me Kushtetutën Federative të vitit 1946, madje as me Kushtetutën e Serbisë. Megjithatë, kjo do të thotë se edhe nga këndvështrimi historisë së partisë ortodokse komuniste, vendimi i parë i organeve më të larta të Kosovës për aneksimin e Kosovës në Serbi ishte një akt i vetëvendosjes. Së dyti, referenca historike për sesionin e dytë të AVNOJ-it nuk mund të vërtetojë argumentin se vetëm ata popuj të renditur atje gëzonin statusin e kombeve njëherë e përgjithmonë. Është fakt se myslimanët e BeH-së që shiheshin vetëm si grup fetar pas vitit 1945 fillimisht u njohën si grup etnik dhe më në fund si „komb” sipas sistemit kushtetues të vitit 1974.<sup>69</sup> Për dallim nga arsytimi i Gjykatës Kushtetuese të Jugosllavisë në lidhje me shqiptarët e Kosovës, as tekstet e së drejtës kushtetuese serbe, kroate apo sllovene<sup>70</sup> nuk argumentonin — me aq sa mund të shoh — se njohja e myslimanëve si „komb” sipas Kushtetutës së Bosnjë dhe Hercegovinës ka shkelur Kushtetutën Federative.

71. Përpjekjet e para për ta kapërcyer asimetrinë e pretenduar të Kushtetutës së RSFJ-së ishin propozimet për ndryshimin e Kushtetutës së RSFJ-së në vitin 1987. Megjithatë, u shty reforma e madhe e marrëdhënieve federative dhe marrëdhënieve mes RSS-së dhe KSA-ve. Ndryshimet e miratuara në vitin 1988 sollën vetëm rregullime të vogla, por i lanë të paprekura institucionet dhe kompetencat e KSA-ve.

72. E njëjta gjë nuk mund të thuhet për amendamentet e kushtetutës së RSS në 1989. Pretendimi politik se autonomia e Kosovës u hoq përmes

---

69 Shih Preambulën e Kushtetutës së Republikës Socialiste të Bosnjës dhe Hercegovinës të vitit 1974 në *Ustavi i ustavni zakoni. Prvi dio. Tekstovi ustava i ustavnih zakona* (Kushtetutat dhe ligjet kushtetuese. Pjesa e Parë. Tekste të Kushtetutave dhe ligjeve kushtetuese), Informator, Zagreb 1974, fq. 61.

70 Jovan Gjorgjeviç, *Ustavno Pravo*, Beograd 1984; Smiljko Sokol/Ljubomir Valkoviç (Ljubomir Valkoviç), *Komentar Ustave Socijalističke Federativne Republike Jugoslavije*, Zagreb 1990; Majda Strobl/Ivan Kristan/ Ciril Ribičič (Ciril Ribičič), *Ustavno Pravo SFR Jugoslavije*, Ljubljana 1986.

këtyre amendamenteve është — nga këndvështrimi kushtetues — i gabuar. Ndryshimet e miratuara në lidhje me kompetencat në veçanti të asambleve të KSA-ve devijuan nga i gjithë sistemi kushtetues i vitit 1974, për aq sa kushtetuta e RSS në lidhje me KSA-të ndoqi marrëdhëniet e Federatës me Republikat. Megjithatë, ato nuk kundërshtonin shprehimisht kushtetutën e RSFJ-së pasi që teksti i kësaj kushtetute mbeti i heshtur për marrëdhëniet specifike ndërmjet Republikës së Serbisë dhe KSA-ve. Vetëm institucionet e KSA-ve ishin të garantuara me kushtetutën federative, por asnjë prej tyre nuk u shfuqizua me këto ndryshime. Megjithatë, këto ndryshime kushtetuese i dobësuan kompetencat e institucioneve të KSA-ve, pasi që ato siguruan bazën për t'i vënë ato nën kontrollin e institucioneve të republikës.

73. Megjithatë, ngjarjet politike në lidhje me ato ndryshime, ngrenë dyshime serioze për legjitimitetin dhe ligjshmërinë e tyre.

74. Në fillim të viteve 1980, reagimi ndaj krizës politike dhe ekonomike në Kosovë nga Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë dhe institucionet shtetërore në nivel federativ dhe të republikës ishte i dyfishtë: shtypja me ligj penal në një rën anë, zhvillimi ekonomik në anën tjetër.

75. Së pari, të gjitha pretendimet politike të demonstruesve shqiptarë të Kosovës për barazi dhe për ta ngritur statusin e KSA të Kosovës në Republikë, të paktën që nga viti 1981, u interpretuan si pretendim për ndarje nga Serbia ose, madje edhe shkëputje nga Jugosllavia për të krijuar një „Shqipëri të Madhe.” Prandaj, pretendimet u shtypën si „kundërrevolucionare” sipas dispozitës përkatëse të Kodit Penal Jugosllav.<sup>71</sup>

76. Ata shqiptarë të Kosovës të dënuar për thirrjen „Kosova-Republikë” në demonstrata publike u dënuan me disa vite burg. Përpjekjet e tyre për

---

71 Shih nenin 114 Krivični Zakon SFRJ, Službeni list SFRJ, br. 44/1976. Ndërmjet viteve 1981 dhe 1987, 1200 persona janë dënuar penalisht, 4000 janë dënuar në procedura kundërvajtëse për vepra nacionaliste. Në të njëjtën periudhë 240 punonjës policie janë shkarkuar për shkak të „veprimtarisë armike” apo „pikëpamjeve të papranueshme”. Ndaj 49 prej tyre janë hapur procedura penale. Dhe Ministri i Mbrojtjes, Branko Mamula, deklaroi në shtator 1987 se 216 grupe ilegale shqiptare ishin zbuluar në ushtrinë jugosllave. Shih Jens Reuter, *Die politische Entwicklung in Jugoslawien (Zhvillimi politik në Jugosllavi)*, *aus politik und zeitgeschichte*, B 6/1988, fq. 6 bazuar në raportet në NIN, 28 qershor 1987 dhe NIN, 27 shtator 1987.

të apeluar dënimet e tyre në Gjykatën Federative të Apelit me arsyetimin se ishte shkelur liria e tyre e garantuar me Kushtetutë, u refuzuan plotësisht si „qartësisht të pabazuara” pa asnjë arsyetim në lidhje me çështjet e të drejtave të tyre njerëzore.<sup>72</sup>

77. Ky gjykim dhe teksti i katalogut të të drejtave të njeriut në kushtetutën e RSFJ-së ku parashikohet një kufizim i përgjithshëm i të drejtave të njeriut „në interes të komunitetit socialist” (neni 153) tregon se në një sistem njëpartiak komunist pa ndarje të shtetit dhe partisë, demonstratat dhe pretendimet politike për reformë kushtetuese mund të interpretohen nga prokurorët dhe gjykatat ose si shprehje demokratike të vullnetit të popullit ose si akt kundërrevolucionar në kuptimin e Kodit Penal.

78. Së dyti, në fakt gjithnjë e më shumë serbë dhe malazezë emigruan nga Kosova për shkak të situatës së rëndë ekonomike,<sup>73</sup> pra të gjitha programet për zhvillimin më të shpejtë ekonomik të Kosovës të miratuara nga Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë dhe institucionet shtetërore padyshim që nuk patën efekt.<sup>74</sup>

79. Gjithashtu, që nga viti 1985, përmes demonstratave serbët e Kosovës kishin filluar një fushatë për të informuar autoritetet partiake dhe shtetërore në Kosovë dhe Beograd dhe publikun për diskriminimin dhe shtypjen e tyre të pretenduar.<sup>75</sup>

80. Këto pretendime të lëvizjes bazë të serbëve të Kosovës dhe kritikata e juristëve kushtetues serbë të përshkruara më lart, më në fund u përvetësuan nga udhëheqja e partisë komuniste serbe, pasi Slobodan Millosheviqi ishte bërë kryetar i Lidhjes së Komunistëve të Serbisë

---

72 Shih *Ligji Jugosllav* Nr. 2/1988, fq. 117-8.

73 Shih shifrat e hulumtimit të dhëna nga Momčilo Pavloviq (Momčilo Pavlović), “Kosovo under Autonomy, 1974 – 1990”, në: Charles Ingrao and Thomas A. Emmert (red.), *Confronting the Yugoslav Controversies. A Scholars’ Initiative*, Purdue University Press, vëll. 2, 2013 fq. 48 – 80.

74 Shih dokumentet e mëposhtme: Platforma Politike për Veprim nga Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë në lidhje me zhvillimin e vetëmenaxhimit socialist, vëllazërisë, unitetit dhe shpirtit të komunitetit në Kosovë, në: *Anketa Jugosllave*, shkurt 1982, fq. 31 – 70; Zhvillimi i Republikave të Pashvilluara dhe Krahinës së Kosovës, 1981 – 1985 dhe Politika Zhvillimore, 1986 – 1990, *Anketa Jugosllave*, Nr. 4/1987, fq. 21 – 40.

75 Shih Viktor Meier, *Wie Jugoslawien verspielt wurde* (Si u humb Jugosllavia), München 1995, f. 74 dhe një analizë e detajuar mbi „Serbët e Kosovës, Intelektualët Nacionalistë Serbë dhe Zyrarët e Regjimit të Millosheviqit” në Pavloviq, “Kosovo under Autonomy”, fq. 66 – 74.

në vitin 1986. Në vijim ai i eliminoi me sukses kundërshtarët e tij për çështjen e Kosovës në funksione shtetërore dhe partiake. Pika e fillimit ishte mbledhja e 8-të plenare e KQ të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë në vjeshtën e vitit 1987, ku ai arriti t'i diskreditojë kundërshtarët e tij në parti për shkak të pozicionit të tyre të dobët ndaj Kosovës. Si pasojë, kreu i partisë komuniste të Beogradit, Dragisha Pavloviq (Dragiša Pavlović) dhe ish-kryetari i Beogradit dhe anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, Bogdan Bogdanoviq (Bogdan Bogdanović), dhanë dorëheqjen. Në nëntor 1987 dha dorëheqjen edhe kreu i Presidencës së Shtetit Serb, Ivan Stamboliq (Ivan Stambolić).<sup>76</sup> Pra, Millosheviqi de facto kishte fituar pushtetin mbi funksionet partiake dhe shtetërore në Serbi.<sup>77</sup>

81. Si kritikant e serbëve të Kosovës ashtu edhe të juristëve kushtetues serbë kishin synuar tashmë një rishikim të kushtetutës së RSS-së në mënyrë që ta vinte Kosovën sërish nën kontrollin e institucioneve të republikës. Pasi rezistencës nga komitetet dhe krerët e partisë komuniste në krahina, u organizuan demonstrata masive nga Aleanca Socialiste Serbe.<sup>78</sup> Protestat masive të 100.000 personave kundër të ashtuquajturve „autonomistë” në Vojvodinë arritën kulmin më 6 tetor, kur e gjithë udhëheqja komuniste e institucioneve shtetërore dhe partiake dha dorëheqjen.<sup>79</sup> Pasi një grusht shteti i ngjashëm në Mal të Zi kishte dështuar në tetor 1988, protestuesit ishin më të suksesshëm në janar 1989. Pas dy ditë demonstratash nga më në fund 120.000 persona, presidenti malazez Slobodan Simoviq (Slobodan Simović) dha dorëheqjen. Paskan dorëheqje masive në të gjitha nivelet partiake dhe shtetërore.<sup>80</sup> Mirëpo, këto ngjarje vetëm sa hapën terrenin për ngjarjet vijuese në vetë Kosovën.

82. Në fillim të shkurtit 1989, Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës refuzoi miratimin e amendamenteve të Kushtetutës së

---

76 Shih Thomas Brey, *Jugoslawien in der Zerreißprobe* (Jugosllavia në sprovë), *Osteuropa* (1989), fq. 570.

77 Shih raportin për ngjarjet në Meier, *Jugoslawien*, fq. 76, dhe Reuter, *Jugoslawien im Umbruch* (Jugosllavia në përmbysje), *aus politik und zeitgeschichte*, B 6/1988, fq. 6-7.

78 Shih Meier, *Jugoslawien*, fq. 136-144, dhe Brey, *Jugoslawien*, fq. 570-571.

79 Brey, *Jugoslawien*, fq. 571.

80 Meier, *Jugoslawien*, fq. 151, dhe Brey, *Jugoslawien*, fq. 573.



Serbisë dhe minatorët e Trepçës filluan një grevë urie e cila shumë shpejt u shndërrua në grevë të përgjithshme.<sup>81</sup> Më 27 shkurt 1989, Kryesia e RSFJ-së, pa praninë e anëtarit slloven, votoi për „masa të posaçme” në Kosovë „për të mbrojtur rendin kushtetues, ligjin dhe rendin publik, sigurinë personale dhe pronën e të gjithë qytetarëve dhe pronën publike ...”<sup>82</sup> Kur Kryesia e Partisë e LKJ u mbledh të nesërmen, Milan Kučan (Milan Kučan) ngriti pyetjen se çfarë do të thotë termi „masa të posaçme”. Raif Dizdareviq (Raif Dizdarević) argumentoi se ky term do të kuptohej si „gjendje e plotë e jashtëzakonshme”. Dhe Stane Dolanc, anëtari slloven në Presidencën e Shtetit, më pas argumentoi para Presidencës sllovene se këto masa ishin të ligjshme, por jo kushtetuese, pasi ato u miratuan në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Gjithë Popullit, por jo në bazë të Kushtetutës.<sup>83</sup> Si pasojë, e drejta për tubim paqësor u pezullua, 40.000 shqiptarë u detyruan që të i kthehen punës dhe u vendosën trupa speciale të policisë dhe ushtrisë.<sup>84</sup>

83. Në këto „rrethana të posaçme” Kuvendi i Kosovës më në fund votoi për amendamentet e propozuara të kushtetutës së RSS-së më 23 mars 1989. Menjëherë më pas nga data 27 deri më 29 mars 1989 ndodhën trazira në rrugë. Qindra persona u mbajtën „të izoluar”, d.m.th. u arrestuan në një vend të panjohur pa aktakuzë, apo gjykim dhe qasje në avokat mbrojtës.<sup>85</sup> Sipas Nenad Zakoshek (Nenad Zakošek)<sup>86</sup> „izolimi” u arsyetua nga autoritetet se kishte një bazë ligjore në nenin 53 të Ligjit Krahinor për Punët e Brendshme. Kjo dispozitë u jep organeve të sigurisë së brendshme, në rast të gjendjes së jashtëzakonshme, kompetencën të „kufizojnë lëvizjen e personave ndaj të cilëve ekziston dyshimi i arsyeshëm se do të rrezikonin rendin kushtetues”. Kjo, sipas ligjit, mund të ushtrohet pa kontroll gjyqësor ose parlamentar për sa kohë ekziston situata emergjente.

---

81 Brey, Jugoslawien, fq. 573.

82 Shpallje nga sesioni i Kryesisë së RSFJ-së, *Tanjug*, 28 shkurt 1989.

83 Këtë e raporton Meyer, *Jugoslawien*, fq. 161 – 164 bazuar në arkivat e partisë sllovene.

84 Thomas Brey, *Jugoslawien: Der Vielvölkerstaat zerfällt* (Jugosllavia: Shteti shumëkombësh po shpërbëhet), *Osteuropa* (1991), f. 425.

85 Shih Jens Reuter, Die jüngste Entwicklung im Kosovo (Zhvillimi më i fundit në Kosovë), *Südosteuropa* (1989), fq. 341.

86 Shih Nenad Zakoshek, Nekontrullirano nasilje države (Pushteti i pakontrolluar i shtetit), *Danas*, 30 maj 1989, fq. 12,

84. Megjithatë, një dispozitë e tillë ligjore është në kundërshtim me idenë e të drejtave të njeriut si element thelbësor i parimit të sundimit të ligjit siç argumenton saktë Zakoshek, si dhe hedh dritë mbi të kuptuarit e ligjshmërisë dhe sundimit të ligjit në të kuptuarit e regjimit komunist. Megjithëse pushteti i organeve të sigurisë së brendshme bazohet në ligj, ligji u jep atyre kompetenca të pakufizuara pa asnjë mekanizëm kontrolli. Kjo bie ndesh me kuptimin e ligjit që presupozon ekzistencën e një sfere të të drejtave të patjetërsueshme të individit dhe një garanci për respektimin e këtyre të drejtave edhe me statute me një procedurë të rregulluar saktësisht për kufizimin e të drejtave të njeriut duke përfshirë mekanizmat e kontrollit.

85. Kushtetuta e re serbe e vitit 1990 e uli statusin e KA-ve nën nivelin e vetëqeverisjes lokale. Kuvendet e tyre nuk kanë fuqi legjislative dhe nuk ka më Presidenca, Gjykata Supreme dhe Kushtetuese. Këto ndryshime ishin shkelje e statusit të garantuar me kushtetutë sipas kushtetutës ende të vlefshme të RSFJ-së të vitit 1974 dhe madje edhe të ndalimit të miratuar përmes amendamentit XLVII, pika 2 e kushtetutës së RSS në 1989, që shpallte se „statusi, të drejtat dhe detyrimet e krahinave autonome siç rregullohet me kushtetutën e RSFJ-së nuk duhet të ndryshohen me amendamentet kushtetuese të Republikës Socialiste të Serbisë”. Është në përputhje me shkeljen thelbësore të kushtetutave që miratimi i kushtetutës së re serbe nuk ndoqi procedurën e parashikuar në kushtetutën e RSS 1974, e ndryshuar në 1989. Për më tepër, për shkak të shfuqizimit të Kuvendit të Kosovës me „Ligji për ndërprerjen e punës së Kuvendit dhe Këshillit Ekzekutiv të KSA të Kosovës”, nuk u sigurua pjesëmarrja e paraparë me Kushtetutë e Kuvendit të Kosovës.

86. Funkzioni politik dhe juridik i kësaj kushtetute të re serbe u vlerësua nga Instituti për Studime Evropiane në Beograd në këto terma: „Kushtetuta e Serbisë e miratuar në vitin 1990, e cila ishte rezultat normativ i nacionalizmit autoritar dhe populist, është shembull paradigmatic i abuzimit të ligjit për të siguruar vazhdimësinë e një regjimi politik. ... forma e saj demokratike ... pritej të siguronte strukturën autoritare të qeverisjes bazuar në udhëheqjen e një njeriu. ... Parlamenti është kryesisht një simulim i demokracisë. Vendimet kryesore politike merren nga një person i vetëm, Presidenti i Republikës, ndërsa roli i Parlamentit është që këtyre vendimeve t’u japë një imazh të kushtetutshmërisë ...

Regjimi ka nevojë për Kushtetutën, parlamentin dhe qeverinë në radhë të parë për të legalizuar dhe institucionalizuar pushtetin e vet."<sup>87</sup>

87. Kushtetuta e re për Republikën Federative të Jugosllavisë në vitin 1992 nuk i përmend më Krahinat Autonome, por vetëm dy republikat anëtare Serbinë dhe Malin e Zi si njësi konstitutive. Pra, ekzistenca dhe statusi i KA-ve nuk garantohet më me Kushtetutën Federative, siç ka qenë rasti me kushtetutën e RSFJ-së. Përsëri miratimi i kushtetutës së re federative nuk ka ndjekur procedurën e paraparë me kushtetutën e RSFJ-së. Gjithashtu mënyra e miratimit të kushtetutës ngre dyshime serioze për legjitimitetin e kësaj kushtetute. Sipas vlerësimit të Institutit për Studime Evropiane në Beograd, kjo kushtetutë e re ishte një zëvendësues i paligjshëm dhe jolegjitim për çështjen e pazgjidhur serbe. Në përfundimin e tyre, kjo „kushtetutë lufte” dhe shteti i ri ishin vetëm përpjekje e regjimit serb për të fshehur faktin se njohja e shtetit serb kishte dështuar.<sup>88</sup>

88. Siç shihet nga „Programi” dhe „Plani Operativ”, të miratuara nga Kuvendi serb në vitin 1990, elita politike nën udhëheqjen e Slobodan Millosheviqit donin të merrnin kontrollin e plotë të pothuajse çdo aspekti të jetës në KA të Kosovës dhe të ndryshonin ekuilibrin etnik duke ofruar një program kthimi për serbët dhe malazezët që kishin emigruar. Për shkak të rezistencës së përfaqësuesve shqiptarë të Kuvendit dhe popullatës së Kosovës, ata më pas e zbatuan këtë plan duke shfuqizuar institucionet e garantuara me kushtetutë të krahinës dhe duke marrë në dorë institucionet administrative, gjyqësore dhe komunale si dhe pozita të tjera në ekonomi, shërbim shëndetësor, arsim, TV dhe radio.

89. Sa i përket ligjeve dhe vendimeve të miratuara në „Rrethanat e Posaçme”, tashmë „Ligji për veprimet e agjencive të republikës në rrethana të posaçme” nuk kishte bazë në kushtetutë dhe për rrjedhojë ishte antikushtetues. „Rrethana të posaçme” nuk ishin parashikuar në kushtetutë, por vetëm „gjendja e jashtëzakonshme”.

---

87 Instituti për Studime Evropiane, *Konflikti Ndëretnik dhe Lufta në ish-Jugosllavi*, Beograd 1992, fq. 23-4.

88 Instituti për Studime Evropiane, *Konflikti*, fq. 29.

90. Ligjet për shfuqizimin e Kuvendit të Kosovës dhe Këshillit Ekzekutiv të saj, si dhe të Kryesisë së Kosovës, dhe për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, Kushtetuese dhe anëtarit të Kosovës në Presidencën Federative, po cenonin statusin e Kosovës të garantuar me Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974.

91. Më në fund, shkarkimi i funksionarëve dhe punonjësve publikë dhe masat e tjera paraprake në të gjitha fushat e shtjelluara më lart, jo vetëm që shkelën dispozitat jodiskriminuese të Kushtetutës së RSFJ-së (neni 154), por edhe të drejtat e vetëadministrimit të garantuara me kushtetutë (neni 10 , 11, 13, 14 kushtetuta e RSFJ-së). Në veçanti, neni 14 paragrafi i fundit i Kushtetutës së RSFJ-së i shpall ex constitutione të gjitha aktet dhe aktivitetet që shkelin këto të drejta si jokushtetuese.

92. Mirëpo, siç tregojnë qartë „Programi” dhe „Plani Operativ” dhe 250 vendimet e zbatuara në vitin 1990, këto masa nuk mund të kenë qenë një reagim spontan i autoriteteve serbe. Ato duhet të jenë planifikuar sistematikisht kohë më parë.

# 2

## Pozita dhe kompetencat e organeve të ndryshme shtetërore sipas Kushtetutës së Serbisë të vitit 1990 dhe Kushtetutës së RFJ-së të vitit 1992 dhe legjislacionit përkatës

### 2.1. Presidenti i Republikës Federative të Jugosllavisë

93. Kompetencat e Presidentit të Republikës Federative të Jugosllavisë janë të numëruara në nenin 96 të Kushtetutës së Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ) të vitit 1992<sup>89</sup>:

„Presidenti i Republikës:

- 1) përfaqëson Republikën Federative të Jugosllavisë brenda dhe jashtë vendit;
- 2) shpall ligjet federative me dekret; nxjerr instrumentet e ratifikimit të traktateve ndërkombëtare;
- 3) nominon një kandidat për kryeministër të qeverisë federative, pasi të ketë dëgjuar opinionet e zëdhënësve të grupeve parlamentare në Kuvendin Federativ;

89 Unë përdor përkthimin në anglisht të botuar nga Ministria e Informacionit të Republikës së Serbisë, *Kushtetuta e Republikës Federative të Jugosllavisë*, Beograd 1992.

- 4) i rekomandon Kuvendit Federativ kandidatët për emërim si gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese Federative, gjyqtarë të Gjykatës Federative, Prokuror të Republikës Federative dhe guvernator të Bankës Kombëtare të Jugosllavisë, pasi të kenë marrë opinionin e kryetarëve të republikave anëtare;
- 5) shpall zgjedhjet për Kuvendin Federativ;
- 6) emëron dhe tërheq me dekret ambasadorët e Republikës Federative të Jugosllavisë, në përputhje me rekomandimet e qeverisë federative; pranon letrat kredenciale të të dërguarve të huaj diplomatikë;
- 7) ndan dekorata dhe nderime të Republikës Federative të Jugosllavisë, siç parashihet me statutin federativ;
- 8) jep falje për vepra penale federative;
- 9) kryen funksione të tjera të parapara me këtë kushtetutë”.

94. Sipas nenit 135 të Kushtetutës së RFJ-së, Ushtria e Jugosllavisë është në kohë luftime dhe paqeje nën komandën e Presidentit të Republikës, në bazë të vendimeve të Këshillit Suprem të Mbrojtjes. Presidenti i Republikës kryeson Këshillin Suprem të Mbrojtjes, i cili përbëhet nga Presidenti i Republikës dhe presidentët e republikave anëtare (neni 135, paragrafët 2 dhe 3). Dhe neni 136 parasheh se „Presidenti i Republikës emëron, gradon dhe shkarkon oficerët e shërbimit të Ushtrisë së Jugosllavisë të përcaktuar me ligj federativ; emëron dhe shkarkon kryetarin, gjyqtarët dhe gjyqtarët vlerësues të gjykatave ushtarake dhe prokurorët ushtarakë”.

95. Ajo që është me interes të veçantë këtu është autoriteti komandues mbi Ushtrinë e Jugosllavisë (VJ) dhe ndërveprimi ndërmjet organeve të ndryshme.

Sipas nenit 78, pika 3 e Kushtetutës së RFJ-së, Kuvendi Federativ vendos për luftën dhe paqen dhe mund të shpallë gjendjen e luftës, gjendjen e kërcënimit të afërt të luftës ose gjendjen e jashtëzakonshme. Megjithatë, nëse Kuvendi Federativ nuk është në gjendje të mblidhet, qeveria federative ka kompetencën të shpallë një kërcënim të afërt luftime, gjendje luftime ose emergjence, në varësi të opinionit të Presidentit të Republikës dhe kryetarëve të dhomave të Kuvendit Federativ (neni 99 pika 10).

96. Siç e përcakton kushtetuta, Presidenti i Republikës duhet të bashkëpunojë më pas me Këshillin Suprem të Mbrojtjes, të cilin ai kryeson njëkohësisht. Kjo marrëdhënie është e rregulluar më hollësisht në nenin 41 të Ligjit për Mbrojtjen.<sup>90</sup> Në këtë sfond, Presidenti i RFJ-së më pas, sipas nenit 40 të Ligjit për Mbrojtjen, i kryen këto detyra në përputhje me vendimet e marra nga Këshilli Suprem i Mbrojtjes:

- 1) „1) urdhëron zbatimin e planit të mbrojtjes së vendit;
- 2) komandon Ushtrinë Jugosllave në kohë paqeje dhe luftë;
- 3) përshkruan ndarjen e vendit në njësi territoriale ushtarake.”

97. Sipas nenit 4 të Ligjit për Ushtrinë Jugosllave<sup>91</sup>, Presidenti i Republikës ka këto kompetenca në ushtrimin e rolit të komandantit të Ushtrisë Jugosllave:

- 1) të përcaktojë elementet bazë të organizimit të brendshëm, zhvillimit dhe pajisjes së ushtrisë;
- 2) të përcaktojë sistemin e komandës së ushtrisë dhe të mbikëqyrë zbatimin e sistemit komandues;
- 3) të vendosë për përdorimin e ushtrisë dhe të miratojë planin e përdorimit të ushtrisë;
- 4) të përcaktojë dhe urdhërojë zbatimin e masave për vendosjen e ushtrisë në gjendje gatishmërie në rast të rrezikut të afërt të luftës, gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme;<sup>92</sup>
- 5) të përcaktojë udhëzime për ndërmarrjen e masave për përgatitjen e mobilizimit dhe të urdhërojë mobilizimin e ushtrisë;
- 6) të miratojë rregullat themelore dhe instrumentet e tjera në lidhje me përdorimin e ushtrisë;
- 7) të miratojë rregulla që rregullojnë rendin e brendshëm dhe marrëdhëniet e shërbimit ushtarak;
- 8) të kryejë detyra të tjera në komandimin e ushtrisë, në përputhje me ligjin federativ.

98. Ligji për Ushtrinë Jugosllave përmban dispozita më të detajuara që përcaktojnë kompetencat shtesë të Presidentit të RFJ-së, si p.sh.

- 1) të përcaktojë degët dhe shërbimet e Ushtrisë Jugosllave (neni 2);

---

90 Službeni list SRJ (Gazeta Zyrtare e RFJ-së), Nr. 43/1994. Shih më poshtë 2.6.

91 Sl. I. SRJ, Nr. 43/1994.

92 Shih gjithashtu nenin 8 të Ligjit për Mbrojtjen.

- 2) të caktojë gjeneralë dhe oficerë të tjerë në poste me caktimin e gradës gjeneral (neni 16, paragrafi 1);
- 3) t'i japë leje një ushtaraku që të marrë një dekoratë nga një vend tjetër (neni 34, paragrafi 1);
- 4) me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm, mund të miratojë gradimin e jashtëzakonshëm të oficerit profesionist në gradën gjeneral (neni 46, paragrafi 1);
- 5) të promovojë oficerët profesionistë dhe rezervë në gradat fillestare; të gradojë oficerët e ushtrisë në gradën e gjeneral-majorit ose grada të larta; të marrë vendime për transferimin, statusin e shërbimit, pranimin dhe përfundimin e shërbimit ushtarak të gjeneralëve; të emërojë oficerë me gradën kolonel në poste me gradën e përcaktuar gjeneral (neni 151);
- 6) të zvogëlojë, të zbusë ose të anulojë çdo masë ose dënim disiplinor me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm (neni 168);
- 7) të miratojë rregullat e disiplinës ushtarake (neni 173);
- 8) të vendosë për kthimin e gradës ushtarakut profesionist ose pjesëtarit të forcave rezervë të cilit i është hequr grada (neni 208);
- 9) të vendosë për lirimin e ushtarëve nga shërbimi ushtarak 60 ditë më herët, nëse është në përputhje me kërkesat e rimbushjes dhe gatishmërisë luftarake të ushtrisë (neni 296 paragrafi 3).

Në ushtrimin e këtyre kompetencave, Presidenti i Republikës miraton dekrete, urdhra dhe vendime.

99. Marrëdhëniet mes Presidentit të Republikës dhe Këshillit Suprem të Mbrojtjes është delikate për këto arsye:

Nga njëra anë, Presidenti i Republikës duket se është në pozitë vartëse, duke zbatuar vetëm vendimet e Këshillit Suprem të Mbrojtjes. Nga ana tjetër, megjithatë, ai është në pozitë drejtuese. Këshilli Suprem i Mbrojtjes është një organ kolektiv, i cili nuk është aktiv në formë të përhershme. Për rrjedhojë, Këshilli Suprem i Mbrojtjes është i varur nga Presidenti i Republikës dhe iniciativat e tij për aq sa ai thërret seancat, propozon rendin e ditës, siguron zbatimin e konkluzioneve etj. Për më tepër, Presidenti i Republikës mund të veprojë edhe nëse nuk mbledhet Këshilli Suprem i Mbrojtjes. Sipas nenit 4 të Ligjit për Ushtrinë Jugosllave,



Presidenti i Republikës ka kompetenca autonome për të ushtruar komandën mbi VJ-në. Dispozita që thotë se Presidenti i Republikës verifikon vendimet e Këshillit Suprem të Mbrojtjes duke nxjerrë dekrete, tregon pozicionin e tij dominues.

Për më tepër, duhet të merret parasysh opinioni i tij këshillues de jure në shpalljen e gjendjes së luftës kur Kuvendi Federativ nuk është në gjendje të mblidhet. Në fakt, ai mund të dominonte gjithë procesin e vendimmarrjes nga përcaktimi i gjendjes së luftës, deri te vendimet e Këshillit Suprem të Mbrojtjes dhe komandës operative të Ushtrisë Jugosllave.

100. Për sa i përket shkeljeve të ligjeve të luftës, përgjegjësitë e Presidentit të Republikës do të trajtohen në kapitullin 3.

101. Marrëdhëniet ndërmjet Presidentit të RFJ-së dhe njësive dhe organeve të punëve të brendshme, duke përfshirë policinë, mund të krijohen në gjendje lufte dhe në një situatë emergjente. Neni 17 i Ligjit të vitit 1994 për Mbrojtjen përcakton se: „Në rast të një kërcënimi të afërt lufte, gjendje lufte ose gjendje të jashtëzakonshme, njësitë dhe organet e brendshme mund të përdoren për kryerjen e detyrave luftarake, domethënë të përfshihen në luftime ose rezistencë të armatosur. Në detyrat luftarake, këto njësi dhe organe janë në varësi të oficerit të Ushtrisë Jugosllave që komandon operacionet luftarake”.

102. Përgjegjësia e drejtpërdrejtë e Presidentit të RFJ-së nuk është e specifikuar këtu. Megjithatë, është e qartë se personi që komandon operacionet luftarake nuk mund të ndryshojë me dashje urdhrat e lëshuara dhe vendimet e marra nga Presidenti i RFJ-së. Përfundimi se Presidenti i RFJ-së është përgjegjës rrjedh edhe nga neni 4, paragrafi 2, pika 2 e Ligjit për Ushtrinë Jugosllave, i cili përcakton se ai „monitoron zbatimin e sistemit komandues”.

103. Për më tepër, Plani i Mbrojtjes së vendit është një dokument domethënës për varësinë e forcave të MUP-it prej VJ-së në kohë paqeje. Atë e miraton Këshilli Suprem i Mbrojtjes dhe Kryetari i Këshillit Suprem të Mbrojtjes urdhëron realizimin e tij (neni 40 dhe neni 41 par. 1 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Mbrojtjen). Plani i mbrojtjes së vendit përcakton detyrimet

e qytetarëve dhe organeve shtetërore (përfshirë MUP-in) lidhur me mobilizimin e përgjithshëm dhe organizimin e përgatitjeve të mbrojtjes, si dhe detyrimin e komandave, njërive dhe institucioneve të VJ-së për të vepruar në përputhje me planet për mobilizimin dhe përdorimin e VJ-së dhe urdhrat e Presidentit të Republikës (neni 6 i Ligjit për Mbrojtjen).

104. Kjo do të thotë se është obligim ligjor i MUP-it që në kohë paqeje t'i zbatojë vendimet e Këshillit Suprem të Mbrojtjes në lidhje me organizimin dhe përgatitjen e qytetarëve për luftim (neni 15 i Ligjit për Mbrojtjen).

## 2.2. Presidenti i Republikës së Serbisë

105. Neni 83 i Kushtetutës së Republikës së Serbisë<sup>93</sup> numëron kompetencat e Presidentit të Republikës së Serbisë. Ai duhet të

- 1) i propozon Kuvendit Kombëtar një kandidat për postin e Kryeministrit pasi dëgjon opinionin e përfaqësuesit të shumicës në Kuvendin Kombëtar;
- 2) i propozon Kuvendit Kombëtar kandidatët për Kryetar dhe gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese;
- 3) shpall ligjet me urdhëresë;
- 4) kryen punët në sferën e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Serbisë dhe shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare në pajtim me ligjin;
- 5) komandon forcat e armatosura në kohë paqeje dhe lufte dhe rezistencën popullore në luftë; urdhëron mobilizimin e përgjithshëm dhe të pjesshëm; organizon përgatitjet për mbrojtje në pajtim me ligjin;
- 6) nëse Kuvendi Kombëtar nuk është në gjendje të mblidhet dhe pas marrjes së opinionit nga Kryeministri, vërteton faktin e ekzistencës së rrezikut të afërt të luftës ose shpall gjendjen e luftës;
- 7) me iniciativën e tij ose me propozimin e Qeverisë gjatë gjendjes së luftës ose rrezikut të afërt të luftës, miraton akte të cilat janë në kompetencën e Kuvendit Kombëtar, me kusht që t'ia paraqesë për miratim Kuvendit Kombëtar sapo të jetë në e mundur të

---

93 Sl. gl. RS, Nr. 1/1990.

mblidhet. Nëpërmjet akteve të shpallura gjatë gjendjes së luftës do të mundësohet kufizimi i disa lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, si dhe të ndryshohet organizimi, përbërja dhe kompetencat e qeverisë dhe të ministrive, gjykatave dhe prokurorisë;

- 8) me propozim të Qeverisë, nëse në një pjesë të territorit të Republikës së Serbisë rrezikohet siguria e Republikës së Serbisë, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit ose puna e organeve dhe agjencive shtetërore, shpall gjendjen emergjente dhe nxjerr akte për marrjen e masave të kërkuara nga rrethana të tilla, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin;
- 9) jep falje;
- 10) ndan dekorata dhe çmime të parapara me ligj;
- 11) themelon shërbime profesionale dhe lloje të tjera për kryerjen e punëve nga juridiksioni i tij;
- 12) punët e tjera i kryen në pajtim me Kushtetutën.

106. Edhe pse sistemi institucional i krijuar me Kushtetutën e Serbisë të vitit 1990 nuk mund të quhet sistem presidencial i qeverisjes nga këndvështrimi i qeverisjes krahasuese për shkak të ekzekutivit të dyfishtë dhe votës së mosbesimit (neni 93), Presidenti i Republikës megjithatë ka një pozitë të fortë. Ai zgjidhet drejtpërdrejt nga populli (neni 86) dhe mund të shkarkohet vetëm nga një shumicë prej dy të tretash të të gjithë anëtarëve të Kuvendit Kombëtar (neni 88 paragrafi 2). Ai shkarkohet nëse shumica e votuesve votojnë për shkarkim në referendum (neni 88 paragrafi 3). Presidenti mund ta shpërndajë Kuvendin Kombëtar me propozim të Qeverisë (neni 89). Neni 84 i jep atij një veto pezulluese në procesin legjislativ.

107. Të jashtëzakonshme nga një këndvështrim krahasues janë kompetencat që i jepen Presidentit në rast të gjendjes së jashtëzakonshme, siç janë përshkruar më lart në kapitullin 1.1.4.

108. Sipas nenit 135 paragrafi 2 i Kushtetutës së RFJ-së, Presidenti i Republikës së Serbisë është anëtar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes dhe në këtë mënyrë merr pjesë në autoritetin komandues mbi Ushtrinë Jugosllave. Sipas nenit 83 paragrafi 5 i Kushtetutës së Serbisë, Presidenti i Republikës së Serbisë është edhe komandant i forcave të armatosura.

Këto dy dispozita shkaktojnë konfuzion të konsiderueshëm kushtetues. Teksa kushtetuta e RFJ-së nuk përdor termin „forca të armatosura”, por flet për ushtrinë jugosllave, kushtetuta serbe përdor termin „forca të armatosura”. Asnjë nga kushtetutat nuk e përmend mbrojtjen territoriale (TO).

109. Për të qartësuar kuptimin e termit „forca të armatosura” të përdorur në kushtetutën serbe dhe marrëdhëniet me Ushtrinë Jugosllave, është e nevojshme të shihet historia e sistemit të forcave të armatosura të krijuara sipas kushtetutës së RSFJ-së. Sipas nenit 240 paragrafi 2 të Kushtetutës së RSFJ-së, Forcat e Armatosura të RSFJ-së përbëheshin nga Ushtria Popullore Jugosllave (JNA) si forcë e përbashkët e RSFJ-së dhe mbrojtja territoriale (TO) „si forma më e gjerë e totalit të rezistencës të organizuar dhe të armatosur kombëtare” në Republikat dhe Krahinat Socialiste Autonome. Ligji për Mbrojtjen Gjithëpopullore të RSFJ-së<sup>94</sup> përmbante dispozitat e detajuara për sistemin e komandës dhe kontrollit si mbi JNA-në ashtu edhe mbi TO-në. JNA ishte një ushtri klasike e lëvizshme. TO bazohej në parimin territorial dhe organet kompetente në Republikat dhe Krahinat Autonome ishin të ngarkuar me TO-në. Shtabet e TO-së u krijua në qytete, komuna, komunitet lokale dhe ndërmarrje të mëdha. Organizimi i TO-së kishte për qëllim të krijonte kushte për mbrojtje gjithëpopullore në të gjithë territorin, nga organizatat e punës dhe komunitetet lokale deri në nivelin e Republikës. Kjo duhet t’u mundësonte njësitë të TO-së të operonin me sukses edhe në territoret e pushtuara përkohësisht.

110. Presidenca e RSFJ-së ishte organi suprem i komandës dhe kontrollit të forcave të armatosura të RSFJ-së, përfshirë TO-në. Përveç kësaj, secila republikë dhe krahinë autonome kishte një komandant të TO-së të emëruar nga Presidenca e RSFJ-së me propozimin e republikës ose krahinës autonome përkatëse.

111. Pozita e TO-së në Republikën e Serbisë u ndryshua me kushtetutën e re të vitit 1990. Teksa neni 296 i Kushtetutës së RSS-së e kishte përcaktuar TO-në serbe si pjesë e forcave të armatosura të RSFJ-së dhe përcaktonte organizimin e TO-së në nivel të Republikës, Krahinave Autonome dhe

---

94 Sl. I. SFRJ, Nr. 21/1982.

Komunave si pjesë e një sistemi të unifikuar të mbrojtjes gjithëpopullore të RSFJ-së, kushtetuta e re serbe e vitit 1990 nuk përmban asnjë dispozitë për mbrojtjen territoriale.

112. Sidoqoftë, Kuvendi Kombëtar miratoi një ligj të ri për mbrojtjen në vitin 1991.<sup>95</sup> Megjithatë, ky ligj nuk e rregullonte organizimin e forcave të armatosura, por nëni 5 paragrafi 1 tregonte se do të miratohej një ligj i veçantë. Nëse interesat e Republikës së Serbisë rrezikohen para miratimit të ligjit të veçantë, nëni 5 paragrafi 2 parasheh përdorimin e TO-së në përputhje me këtë ligj.

Sipas nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit për Mbrojtjen, TO si pjesë e sistemit ende ekzistues të forcave të armatosura të përbashkëta të RSFJ-së, duhej të mbronte integritetin territorial dhe rendin kushtetues të RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë. Një kapitull i veçantë në Ligjin për Mbrojtjen i kushtohet TO-së (nenet 31 deri në 67).

113. Sipas nenit 6 të Ligjit për Mbrojtjen, Presidenti i Republikës kishte këto kompetenca. Ai

- 1) drejton forcat e armatosura në kohë paqeje dhe lufte dhe është i autorizuar të zgjidhë çështje organizative dhe personeli në fushën e mbrojtjes së territorit;
- 2) miraton planin e mbrojtjes së Republikës së Serbisë si dhe dokumentet e tjera që përcaktojnë masat për organizimin dhe zbatimin e përgatitjeve të mbrojtjes;
- 3) urdhëron zbatimin e masave të gjendjes së gatishmërisë dhe masave të tjera të nevojshme;
- 4) përcakton parimet e organizimit dhe fuqisë së forcave policore në rast të rrezikut të afërt të luftës dhe në gjendje lufte;
- 5) mund të urdhërojë përdorimin e policisë në luftë, gjatë një kërcënimi të afërt lufte dhe në çdo situatë tjetër emergjente për të mbrojtur të drejtat dhe përgjegjësitë kushtetuese të Republikës dhe të qytetarëve të saj.

---

95 Sl. gl. RS, Nr. 45/1991.

Siç shihet nga këto kompetenca, Presidenti i Republikës kishte ndikim vendimtar në të gjitha aspektet e mbrojtjes së Republikës.

114. Për më tepër, ligji parashikonte një ngritje intensive të TO-së në Republikën e Serbisë. Në dispozitat kalimtare ishte përcaktuar një plan i ngjeshur për transferimin e përgjegjësive, pajisjeve dhe materialeve nga mbrojtja gjithëpopullore tek Republika e Serbisë. Në atë mënyrë, në pritje të miratimit të ligjit për Forcat e Armatosura të Republikës së Serbisë, TO praktikisht funksiononte si forca të armatosura të Republikës së Serbisë.

115. Në anën tjetër, TO e Republikës së Serbisë, sipas Kushtetutës ende të vlefshme të RSFJ-së, de jure mbeti nën komandën e Presidencës së RSFJ-së dhe jo të Presidentit të Republikës së Serbisë. Sipas neneve 113 dhe 115 të Ligjit për Mbrojtjen Gjithëpopullore, komandantët e TO-ve të Republikave dhe Krahinave Autonome ishin përgjegjës para Presidencës së RSFJ-së për sa i përket performancës së tyre, gatishmërisë luftarake, përdorimit të njësive dhe instalimeve, dhe komandimi dhe kontrolli ishin në përputhje me komandën dhe kontrollin e forcave të armatosura.

116. Si mund të përputhen autoritetet e ndryshme komanduese mbi „forcat e armatosura” sipas Kushtetutës së RFJ-së dhe Kushtetutës serbe?

117. Pas miratimit të Kushtetutës së RFJ-së dhe Ligjit për Ushtrinë Jugosllave, Presidenti i Republikës së Serbisë — nga pikëpamja kushtetuese — merr pjesë vetëm përmes Këshillit Suprem të Mbrojtjes në autoritetin komandues mbi VJ-në. Megjithatë, ai kishte autoritet të plotë komandues mbi TO të Republikës së Serbisë në vend të ish-Presidencës së RSFJ-së, pasi kushtetuta e RFJ-së nuk e parashikonte më një autoritet të tillë komandues për Presidentin e RFJ-së. Autoriteti i tij komandues mbi TO-në, sipas Kushtetutës serbe, nënkuptohet në kompetencën për të komanduar „forcat e armatosura” të Republikës së Serbisë.

118. Megjithatë, të dyja kushtetutat parashikojnë shpalljen e gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme. Sipas nenit 78, pika 3 e Kushtetutës së RFJ-së, kjo është kompetencë e Kuvendit Federativ dhe sipas nenit 99 të Kushtetutës së RFJ-së të Qeverisë Federative, nëse Kuvendi nuk mund të mbledhet, Presidenti mund të shpallë gjendjen e

luftës. Sipas nenit 83 të Kushtetutës së Serbisë, Presidenti shpall gjendjen e luftës dhe gjendjen e jashtëzakonshme, e cila megjithatë është e kufizuar në një pjesë të territorit të Republikës.

Nga fakti se Kushtetuta e Republikës së Serbisë kishte për qëllim të përgatiste bazat juridike për një shtet të pavarur, siç u përmend më lart në kapitullin 1.1.4., është e qartë se këto dispozita të kushtetutës së RFJ-së dhe kushtetutës serbe nuk janë harmonizuar kurrë.<sup>96</sup>

119. Për sa i përket marrëdhënieve ndërmjet Presidentit të Republikës dhe Ministrisë së Brendshme të Serbisë (MUP i Serbisë), Presidenti i Republikës nuk ka autoritet të drejtpërdrejtë<sup>97</sup> mbi MUP-in sipas dispozitave kushtetuese për sistemin parlamentar të qeverisjes.<sup>98</sup> Por bazuar në dispozitën përkatëse të nenit 83 të kushtetutës të cituar më lart, neni 17 i Ligjit për Qeverinë e Republikës së Serbisë<sup>99</sup> parasheh që Qeveria t'i dorëzojë propozim Presidentit të Republikës së Serbisë për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme<sup>100</sup> dhe propozon dokumente që përmbajnë masa që duhet të ndërmerren nëse në një pjesë të territorit të Republikës kërcënohet siguria, liria dhe të drejtat e njeriut ose funksionimi i organeve të qeverisjes. Neni 17 i Ligjit për Punët e Brendshme të Republikës së Serbisë<sup>101</sup> pastaj përcakton se MUP-i do të ndërmarrë masa për mbrojtjen e sigurisë së Republikës dhe qytetarëve të saj në bazë të urdhrave dhe instrumenteve të tjera të lëshuara nga Presidenti i Republikës së Serbisë. Përfundimisht, sipas nenit 6, pikat 4 dhe 5 të Ligjit për Mbrojtjen, kompetencat që i janë dhënë Presidentit të Republikës përfshijnë vetëm policinë dhe jo MUP-in në tërësi.<sup>102</sup> Në këtë

---

96 Shih Sl. lista SRJ, Nr. 34/1992 dhe Nr. 29/2000.

97 Budimir Babović (Budimir Babović), *Analiza e Rregulloreve në lidhje me Përgjegjësinë për Kontrollin e Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë*, Beograd 2003, në § 74f është i gabuar në këtë aspekt nga pikëpamja e ligjit kushtetues. Është e vërtetë se ministrinë zbatojnë edhe aktet e përgjithshme të Presidentit sipas nenit 94 paragrafi 2, por paragrafi 3 parasheh që ministrinë janë të pavarura.

98 Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë të shkarkojë asnjë nga ministrat dhe nuk ka të drejtë të propozojë votëbesimin Qeverisë apo ndonjë ministri të veçantë.

99 Sl. gl. RS, Nr. 5/1991.

100 Megjithatë, në nenin 18 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Serbisë, përcaktohet se Qeveria në gjendje lufte ose në rrezik të afërt lufte i propozon Presidentit të Republikës të veprojë për çështjet në kompetencë të Kuvendit Kombëtar. Kjo dispozitë tregon se autoritetet komanduese të të dy presidentëve nuk janë të harmonizuara në nivel statutor.

101 Sl. gl. RS, Nr. 44/1991.

102 Policia është organizatë për ruajtjen e rendit publik dhe ligjit. Prandaj policia është pjesë e

kontekst, policia perceptohet si një element i sistemit të mbrojtjes nën autoritetin komandues të Presidentit të Republikës.

120. Neni 9 i Ligjit për Punët e Brendshme parasheh që ministri është i detyruar të paraqesë raport për punën e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe për gjendjen e sigurisë në Republikë, nëse kërkohet nga Kuvendi Kombëtar dhe Presidenti i Republikës. Megjithatë, kërkesa drejtpërdrejt nga Ministri i Punëve të Brendshme, është në kundërshtim me nenin 85 të Kushtetutës së Republikës së Serbisë.

121. Kompetenca shumë domethënëse i janë dhënë Presidentit të Republikës së Serbisë në Ligjin për gradat e anëtarëve të MUP-it të miratuar në vitin 1995.<sup>103</sup> Ky ligj i mundësoi Presidentit të forcojë dhe të ushtrojë drejtpërdrejt ndikimin e tij mbi shërbimin policor në Serbi. Sipas nenit 6, „gjeneralët dhe zyrtarët e autorizuar në postet për të cilat kërkohet grada gjeneral sipas specifikave të vendit të punës emërohen dhe gradohen nga Presidenti i Republikës”. Për këtë arsye, vendimet më të rëndësishme të personelit janë vënë në duart e Presidentit pasi që praktikisht për të gjitha pozitat drejtuese në MUP-in e Serbisë (ndihmës ministra dhe shefa të administratës) kërkohet grada e gjeneralit. Sipas nenit 13 të Ligjit për Gradat, ai u bë edhe instanca më e lartë disiplinore për ata punonjës të MUP-it që kishin marrë gradën gjeneral.

122. Më 21 prill 1997, Presidenti Millosheviq nxori vendimin që RDB, Departamenti i Sigurisë së Shtetit, tash e tutje do të punonte „në përputhje me udhëzimet e Presidentit të Republikës dhe të Qeverisë së Republikës së Serbisë”.<sup>104</sup> Kjo do të thotë se ministri i Brendshëm u la mënjanë zyrtarisht.

### 2.3. Zëvendëskryeministri i RFJ-së

123. Sipas nenit 68 të Ligjit për Mbrojtjen, njësitë e mbrojtjes civile angazhohen në operacione të mbrojtjes dhe shpëtimit nga shkatërrimet

---

strukturës së MUP-it, por vetë MUP-i ka shumë detyra të tjera. Shih Ligjin për Ministrinë e Serbisë, Sl. gl. RS Nr. 7/1991 dhe Baboviq, *Analizë*, § 33.

103 Sl. gl. RS, Nr. 53/1995.

104 Materiali provues i TPNJ, K0227740.



e shkaktuara nga lufta, fatkeqësitë natyrore dhe katastrofat dhe rreziqet si në kohë paqeje ashtu edhe në luftë.

124. Sipas nenit 84, paragrafi 1 i Ligjit për Mbrojtjen, Zëvendëskryeministri është komandant i mbrojtjes civile. Megjithatë, rregullat që rregullojnë organizimin dhe ngritjen e njërive të mbrojtjes civile, shtabet dhe komisarët caktohen nga Ministri i Mbrojtjes (neni 86).

## 2.4. Ministri i Brendshëm i Serbisë

125. Sipas Ligjit për Punët e Brendshme të vitit 1991, Ministri i Punëve të Brendshme është i autorizuar që:

- 1) të caktojë fushën e punës së njërive organizative, organizimin e tyre, selinë dhe territorin për të cilin janë themeluar (neni 6 paragrafi 2);
- 2) të rregullojë mënyrën se si kryhen detyrat e MUP-it (neni 7);
- 3) të nxjerrë rregullore për dokumentet zyrtare të identifikimit dhe armët e zyrtarëve të autorizuar (neni 18, paragrafi 4) dhe punonjësve që kryejnë detyra të caktuara (neni 26, paragrafi 6);
- 4) të thërrasë personat nga forca rezervë që të kryejnë detyra të caktuara të MUP-it në kohë paqeje, „... dhe veçanërisht të parandalojë aktivitetet që kanë për qëllim kërcënimin e sigurisë së Republikës, të parandalojë çrregullimet e qetësisë dhe të rivendosë rendin dhe ligjin pas trazirave të mëdha dhe të ofrojë ndihmë në rast rreziku të përgjithshëm të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore” (neni 28).

126. Sipas nenit 6 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të MUP-it, të datës 5 qershor 1996, ai mund të formojë njësi speciale dhe të specializuara, grupe operationale ose njësi të tjera të specializuara.<sup>105</sup> Caktimi në poste për të cilat nuk kërkohet grada gjeneral është në kompetencë të Ministrit të Brendshëm sipas nenit 6 të Ligjit për Gradat.

---

105 Baboviq, *Analiza*, § 87.

127. Sipas nenit 17 të Ligjit për Punë të Brendshme, MUP-i i Serbisë zbaton drejtpërdrejt „urdhrat dhe aktet e dhëna nga Presidenti i Republikës së Serbisë me qëllim të përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme”. Prandaj ministri në këtë drejtim është në vartësi.

128. Megjithatë, siç mund të shihet nga vendimi i Millosheviqit i vitit 1997 më lart, ministri zyrtarisht u la mënjanë në drejtimin e MUP-it.

## 2.5. Komanda Supreme dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Jugosllavisë

129. Në vitin 1987, Kryesia e RSFJ-së miratoi një vendim për ndryshimin e emrit nga Shtabi i Përgjithshëm i JNA-së në Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.<sup>106</sup> Ky vendim pati efektin e krijimit të një Shtabi të Përgjithshëm të përbashkët për të dy pjesët përbërëse të Forcave të Armatosura, JNA dhe TO. Kështu, TO pushoi së qeni në varësi të drejtpërdrejtë të Presidencës së RSFJ-së, dhe kaloi në vartësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe zonës strategjike ushtarake.

130. Kushtetuta e RSFJ-së nuk e përmend termin „komandë supreme”. Termi Shtabi i Komandës Supreme u shfaq për herë të parë në ndryshimet e vitit 1991 në Ligjin për Mbrojtjen Gjithpopullore. Neni 106 rregullon më hollësisht dispozitat kushtetuese që kanë të bëjnë me Presidencën e RSFJ-së si organ suprem i komandës dhe kontrollit të forcave të armatosura. Sipas nenit 79 të Ligjit për Mbrojtjen Gjithëpopullore, Sekretariati Federativ për Mbrojtjen Kombëtare vepronte si Shtabi i Komandës Supreme të Forcave të Armatosura të RSFJ-së.

131. Sipas Ligjit për Ushtrinë Jugosllave, Shtabi i Përgjithshëm i VJ-së tani është organi më i lartë profesional dhe shtabi për përgatitjen dhe përdorimin e ushtrisë në kohë paqeje dhe lufte (neni 5, paragrafi 1).

---

106 Gazeta Zyrtare Ushtarake, Nr. 27/1987.

132. Në përputhje me parimet themelore të organizimit, zhvillimit dhe themelimit të Ushtrisë Jugosllave dhe akteve të miratuara nga Presidenti i RFJ-së, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm ka këto kompetenca sipas nenit 5, paragrafi 2 i Ligjit për Ushtrinë Jugosllave:

- 1) të përcaktojë organizimin, planet zhvillimore dhe ngritjen e komandave, njërive dhe institucioneve të ushtrisë;
- 2) të përcaktojë planet e rekrutimit dhe rimbushjes së ushtrisë dhe numrin e rekrutëve;
- 3) të miratojë rregullat e stërvitjes ushtarake në ushtri;
- 4) të hartojë programe edukimi dhe trajnimi për oficerët profesionistë dhe rezervë;
- 5) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Me qëllim të zbatimit të instrumenteve të miratuara nga Presidenti i RFJ-së dhe kryerjes së detyrave komanduese ushtarake dhe detyrave të tjera të parapara me ligj, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm nxjerr rregulla, urdhra, direktiva, udhëzime dhe dokumente të tjera (neni 6, paragrafi 1 i këtij Ligji për Ushtrinë Jugosllave).

133. Ka edhe kompetenca të tjera të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të rregulluara në Ligjin për Ushtrinë Jugosllave:

- 1) vendos për personat për organet e sigurisë dhe të policisë ushtarake (neni 30 paragrafi 2);
- 2) mund të gradojë në mënyrë të jashtëzakonshme nënoficerë profesionistë dhe oficerë profesionistë në gradën tjetër më të lartë (neni 46, paragrafi 2);
- 3) në nenin 152 janë të rregulluara autoritete të tjera në gradimin e oficerëve të VJ-së.

## 2.6. Këshilli Suprem i Mbrojtjes

134. Dispozitat kushtetuese për përbërjen e Këshillit Suprem të Mbrojtjes tashmë janë përshkruar më lart në 2.1.

135. Llogaridhënia e përbashkët dhe individuale e Këshillit Suprem të Mbrojtjes nuk është e specifikuar në Kushtetutë, në Ligjin për Mbrojtjen, madje as në Rregullore.

136. Mundësia e vetme është që secili prej tre anëtarëve të ketë përgjegjësi subsidiare politike nga pikëpamja e pozitive të tyre si Presidentë të RFJ-së dhe të Republikave. Nga ky këndvështrim, Presidenti i RFJ-së është në pozitë më të fortë si kryetar i shtetit dhe kryetar i Këshillit të Mbrojtjes. Marrë parasysh rolin e tij vendimtar në sistemin e mbrojtjes së RFJ-së dhe në kuadër të VJ-së, ai duhet të mbajë më shumë përgjegjësi.

137. Kompetencat e Këshillit Suprem të Mbrojtjes janë përcaktuar më afër në nenin 41 të Ligjit për Mbrojtjen: ai

- 1) miraton planin e mbrojtjes së vendit;
- 2) merr vendime në bazë të të cilave Presidenti i RFJ-së komandon Ushtrinë Jugosllave;
- 3) vlerëson kërcënimet e mundshme të luftës dhe rreziqe të tjera të rëndësishme për sigurinë dhe mbrojtjen e vendit;
- 4) përcakton sasinë e pajisjeve dhe armëve të nevojshme për mbrojtjen e vendit;
- 5) përcakton kërkesat për rregullimin e territorit për mbrojtje;
- 6) përcakton strategjinë e luftës së armatosur dhe rregullat e punësimit të forcave për mbrojtjen e vendit dhe zhvillimin e luftës;
- 7) miraton elementet bazë për zhvillimin e planeve dhe programeve të trajnimit për qëllime të mbrojtjes;
- 8) kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj federativ.

138. Organizimi dhe përgatitja e qytetarëve për luftim bëhet si në VJ ashtu edhe në „njësitë dhe organet e brendshme” (neni 15 i Ligjit për mbrojtjen). Kjo do të thotë se është obligim ligjor i MUP-it që në kohë paqeje t'i zbatojë vendimet e Këshillit Suprem të Mbrojtjes në lidhje me organizimin dhe përgatitjen e qytetarëve për luftim.

## **2. 7. Departamenti Shtetëror i Sigurisë, Departamenti i Sigurisë Publike dhe Stafi i MUP-it në Kosovë dhe Metohi**

139. Ministria e Punëve të Brendshme serbe sipas Ligjit për Punët e Brendshme të vitit 1991 përbëhet nga dy shërbime bazë, të quajtura departamente: Departamenti i Sigurisë Shtetërore (RDB) dhe Departamenti i Sigurisë Publike (RJB). RDB-ja është përgjegjës për aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e sigurisë së Republikës

së Serbisë dhe parandalimin e aktiviteteve që synojnë cenimin ose rrëzimin e rendit kushtetues (neni 1 i Rregullores për Organizimin e Brendshëm të MUP-it të Serbisë).<sup>107</sup>

140. Departamenti i Sigurisë Publike është përgjegjës për aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e jetës dhe sigurisë personale dhe pronësore të qytetarëve; parandalimin dhe zbulimin e krimeve; ruajtjen e rendit dhe ligjit; sigurimin e sigurisë në tubime dhe mbledhje të tjera të qytetarëve; sigurimin e personave dhe objekteve të caktuara; sigurinë e trafikut rrugor; kontrollin e vendkalimeve kufitare shtetërore; mbrojtjen nga zjarri; shtetësinë; letërnjoftimet personale; rezidencën dhe vendbanimin e qytetarëve.

141. Departamenti drejtohet nga një shef i cili organizon punën e tij dhe është përgjegjës për të. Në parim, ai gëzon një shkallë të lartë pavarësie në marrjen e vendimeve. Megjithatë, në rastin e vendimeve të rëndësishme, ai duhet të konsultohet me ministrin, i cili nga ana e tij mund ta vendosë çështjen në agjendën e stafit të tij të specializuar. Shefi i departamentit mund të krijojë staf të përhershëm ose të përkohshëm.

142. Bazuar në këtë autoritet, më 15 gusht 1998, shefi i RJB-së vendosi të themelojë Shtabin e MUP-it për KA të Kosovës dhe Metohisë. Përgjegjës i këtij Shtabi është emëruar gjeneral-major Sreten Lukiq (Sreten Lukić), zëvendës shef i SUP-it të Beogradit.<sup>108</sup> Një muaj më vonë, më 16 qershor 1998, u formua Shtabi i MUP-it të Serbisë për Parandalimin e Terrorizmit dhe komandant i saj u emërua sërish Sreten Lukiq. Ai kishte për detyrë „planifikimin, organizimin dhe kontrollin e punës dhe angazhimit të njësive organizative të Ministrisë dhe të njësive të ridislokuara dhe të bashkangjitura në parandalimin e terrorizmit në zonën e Kosovës dhe Metohisë”.<sup>109</sup> Pra, është e qartë se aktivitetet e tij nuk kanë qenë për të gjithë Serbinë, por vetëm për Kosovën dhe Metohinë. Shefi i Shtabit duhej të përgjigjej për punën e tij, punën e Shtabit dhe gjendjen e sigurisë para ministrit, të cilin duhet ta mbante të informuar për ngjarjet, masat e marra dhe rezultatet e tyre. Kjo do të thotë se ai gëzonte një shkallë të lartë autonomie në marrjen e masave.<sup>110</sup>

---

107 Materiali provues i TPNJ 1099.

108 Babović, *Analizë*, § 53.

109 Materiali provues i TPNJ-së K0229694.

110 Babović, *Analizë*, § 54.

## 2.8. Konkluzione

143. Presidenti i RFJ-së ka pozicion të fortë ligjor në bashkimin e dispozitave për Këshillin Suprem të Mbrojtjes dhe Ligjet për Ushtrinë Jugosllave dhe Ligjin për Mbrojtjen. Në fakt, kështu ai mund të dominonte gjithë procesin e vendimmarrjes nga përcaktimi i gjendjes së luftës deri te komanda operative e Ushtrisë Jugosllave.

144. Dispozitat e paqarta kushtetuese në lidhje me autoritetin komandues të Presidentit të RFJ-së dhe Presidentit të Republikës së Serbisë mbi „forcat e armatosura” mund të harmonizohen me interpretim. Kështu që Presidenti i RFJ-së komandon Ushtrinë Jugosllave, ndërsa Presidenti i Republikës së Serbisë komandon mbrojtjen territoriale të Serbisë, komandon mbrojtjen territoriale të Serbisë, e cila nuk është e paraparë me kushtetutë, por e rregulluar në detaje me Ligjin serb për mbrojtjen.

145. Dispozitat e kushtetutës së RFJ-së dhe kushtetutës serbe në lidhje me shpalljen e gjendjes së luftës nuk janë të harmonizuara. Vetëm në rast të gjendjes së jashtëzakonshme kompetencat e të dy presidentëve nuk do të mbivendosen nëse shpallet gjendja e jashtëzakonshme në të gjithë territorin e Jugosllavisë, ndërsa dispozitat përkatëse serbe flasin për gjendje të jashtëzakonshme vetëm në një pjesë të territorit të Republikës. të Serbisë.

146. Në lidhje me vartësinë e MUP-it dhe forcave policore, dispozitat përkatëse të Ligjit Jugosllav për Mbrojtjen dhe Ligjit Serb për Mbrojtjen dhe Ligjit për Punët e Brendshme, nuk janë të harmonizuara.

# 3

## Detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare në lidhje me konfliktin e Kosovës

### 3.1. Traktatet ndërkombëtare detyruese për RFJ-në dhe zbatimi i tyre në të drejtën e brendshme

147. Si nënshkruese e konventave ndërkombëtare, RSFJ-ja ishte e detyruar t'i përmbahej të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe ligjeve ndërkombëtare të luftës.

RSFJ kishte nënshkruar dhe ratifikuar, ndër të tjera, konventat e mëposhtme:

- Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe dy Protokollet Shtesë të vitit 1977 (Sl. lista SFRJ, Nr. 16/1978);
- Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit (Sl. vesnik Prezidijuma Narodne Skupštine FNRJ, Nr. 2/1950);
- Konventa për Ndalimin e trafikimit të personave për shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve (Sl. lista FNRJ, Nr. 2/1951);
- Protokollin për Ndryshimin e Konventës për Skllavërinë, nënshkruar në Gjenevë më 25 shtator 1926 (Sl. lista FNRJ, Nr. 6/1955);
- Konventa Plotësuese për heqjen e skllavërisë, tregtisë së skllavëve dhe institucioneve dhe praktikave të ngjashme me skllavërinë (Sl. lista FNRJ, Nr. 7/1958);
- Konventa për Lirinë e Asociimit dhe Mbrojtjen e të Drejtës për Organizim (Sl. lista FNRJ, Nr. 8/1958);
- Konventa në lidhje me statusin e refugjatëve (Sl. lista FNRJ, Nr. 7/1960);

- Konventa në lidhje me diskriminimin në lidhje me punësimin dhe profesionin (Sl. lista FNRJ, Nr. 3/1961);
- Konventa Kundër Diskriminimit në Arsim (Sl. lista SFRJ Nr. 4/1964);
- Protokollin në lidhje me statusin e refugjatëve (Sl. lista SFRJ, Nr. 15/1967);
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (Sl. list SFRJ, Nr. 6/1967);
- Konventa për moszbatueshmërinë e kufizimeve ligjore për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit (Sl. Lista SFRJ, Nr. 50/1970);
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (Sl. lista SFRJ; Nr. 7/1971);
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (Sl. list SFRJ, Nr. 7/1971);
- Konventa Ndërkombëtare për Shtypjen dhe Ndëshkimin e Krimin të Aparteidit (Sl. lista SFRJ, Nr. 14/1975);
- Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese (Sl. lista SFRJ, Nr. 9/1991).

148. Nga pikëpamja e ligjit kushtetues ky obligim vlen edhe për RFJ-në e cila në mënyrë eksplicite në datën e shpalljes i ka pranuar të gjitha obligimet e RSFJ-së. Deklarata e miratuar nga pjesëmarrësit e seancës së përbashkët të Kuvendit të RSFJ-së, Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë dhe Kuvendit të Republikës së Malit të Zi, e miratuar më 27 prill 1992, nën pikën 1, përcakton se „Republika Federative e Jugosllavisë, në vazhdimësi të personalitetit shtetëror, juridik dhe politik ndërkombëtar të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, do t’i përmbahet rreptësisht të gjitha angazhimeve që RSF e Jugosllavisë ka marrë ndërkombëtarisht në të kaluarën”.<sup>111</sup>

149. Nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare publike, pyetja nëse RFJ-ja ishte e lidhur me detyrimet ndërkombëtare të RSFJ-së lidhet me pyetjen se kush është pasardhësi ligjor i RSFJ-së. Kjo çështje është diskutuar gjatë në Vendimin për Juridiksionin Kundërshtues të Parashtrësës<sup>112</sup>. Si përfundim,

---

111 Unë përdor përkthimin në anglisht të botuar nga Ministria e Informacionit të Republikës së Serbisë, *Kushtetuta e Republikës Federative të Jugosllavisë*, Beograd 1992, fq. 57.

112 Prokurori kundër Milan Milutinović, Dragoljub Ojdanić, Nikolla Shainović, *Vendimi për Juridiksionin Kundërshtues të Parashtrësës*, IT-99-37-PT, i 6 majit 2003. Shih gjithashtu Gjykata



RFJ-ja mbeti e lidhur me obligimet e pranuar nga RSFJ duke u përjashtuar vetëm nga puna e përditshme në Asamblenë e Përgjithshme, siç thuhet në letrën e Nënsekretarit të Përgjithshëm.<sup>113</sup>

150. RSFJ i kishte nënshkruar dhe ratifikuar Konventat e Gjenevës të vitit 1949 më 21 prill 1950 dhe dy Protokollet Shtesë të vitit 1977 më 11 qershor 1979, fakt që e bën të qartë se në kohën e shpërbërjes së saj RSFJ ishte një palë kontraktuese e lartë në Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe dy Protokollet Shtesë. Prandaj mund të konkludohet se në vitin 1998 dhe 1999, e drejta ndërkombëtare humanitare siç është shkruar në katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe në dy Protokollet Shtesë të vitit 1977, ishte e zbatueshme në territorin e Republikës Federative të Jugosllavisë.

151. Varësisht nga klasifikimi i situatës në Kosovë si konflikt i armatosur dhe më tej nga përcaktimi i karakterit të konfliktit të armatosur si ndërkombëtar apo jo ndërkombëtar, hapi tjetër është shqyrtimi i grupit të rregullave të aplikueshme.

152. Në rastin e konflikteve të armatosura, civilët mbrohen nga grupet e mëposhtme të rregullave. Para së gjithash, duhet të mbrohen të drejtat e njeriut siç janë parashikuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948. Këto të drejta shtjellohen më tej në dy Paktet Ndërkombëtare të vitit 1966, Konventën Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) dhe Konventën Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESC).

153. Veçanërisht ICCPR shërben si një burim i mirë material pasiqë neni 4 i tij shpreh qartë se të drejtat e njeriut janë deri në një masë të derogueshme në kohën e një emergjence publike të shpallur, por gjithashtu përcakton se të drejtat e parashikuara në nenet 6, 7, 8 (paragrafët I dhe 2), 11, 15, 16 dhe 18 nuk janë të derogueshme në

---

Ndërkombëtare e Drejtësisë, Vendimi për *Kërkesën për Rishikimin e Aktgjykimit të 11 korrikut në çështjen lidhur me zbatimin e Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit (Bosnja dhe Hercegovina kundër Jugosllavisë, Kundërshtimet paraprake të 3 shkurtit 2003, Lista e Përgjithshme Nr. 122.*

113 Dokument i Kombeve të Bashkuara. A/47/485.

asnjë rrethanë. Të drejtat në fjalë janë e drejta e natyrshme për jetën e nenit 6 të KNDCP, ndalimi absolut i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës siç parashikohet në nenin 7 të KNDCP, ndalimi i skllavërisë, tregtisë së skllavëve dhe servitutit të nenit 8 KNDCP, paragrafët 1 dhe 2, ndalimi i burgimit për shkak të vetëm pamundësisë për të përmbushur një detyrim kontraktor siç përcaktohet në nenin 11 të KNDCP, ndalimi i retroaktivitetit në të drejtën penale i nenit 15 të KNDCP, e drejta për njohje si person para ligjit në nenin 16 të KNDCP, dhe liria e ndërgjegjes, mendimit dhe fesë siç parashikohet në nenin 18 të KNDCP.

154. Megjithatë, mbrojtja e popullatës civile gjatë konflikteve të armatosura para së gjithash mbulohet nga Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe Protokollet e tyre Shtesë të vitit 1977.

155. Në rast se konflikti klasifikohet si konflikt i armatosur jo-ndërkombëtar, zbatohet neni 3 i përbashkët për Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollin Shtesë II. Neni 3 u jep personave që nuk marrin pjesë aktive në luftime një grup të drejtash për t'u zbatuar pa asnjë dallim të bazuar në racën, ngjyrën, fenë ose besimin, seksin, lindjen ose pasurinë dhe kritere të ngjashme. Këto të drejta përfshijnë ndalimin e dhunës ndaj jetës ose integritetit fizik, duke përfshirë torturën dhe trajtimin çnjerëzor, mizor, poshtëruës dhe degradues<sup>114</sup>, marrjen e pengjeve dhe dhënien e dënimeve dhe ekzekutimeve pa vendim të mëparshëm nga një gjykatë e krijuar rregullisht.

156. Më pas, Protokollin Shtesë II ripërcakton qëllimin dhe parimin e dallimit negativ, që do të thotë se mbrojtja duhet t'u jepet të gjithë njerëzve pa asnjë dallim mbi bazat e përmendura më lart, në nenet 1 dhe 2 të tij. Personave që nuk marrin pjesë aktive në luftime, që ose nuk luftuar kurrë ose e nuk luftojnë më, u garantohen të drejtat themelore siç parashikohen në nenin 4 të Protokollit Shtesë II, të cilat janë ndalimi i „*dhunës ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike ose mendore*” të personave, në veçanti vrasja si dhe trajtimi mizor si tortura, gjymtimi ose çdo formë e ndëshkimit trupor” (neni 4 para. 2 pika a), dënimi kolektiv (neni 4

---

114 Këto dy të fundit janë klasifikuar si fyerje ndaj dinjitetit personal nga neni 3, para. 1 lit. c të Konventës së katërt të Gjenevës.

para. 2 pika b), pengmarrja (neni 4 para. 2 pika c) dhe aktet e terrorizmit (neni 4 para. 2 lit. d). Për më tepër, ndalimet e dhunimit të dinjitetit personal (neni 4 para. 2 pika e) duke u kuptuar si trajtim poshtërues dhe degradues, por edhe përdhunimi, prostitucioni i detyruar dhe çdo formë tjetër e sulmit të pahijshëm, të gjitha format e skllavërisë dhe tregtisë së skllëvërve (neni 4 para. 2 pika f), plaçkitja (neni 4 para. 2 pika g) dhe kanosja për kryerjen e ndonjëres prej veprimeve të përmendura (neni 4 para. 2 pika h). Të gjitha këto të drejta më pas shtjellohen.

157. Rëndësi të veçantë për mbrojtjen e popullatës civile gjatë një konflikti të armatosur jo-ndërkombëtar kanë edhe nenet 13 deri në 18 që trajtojnë nën titullin e pjesës IV mbrojtjen e civilëve, të cilët duhet të mbrohen gjithmonë nga rreziqet që mund të lindin nga operacionet ushtarake, siç parashtrohet në nenin 13, i cili gjithashtu thotë se civilët dhe objektet civile nuk duhet të jenë objekt sulmi.

158. Neni 14 mbron objektet që janë thelbësore për mbijetesën e civilëve, si p.sh. ushqimi, uji i pijshëm si dhe bagëtitë ose të mbjellat. Objektet dhe veprat e rrezikshme mbrohen nga neni 15, vendet kulturore dhe vendet e kultit me nenin 16. Neni 17 ndalon rreptësisht lëvizjen e detyruar të civilëve.

159. Megjithatë, nëse konflikti është një konflikt i armatosur ndërkombëtar, zbatohen Konventa e katërt e Gjenevës e vitit 1949 dhe Protokollin i parë Shtesë i vitit 1977, të cilat janë më gjithëpërfshirëse se normat mjaft kufizuese të nenit 3 të Konventës së katërt të Gjenevës dhe ato të Protokollit Shtesë II. Konventa e Gjenevës numër katër mbron civilët në rast të një konflikti të armatosur (Seksioni I), por përfshin gjithashtu norma në lidhje me territoret e pushtuara (Seksionet I dhe III) dhe rastin e të huajve në territorin e konfliktit (Seksioni II). Për më tepër, mbrojtja e të internuarve mbulohet në Seksionin IV.

160. Për më tepër, duhet të merret parasysh Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në Rezolutën 260 A (III) të 9 dhjetorit 1948, pasi ajo e ndalon gjenocidin dhe e përkufizon atë si një akt me qëllim për të shkatërruar në tërësi ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar, siç parashikohet në nenin 2 të saj. Aktet e gjenocidit janë, sipas

përcaktimit në nenin 2, lit. a deri në d, vrasjet e anëtarëve të grupit, dëmtime të rënda trupore ose mendore të anëtarëve të grupit, shkaktim i qëllimshëm i kushteve të jetesës në grup, të cilat llogariten të sjellin shkatërrimin e tij fizik tërësisht ose pjesërisht, vendosja e masave me synimin për të parandaluar lindjet në grup dhe transferimi i detyruar i fëmijëve të grupit në një grup tjetër.

161. Për sa i përket zbatimit të këtyre detyrimeve ndërkombëtare sipas ligjit të brendshëm, mund të bëhen vëzhgimet e mëposhtme.

162. Ligji për Mbrojtjen e Republikës së Serbisë i vitit 1991 nuk e trajtoi çështjen e dënimeve për shkeljet e ligjeve të luftës pasi që rregulloret e RSFJ-së që kanë të bëjnë me ligjet e luftës dhe Kodin Penal të RSFJ-së që përmbajnë dispozitat për krimet kundër njerëzimit dhe ligjet ndërkombëtare ishin të vlefshme për Republikën e Serbisë si shtet anëtar i RSFJ-së.

163. Pas themelimit të RFJ-së, sipas nenit 19 të Ligjit për Mbrojtjen e RFJ-së, pjesëtarët e VJ-së të përfshirë në një luftë të armatosur ishin të detyruar që në të gjitha rrethanat t'u përmbaheshin rregullave të ligjeve ndërkombëtare të luftës dhe rregullave të tjera që i referohen trajtimit njerëzor të të plagosurve dhe të burgosurve dhe mbrojtjes së popullatës civile.

Presidenca e RSFJ-së kishte nxjerrë Urdhër për zbatimin e ligjeve ndërkombëtare të luftës nga forcat e armatosura të RSFJ-së.<sup>115</sup>

Në lidhje me Ligjin Kushtetues për Zbatimin e Kushtetutës së RFJ-së<sup>116</sup> i cili rregullon inkorporimin e ligjeve dhe rregulloreve federative në sistemin juridik të RFJ-së, Urdhri i Presidencës së RSFJ-së mbeti në fuqi.

164. Në lidhje me dispozitat e Urdhrit, Presidenti i RFJ-së

---

115 Botuar në Gazetën Zyrtare Ushtarake Nr. 7/1988.

116 Unë përdor përkthimin në anglisht të botuar nga Ministria e Informacionit të Republikës së Serbisë, *Kushtetuta e Republikës Federative të Jugosllavisë*, Beograd 1992, fq. 43 – 52.

- 1) duhej të ishte informuar për krimet e luftës dhe mund të kishte shqiptuar masa ndëshkuese ndaj oficerëve vartës që nuk e informuan atë;
- 2) si oficeri më i lartë ushtarak, ai duhet të kishte ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar respektimin e ligjeve ndërkombëtare të luftës dhe që oficeri përgjegjës të fillonte ndjekjen penale të individëve që shkelën ligjet ndërkombëtare të luftës;
- 3) si oficeri më i lartë ushtarak, ai ishte i detyruar të urdhëronte një hetim të plotë të shkeljeve të ligjeve të luftës, mbledhjen e provave, paraqitjen e provave dhe fillimin e procedimit përpara një gjykate ushtarake për të vendosur për shkelje të tilla të ligjeve të luftës.

165. Sa i përket masave kundër MUP-it për shkelje të rregullave të ligjeve të luftës, pozita e presidentit të RFJ-së në kuadër të sistemit të mbrojtjes dhe strukturës së VJ-së si komandant i VJ-së përfshin masa ndaj njësive të MUP-it dhe organeve të tjera që kanë marrë pjesë, si pjesë përbërëse e VJ-së në varësi të oficerit të VJ-së, në kryerjen e detyrave luftarake (neni 17).

166. Veprimet e MUP-it në kundërshtim me të drejtën humanitare ndërkombëtare të cilat nuk kanë të bëjnë me VJ-në do të ndëshkoheshin sipas Kodit Penal dhe dispozitave të tij në lidhje me krimet kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare.

### **3.2. Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Sigurimit**

167. Menjëherë pas rrënimit të autonomisë së Kosovës, Asambleja e Përgjithshme vlerësoi në një sërë rezolutash gjendjen e të drejtave të njeriut.<sup>117</sup>

168. Pasi u bëri thirrje „autoriteteve serbe që të përmbahen nga përdorimi i forcës, të ndalojnë menjëherë praktikën e „spastrimit etnik“

---

117 Pjesë nga tekstet mund të gjenden në Weller (red.), *Crisis*, fq. 125 – 132.

dhe të respektojnë plotësisht të drejtat e personave që u përkasin komuniteteve etnike ose pakicave” me Rezolutën 47/147, të 18 dhjetorit 1992, Asambleja e Përgjithshme në Rezolutën 48/153 të datës 20 dhjetor 1993 nën paragrafin 18 përmbledh shkeljet e të drejtave të njeriut dhe u kërkon „autoriteteve në Republikën Federative të Jugosllavisë” sipas paragrafit 19 të marrin masa:

„18. Dënon fuqishëm në veçanti masat dhe praktikën e diskriminimit dhe shkeljen e të drejtave të njeriut të shqiptarëve etnikë të Kosovës, si dhe represionin në shkallë të gjerë të kryer nga autoritetet serbe, duke përfshirë:

- (a) brutalitetin policor ndaj shqiptarëve etnikë, kontrollet arbitrare, sekuestrimin dhe arrestimin, torturat dhe keqtrajtimin gjatë ndalimit dhe diskriminimit në dhënien e drejtësisë, që çon në klimën e paligjshmërisë në të cilën aktet kriminale, veçanërisht kundër shqiptarëve etnikë, ndodhin pa u ndëshkuar;
- (b) largimin diskriminues të zyrtarëve shqiptarë etnikë, veçanërisht nga policia dhe gjyqësori, shkarkimin masiv të shqiptarëve etnikë nga pozita profesionale, administrative dhe të tjera të të kualifikuara në ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet publike, duke përfshirë mësimdhënësit nga sistemi shkollor i drejtuar nga serbët, dhe mbylljen e shkollave të mesme dhe universiteteve shqiptare;
- (c) burgosjen arbitrare të gazetarëve shqiptarë etnikë, mbylljen e masmediave në gjuhën shqipe dhe largimin diskriminues të personelit shqiptar etnik nga stacionet lokale të radios dhe televizionit;
- (d) represionin nga policia dhe ushtria serbe.

19. U kërkon autoriteteve në Republikën Federative të Jugosllavisë (Serbi dhe Mal i Zi):

- (a) të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për t'i dhënë fund menjëherë shkeljeve të të drejtave të njeriut të shkaktuara ndaj shqiptarëve etnikë në Kosovë, duke përfshirë, në veçanti, masat dhe praktikën diskriminuese, ndalimin arbitrar dhe përdorimin e torturës, trajtimet e tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese dhe ekzekutimeve pa gjyq;

- (b) të revokojnë të gjithë legjislacionin diskriminues, veçanërisht atë që ka hyrë në fuqi që nga viti 1989;
- (c) të rithemelojnë institucionet demokratike të Kosovës, duke përfshirë Parlamentin dhe gjyqësorin;
- (d) të rifillojnë dialogun me shqiptarët etnikë në Kosovë, duke përfshirë edhe nën kujdesin e Konferencës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë.

20. Gjithashtu u kërkon autoriteteve të Republikës Federative të Jugosllavisë (Serbi dhe Mal i Zi) që të respektojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të shqiptarëve etnikë në Kosovë, dhe shpreh mendimin se mjeti më i mirë për të mbrojtur të drejtat e njeriut në Kosovë është rivendosja e autonomisë së saj; ...”.

169. Ky vlerësim i situatës së të drejtave të njeriut dhe nxitjet e Asamblesë së Përgjithshme përsëriten vazhdimisht në rezolutat e mëposhtme.<sup>118</sup>

170. Në këtë kontekst vlen të përmendet edhe se në rezolutën 49/204, të 23 dhjetorit 1994, AP-ja i referohet opinionit të Nënkomisionit për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Pakicave se masat dhe praktikrat e cituara më lart „përbënin një formë të spastrimit etnik”. Në rezolutën 50/190, të 22 dhjetorit 1995, AP-ja është gjithashtu „e shqetësuar për çdo përpjekje për t’i përdorur refugjatët serbë dhe mjete të tjera për të ndryshuar ekuilibrin etnik në Kosovë ...”.

171. Më në fund, në rezolutën 53/164, të 9 dhjetorit 1998, në paragrafin 8 AP-ja

„dënon fuqishëm numrin dërrmues të shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera nga autoritetet e Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mal i Zi), autoritetet policore dhe ushtarake në Kosovë, duke përfshirë ekzekutime pa gjyq, sulme pa dallim dhe të përhapura ndaj civilëve, shkatërrim pa dallim dhe të gjerë të pronave, zhvendosje masive të civilëve, marrjen e pengjeve civile,

---

118 Rezoluta 49/204, 23 dhjetor 1994; 50/190, 22 dhjetor 1995; 50/193, 22 dhjetor 1995; 51/111, 12 dhjetor 1996; 51/116, 12 dhjetor 1996; 52/139, 1 dhjetor 1997; 52/147, 12 dhjetor 1997.

torturë dhe trajtime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, në shkellje të ligjit ndërkombëtar humanitar, duke përfshirë nenin 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe Protokollit Shtesë II të Konventave, në lidhje me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jo-ndërkombëtare, dhe u bën thirrje autoriteteve të Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mal i Zi) të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i eliminuar këto praktika të papranueshme.”

172. Megjithatë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së filloi të merret me situatën në Kosovë fillimisht në vitin 1998. Për t'i shqyrtuar detyrimet me të cilat përballet Republika Federative e Jugosllavisë si pasojë e një sërë rezolutash të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, rekomandohet që kjo të bëhet në mënyrë kronologjike duke filluar me REZ 1160 KS të 31 marsit 1998.<sup>119</sup>

173. Së pari dhe më kryesorja, REZ 1160 e OKB-së vendos një embargo për armët dhe materialet e lidhura për Republikën Federative të Jugosllavisë dhe Kosovën dhe kërkon raporte të rregullta nga shtetet për masat e marra për të respektuar embargon.<sup>120</sup> Gjithashtu kërkon që Republika Federative e Jugosllavisë të ndërmarrë menjëherë hapat e nevojshëm për arritjen e zgjidhjes politike dhe zbatimin e veprimeve të treguara të Grupit të Kontaktit.<sup>121</sup> Për më tepër, të dyja palëve në konflikt, autoriteteve të Republikës Federative të Jugosllavisë si dhe lidërshiptit të komunitetit të shqiptarëve të Kosovës u bëhet thirrje që të hyjnë në një dialog kuptimplotë nën kujdesin e grupit të kontaktit pasi që një proces i mirëfilltë politik përfaqësonte mënyrën e vetme për ta mposhtur dhunën dhe terrorizmin në atë kohë.<sup>122</sup> Përveç klauzolave të drejtuara ndaj Bashkësisë Ndërkombëtare, bie në sy klauzola 17 e REZ 1160 KS pasi që së pari i kërkon Prokurorisë së TPNJ-së të mbledhë informacione dhe së dyti vëren se Republika Federative e Jugosllavisë është e detyruar të bashkëpunojë me Tribunalin.

---

119 S/RES/1160 (31 mars 1998).

120 S/RES/1160 (31 mars 1998) paragrafët 8, 9 dhe 12.

121 Grupi i Kontaktit, i përbërë nga përfaqësues të Francës, Gjermanisë, Italisë, Rusisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, rekomanduan dy grupe të aktiviteteve në mars 1998, të cilat më pas iu përcollën presidentit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Shih S/1998/223 të 12 marsit 1998 dhe S/1998/272 të 27 marsit 1998.

122 S/RES/1160 (31 mars 1998) paragrafët 1 deri 4.



174. Në kundërshtim me qëllimin e veprimeve të imponuara, situata në Kosovë u përkeqësua dhe Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi REZ 1199 KS më 23 shtator 1998<sup>123</sup> në të cilën fillimisht kërkoi nga të gjitha palët që të pushojnë luftimet, të hyjnë në një armëpushim për të lehtësuar një dialog politik kuptimplotë dhe të përmirësojnë situatën humanitare për të shmangur një krizë humanitare. Për më tepër, kjo rezolutë kërkonte që Republika Federative e Jugosllavisë të ndërpriste të gjitha veprimet e forcave të sigurisë kundër civilëve dhe t'i tërhiqte këto forca shtypëse, për të mundësuar monitorimin ndërkombëtar nga Misioni Monitorues i KE-së; të akreditojnë pa asnjë pengesë misionet diplomatike dhe të lehtësonin në bashkëpunim me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Komisionerin e Lartë të OKB-së për Refugjatët kthimin e sigurt të refugjatëve dhe personave të zhvendosur si dhe qasjen e organizatave humanitare dhe furnizimeve në Kosovë.<sup>124</sup> Në anën tjetër, Këshilli i Sigurimit kërkoi që lidhshipi i shqiptarëve të Kosovës të dënojë veprimet terroriste. Për më tepër, Republikës Federative të Jugosllavisë iu kujtua përgjegjësia e saj për sigurinë e personelit diplomatik në territorin e saj dhe detyrimi i saj për t'i lehtësuar personelit monitorues një klimë pune pa kërcënime me përdorim të forcës apo përdorim të forcës. Të gjitha autoriteteve në Republikën Federative të Jugosllavisë si dhe lidhshipit të shqiptarëve të Kosovës iu bë thirrje të bashkëpunojnë me Zyrën e Prokurorisë. Përveç kësaj, u theksua se Republika Federative e Jugosllavisë duhej të sillte para drejtësisë ata pjesëtarë të forcave të sigurisë përgjegjës për keqtrajtimin e civilëve dhe shkatërrimin e pronës.

175. Më 24 tetor 1998, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi REZ 1203 KS<sup>125</sup> në të cilën nga Republika Federative e Jugosllavisë dhe lidhshipi i shqiptarëve të Kosovës u kërkua respektimi i plotë i të gjitha aspekteve të REZ 1160 KS të 31 marsit 1998 dhe REZ 1199 KS të 23 shtatorit 1998. Përveç riafirmimit të së drejtës së refugjatëve dhe personave të zhvendosur për t'u kthyer në mënyrë të sigurt, përmendet në mënyrë eksplicite përgjegjësia e Republikës Federative të Jugosllavisë për të ofruar kushte që u mundësojnë atyre ta bëjnë këtë.<sup>126</sup> Klauzola të tjera

---

123 S/RES/1199 (23 shtator 1998).

124 S/RES/1199 (23 mars 1998) paragrafi 4.

125 S/RES/1203 (24 shtator 1998).

126 Po aty paragrafi 12.

operative përmbajnë obligimet për të bashkëpunuar me Misionin Verifikues të OSBE-së në Kosovë dhe TPNJ-në.<sup>127</sup>

176. Meqenëse RFJ-ja nuk përmbushi asnjërën nga këto kërkesa, Këshilli i Sigurimit i OKB-së u mor me çështjen e RFJ-së dhe Kosovës edhe një herë në REZ 1207 KS të datës 17 nëntor 1998, duke reaguar ndaj një letre të presidentit të atëhershëm të TPNJ-së, gjyqtarit. Gabrielle Kirk-McDonald. Ai kryesisht merret me çështjet e bashkëpunimit me Tribunalin dhe i drejtohet si RFJ-së ashtu edhe udhëheqjes së komunitetit të shqiptarëve të Kosovës.<sup>128</sup>

177. Mosrespektimi i mëtejshëm i kërkesave, që gjithashtu rezultoi në viktima, siç theksohet nga presidenti i Këshillit të Sigurimit të OKB-së,<sup>129</sup> më pas çoi në dy rezoluta të tjera gjatë vitit 1999, REZ 1239 KS të 14 majit 1999<sup>130</sup> dhe REZ 1244 KS të 10 qershorit 1999.<sup>131</sup>

178. REZ 1239 KS merret kryesisht me situatën e refugjatëve dhe personave të zhvendosur dhe përmirësimin e situatës së tyre, duke u bërë thirrje shteteve dhe organizatave t'i mbështesin ata persona dhe civilë të prekur nga kriza. Edhe një herë kërkohet një zgjidhje politike e konfliktit, pasi që në të kundërt situata vetëm sa do të përkeqësohej.<sup>132</sup> Duhet të kihet parasysh se kjo rezolutë u miratua pasi sulmet ajrore nga forcat e NATO-s tashmë ishin duke u zhvilluar.

179. Më në fund, REZ 1244 KS e 10 qershorit 1999<sup>133</sup> i jep fund mosrespektimit pasi që i hap rrugën UNMIK-ut, Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara për Kosovën, duke kërkuar bashkëpunim të plotë nga Republika Federative e Jugosllavisë e cila deri më sot kishte pranuar të gjitha parimet<sup>134</sup> si aneks i rezolutës.

---

127 Po aty, paragrafët 6 dhe 14.

128 S/RES/1207 (17 shtator 1998).

129 S/PRST/ 1999/2 (19 janar 1999).

130 S/RES/1239 (14 shtator 1999).

131 S/RES/1244 (10 qershor 1999).

132 S/RES/1239 (14 maj 1999) paragrafët 2 dhe 5.

133 Kjo rezolutë u miratua vetëm 6 ditë pas pezullimit të sulmeve ajrore të NATO-s.

134 Parimet e përmendura janë: në Aneksin I Parimet e Përgjithshme të miratuara nga takimi i Ministrave të Jashtëm të G8 në Petersberg më 6 maj 1999 dhe në Aneksin II parimet për zgjidhjen e krizës në Kosovë. Këto të fundit u pranuan nga RFJ më 2 qershor 1999.

### 3.3. Konkluzione

180. RSFJ-ja ishte e detyruar t'i përmbahej të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe ligjeve ndërkombëtare të luftës si nënshkruese e konventave ndërkombëtare si Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollat e tyre Shtesë të vitit 1977, Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike e të vitit 1966, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor e vitit 1966 ose Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese. Të marra në tërësi, këto detyrime ndërkombëtare mbrojnë popullatën civile në konfliktet e armatosura, të karakterit ndërkombëtar dhe jo-ndërkombëtar, nga të gjitha format e gjenocidit dhe spastrimit etnik përmes vrasjeve, ekzekutimeve pa gjyq, trajtimit mizor si tortura, gjymtimi ose çdo formë ndëshkimi trupor, përdhunimi, prostitucioni i detyruar, shkatërrimi i pronës dhe lëvizja e detyruar e civilëve.

181. Këto konventa ishin gjithashtu të detyrueshme për RFJ-në si nga këndvështrimi i së drejtës kushtetuese ashtu edhe nga e drejta ndërkombëtare publike dhe u inkorporuan në rendin juridik të brendshëm.

182. Në lidhje me dispozitat përkatëse, Presidenti i RFJ-së mund të kishte shqiptuar masa ndëshkuese ndaj oficerëve vartës të Ushtrisë Jugosllave të cilët nuk e informuan atë për krimet e luftës, dhe ai ishte i detyruar të urdhëronte hetim të plotë dhe të fillonte procedurën para gjykatës ushtarake. Këtu përfshihen edhe masat ndaj njërive të MUP-it që kanë marrë pjesë në kryerjen e detyrave luftarake. Meqenëse Presidenti i RFJ-së ishte përgjegjës „për të mbikëqyrur zbatimin e sistemit komandues“ (neni 4 i Ligjit për Ushtrinë Jugosllave), ai kishte një detyrë pozitive ligjore për të mbikëqyrur veprimet e Ushtrisë dhe nuk mund të priste vetëm raportet.

183. Veprimet e MUP-it që nuk kishin lidhje me Ushtrinë Jugosllave duhej të dënoheshin sipas Kodit Penal dhe dispozitave të tij në lidhje me krimet kundër njerëzimit dhe ligjit të brendshëm.

184. Për më tepër, ndërmjet dhjetorit 1992 dhe dhjetorit 1998, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një numër të rezolutave

ku shprehu shqetësime të mëdha për situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë për shkak të brutalitetit policor ndaj shqiptarëve etnikë, bastisjeve arbitrare, konfiskimeve dhe arrestimeve, torturave dhe keqtrajtimit gjatë paraburgimit dhe diskriminimit në administrimin e drejtësisë, shkarkimit masiv të shqiptarëve etnikë nga pozitat profesionale, administrative dhe të tjera të kualifikuara në ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet publike, duke përfshirë mësimdhënësit nga sistemi shkollor i drejtuar nga serbët, dhe mbylljes së shkollave të mesme dhe të universiteteve shqiptare; burgosjeve arbitrare të gazetarëve shqiptarë etnikë, mbylljes së masmediave në gjuhën shqipe dhe largimit diskriminues të personelit shqiptar etnik nga radiot dhe televizionet lokale.

185. Në ato rezoluta, Asambleja e Përgjithshme u kërkoi autoriteteve në Republikën Federative të Jugosllavisë që të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i dhënë fund menjëherë këto shkelje të të drejtave të njeriut, për të revokuar të gjithë legjislacionin diskriminues dhe për të rivendosur institucionet demokratike të Kosovës, duke përfshirë Kuvendin dhe gjyqësorin.

186. Megjithatë, përkundër faktit se asnjë nga rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme nuk pati ndonjë efekt pozitiv, Këshilli i Sigurimit i OKB-së filloi të miratonte rezoluta vetëm në mars të vitit 1998. Në një seri të rezolutave pas kësaj rezolute të parë, KS kërkon që RFJ të ndalojë të gjitha veprimet e forcave të sigurisë kundër popullatës civile dhe të sjellë para drejtësisë ata anëtarë të forcave të sigurisë përgjegjës për keqtrajtimin e civilëve dhe shkatërrimin e pronës, si dhe të ndërmarrë menjëherë të gjitha hapat për arritjen e një zgjidhje politike dhe për të bashkëpunuar me TPNJ-në.

187. Sidoqoftë, RFJ nuk e respektoi asnjë nga kërkesat e KS-së. Më në fund, REZ 1244 KS e 10 qershorit 1999 krijoi bazën për themelimin e UNMIK-ut, i cili mori përsipër të gjithë pushtetin legjislativ, administrativ dhe gjyqësor në Kosovë.

## Biografia

---

Joseph Marko, i lindur më 1955, është Profesor Emeritus i të Drejtës Publike Krahasuese dhe Shkencave Politike në Universitetin e Graz/Austri, me fokus të veçantë në hulumtimet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të pakicave në shoqëritë e ndara, federalizmit dhe rajonalizmit krahasues dhe menaxhimit të konflikteve. Ai ka shërbyer si gjyqtar ndërkombëtar në Gjykatën Kushtetuese të Bosnjë dhe Hercegovinës (1997 – 2002), i emëruar nga Presidenti i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në përputhje me Marrëveshjen e Dejtonit, si dhe ka shërbyer si këshilltar politiko-juridik për reformën kushtetuese në Bosnjë dhe Hercegovinë për Përfaqësuesin e Lartë Schwarz-Schilling në vitet 2006 – 2007. Mes viteve 1998 – 2002 dhe 2004 – 2006 ai ka shërbyer edhe si anëtar i Komitetit Këshillimor për Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës në kuadër të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Në vitet 2016 – 2017 ai ishte i angazhuar si këshilltar ligjor i Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Espen Eide, për negociatat për ribashkimin e Qipros. Nga viti 1998 deri në vitin 2020 ai ka qenë edhe drejtor shkencor i Institutit për të Drejtat e Pakicave në Akademinë Evropiane në Bozen/Bolzano. Ai ka botuar dhe redaktuar më shumë se një duzinë libra dhe më shumë se 130 artikuj shkencorë në fushat e tij të hulumtimit.

ISBN 978-9951-8664-6-0



9 789951 866460